

BIBLIOTEKA  
SHËTETIT

SH-32

713

HALIL  
JAÇELLARI

# MIRËMËNGJES NJË RREZË!

TREGIME



814-32  
713.

HALIL JAÇELLARI

# MIRËMËNGJES, NJERËZ!

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## DITËT E PARA TË PRANVERËS

Era që frynte nga lindja i shpërndau retë. Shiu që ra ditët e fundit e zbuti kohën, por prapë mëngjeset ishin të ftohta.

Zenel Grona fshiu djersën me mëngën e këmishës, mori frymë thellë e vazhdoi ta qëllonte me të gjithë forcën trungun e lisit.

Lisi i rrëzuar përtokë ishte ende i fortë. Sëpata kërciste duke goditur drurin dhe jehonat përhapeshin thellë në pyll.

«Ku kuu... ku kuu...», — nisi papritur qyqja, si të donte të mbante ritmin e sëpatës. Dielli ende s'kishte dalë. «Ku kuu... ku kuu...».

«Më munde, e mallëkuar», — tha me vete Zeneli duke kujtuar fëmijërinë. E ëma e porosiste gjithmonë në vögëli që të mos dilte nga shtëpia pa ngrënë mëngjesin.

Qyqja vazhdonte kukunë me nge. Një zog rrahu krahet pranë. Skifteri u lëshua pas tij me tërë shpejtësinë dhe ai zuri të cicëronte i tmerruar. Zeneli ndoqi me sy fluturimin gjithë dredha të zogut që kërkonte t'i shpëtonte skifterit. Ata u zhdukën thellë në pyll, njëri për t'i shpëtuar thonjve të vdekjes, tjetri për të vazhduar jetën.

Pasi i bëri drutë, i lidhi mirë e i hodhi në sup. Kali i kishte ngordhur disa ditë më parë. Nën peshën e druve Zenelit iu kujtua ajo ditë.

...Kishte qenë në kopsht duke rregulluar lesën e por-

tës, kur kishte parë të birin që vraponte drejt tij. Djali dukej shumë i tronditur. Ai deshi të thoshte diçka, por i kishte mbetur fjala në grykë.

Shtrengoi grushtat e vegjël te sytë e përlotur e mezi tha:

— Kali, baba, kali!..

Zeneli vrapoi drejt oborrit, ku e gjeti doriun e tij shtrirë. Kali ngriti edhe një herë kokën kur njohu të zotin, si të donte t'i kërkonte ndjesë që po e linte. Fshatari u ul pranë kafshës, ia mori kokën me të dyja duart dhe ia vuri ngadalë mbi gjurin e tij. Sytë e kalit shkëlqyen si të shprehnin mirënjohjen më të thellë. Kurse sytë e të zotit shprehnin një dhembje të trubullt.

Fëmijët po qanin në heshtje. Kali ishte pjesëtar i familjes së tyre. Duke vështruar djemtë, Zeneli e mblodhi veten. Filloi t'i përkëdhelte dhe u tregua aq i dashur atë ditë me ta, sa fëmijët pothuaj e harruan kalin. Ai që nuk e harroi ishte Zeneli. Drutë që kishin rënduar vite të tëra në kurrizin e kafshës, tani do t'i peshonin atij mbi shpatulla.

... Këto po mendonte Zeneli tek po kthehej në shtëpi i kërrusur nën barrën e druve. Djersët në rrëkera të vogla i zbrisnin nga balli, i vishnin sytë e i pikonin nga maja e hundës. Jeta tani do të rëndonte e tëra në kurrizin e tij.

Duke ngjitur të përpjetën drejt shtëpisë, atij iu kujtua se si i tendoseshin muskujt e se si gulçonte kali në këtë copë rrugë të vështirë.

Tani kali nuk do të gulçonte më, kështu që i mbetej atij të gulçonte.

Ata kishin qenë miq të vjetër e për vite të tëra e kishin mbajtur së bashku peshën e rëndë të varfërisë.

I këputur, Zeneli e kujtoi edhe një herë me dhembje kalin e tij plak.

Dikush qeshi përtej gardhit. Zeneli vështroi andej. Qehajai i Hamdi beut i ktheu krahët. Një çast ai mendoi të lëshonte drutë e t'i hidhej atij me të gjithë tërbimin e një njeriu që e shtyp një peshë mbi supe. Po veprimi shpesh nuk i ndjek mendimet. Sidomos kur fëmijët janë të leckosur e të presin në shtëpi. Shtrëngoi nofullat e gjera e lëpiu buzët. Një nyje e vriste shumë në anën e djathtë e ai, duke ecur, hidhej për t'u ndërruar pozicionin druve. Qeni i doli përpara i gëzuar e deshi t'i përkëdhelej, por Zeneli i futi një shqelm dhe ai u largua duke ulëritur nga dhembjet. U largua dhe u tulat diku pa u ndier. Mbase dhe i habitur. Ja kishin shpërblyer gjithë atë zell dashurie me një harbutëri të pashembullt. Duhej ta mësonte dhe ai se njeriu, kur është i ngarkuar rëndë, paska ca vese të çuditshme.

— Uf!, — ia bëri Zeneli dhe i hodhi drutë në mes të oborrit. Fshiu djersët me pëllëmbët e ashpra e psherëtiu. Një gjel rrahu krahët majë gardhit e pastaj krenar e zgjati sa mundi këngën.

— Plaç të preftë!, — dëgjoji ai të shoqen, e pastaj një të pallur të lehtë viçi.

Dy djemtë e mëdhenj, njëri shtatë dhe tjetri pesë, bisedonin brenda në kasollen e lopës. Zërat e tyre iu dukën Zenelit si cicërime zogjsh. E shoqja, duke mjelur lopën, zemërohej me të madhin, që si dukej humbte pas bisedës me të vëllanë dhe nuk e mbante mirë viçin. Zenel Grona mori frymë thellë. Ajri ishte i pastër dhe i freskët. Djali i madh i tregonte të vëllait se si e kishin therur demin e Hamdi beut.

— Po ne, — tha papritur i vogli, — po ne çfarë do të therim?

— Theri babai atë gjelin e kuq, — tha Naimi, djali i madh.

— Po ta shikoje, — vazhdoi i vogli dhe filloi përsë-

ri të tregonte se si e kishin therur demin. Zeneli dëgjonte i heshtur dhe i lodhur. Nga dera gjysmë e hapur e shtëpisë pa të bijën që hapi gojën dhe shtriu krahët, sikur do të fluturonte.

— Babi, — i qeshi fytyra asaj menjëherë, — do të shkosh sot në qytet, babi?... Do të na blesh sheqer?... — Iu afrua si mace dhe u tulat në qillotat e tij prej shajaku. Zeneli i përkëdheli flokët, pastaj me duart e tij të mëdha e ngriti lart dhe e puthi.

— Më shpove, o babi, më shpove, — u ankua vajza tërë naze dhe e fshehu fytyrën në supin e tij.

— Kur do të kthehesh?, — e pyeti e shoqja, kur ai ishte bërë gati të nisej për në qytet.

— Nuk vonohem. — Hodhi hejbet në krah dhe u nis me hap të rregullt.

Fëmijët, të mbledhur rreth së ëmës, e ndoqën të atin me sy. Ai sa vinte e bëhej më i vogël. Trupi si lis i Zenelit dalëngadalë u shndërrua në një pikë të zezë, që i ngjitej faqes së malit. Pastaj ai u fut në pyll dhe ata nuk e panë më.

Duke ngjitur të përpjetën drejt qytetit, Zeneli llogariste vezët që kishte brenda në hejbe, llogariste lekët që do të merrte nga djathi, llogariste se çfarë mund të blinte dhe çfarë nuk do të mund të blinte, por tani nuk ishte kjo më e rëndësishmja. Më parë duhej të shiste vezët e djathin, ndryshe nuk mund të blinte gjë prej gjëje.

Nuk i vajti ters atë ditë.

I shiti shpejt ç'kishte për të shitur, u bleu fëmijëve nga një palë këpucë dhe i gëzuar e i lodhur e mori përsëri rrugën drejt fshatit.

Në qafë të malit u ul pranë një burimi. Dielli varej drejt perëndimit. Nxori nga trasta pak bukë, një qepë, pak djathë e hëngri ngadalë, duke vështruar atje larg, në fund të luginës. Një mjegull e hollë mbulonte shtëpitë e fsha-

tit të tij. Drodhi një cigare dhe e piu me kënaqësi. Pastaj piu edhe një herë ujë. Burimi ishte i kthjellët. Para se të takonin buzët në ujë, ai pa se nga poshtë e vështronte një fytyrë e gjerë, me mjekër të zezë, me vetulla të trasha, me flokë të dendur e me vështrim të ngrysur. E vështroi një çast fytyrën e tij, pastaj përplasi buzët në sipërfaqen e ujit dhe ajo u rrudhos duke u dredhur e tëra. Duke zbritur të tatëpjetën drejt fshatit, dëgjoi të shtëna pushkësh.

Ndaloi, mbajti vesh, pastaj e mori me mend se ato vinin nga kopshti i Hamdi beut.

Hamdi beu shtronte gosti të madhe çdo verë ditën e shënuar. I kishin ardhur miq nga ana e anës dhe kishin filluar të pinin që në drekë. Njëri prej miqve, pasi kishte treguar zotësi në raki, tani po tregonte një tjetër aftësi të rrallë. Nga njëqind hapa larg kishte bërë copë tri kuti duhani dhe festen e zezë të nënprefektit e kishte shpuar disa herë me radhë. Gazi dhe hareja ishin ngritur në qiell. Në kulmin e suksesit, i dehur nga rakia më parë e tani nga lëvdatat, thirri:

— E shikoni atë që ecën në rrugë?

Të gjithë vështruan andej nga tregonte ai me dorë.

— Do t'i rrëzoj qelshen nga koka...

— Jo, — iu hodh një tjetër nga miqtë, — u çmende? po sikur t'ia mbash drejt e në kokë!?!...

— Jo, — tha ai me rrëmbim, — unë i rrëzoj qelshen, e atë s'do ta gjejë gjë prej gjëje.

— Mos, Xhafë, do ta marrësh në qafë! — Ai që kundërshtoi i zuri grykën e pushkës për ta ndaluar.

— Pse trembeni?, — tha atëherë nënprefekti. — Xhafa ndan edhe qimen. — Pastaj urdhëroi atë që kërkonte ta ndalonte Xhafën: — Lëshoja pushkën!

Tjetri u bind menjëherë.

Të gjithë vështruan se si u ngrit gryka e pushkës dhe mbajtën frymën, bashkë me atë që vështronte me një

sy nëpërmjet shënjestrës qeleshen e bardhë të Zenel Gro-nës. Zeneli ecte i lodhur dhe i qetë. Ai kurrë nuk e merr-te me mend se nja 50 hapa larg një grykë pushke po e shoqëronte hap pas hapi.

Dëgjoi një të shtënë dhe një vërshtëllimë përmbi ko-kë. Qeleshja i fluturoi si me magji dhe ra disa hapa më tej.

Në fillim nuk kuptoi asgjë. Njëherë kujtoi se mos ia mori era. Por, kur e pa të shpuar dhe dëgjoi zhurmën që vinte nga kopshti, gjithçka iu bë e qartë.

I zbetë, vështroi edhe një herë qeleshen. Kaloi do-rën mekanikisht mbi flokët e shkrumëzuar, pastaj me egërsinë e një ariu, që ndien forcën e pamposhtur të mus-kujve të vet për t'u hedhur në sulm, u afrua rëndë-rëndë atje ku pak më parë brohoritja e të qeshurat kishin pla-sur si bombë.

Ata heshtën si me magji, sapo e panë t'u afrohej ai njeri i egërsuar, që i dridheshin flegrat e hundës nga tër-bimi.

— Ti? . . . — iu drejtua Zeneli me sytë gjysmë të mby-llur Xhafës, që e mbante pushkën mbështetur në tokë e grykën lart.

Xhafa nuk i rezistoi dot atij vështrimi të egër. Qepa-llat iu përplasën dhe e ndjeu se u zbeh.

— Ta paguaj qeleshen, — i tha me kapadaillëk, duke dashur të mos u jepte të kuptonin të tjerët se një ndjenjë frike e çuditshme e kishte pushtuar që në çastin e parë që u ndesh me vështimin e Zenelit. Me një lëvizje të rrufe-shme Zeneli ia rrëmbeu pushkën dhe e theu duke e për-plasur me forcë te një trung. Pastaj e vështroi edhe një herë nga koka te këmbët me sytë gjysmë të mbyllur dhe u kthye. Hodhi hejbet në sup dhe u nis pa vështuar prapa. Trupi i tij i madh lëkundej në çdo hap. Kapërceu gardhin dhe mori rrugën drejt shtëpisë.



Qielli ishte i kaltër. Vetëm atje larg mbi majat e mprehta të maleve, re të bardha lëviznin të heshtura.

Zeneli mori frymë thellë i lehtësuar. Ishte i kënaqur. E kishte zbrazur zemërimin. Shpejtoi hapat dhe atë çast nuk e ndjeu lodhjen e ditës. Sytë i shkëlqenin nga gëzimi. E prisnin fëmijët. Përfytyroi se si do të vraponin ata sapo ta shihnin dhe iu kujtuan këpucët që u kishte blerë. E shpejtoi edhe më shumë hapin padashur...

Një krismë oshëtiu tejpertej luginës. Pastaj një hesh-tje e plotë. Dukej sikur atë çast pranvera po përgjonte. Zeneli rënkoi dhe ra përmbys. Plumbi e mori nga prapa drejt e në zemër. Fytyra e mbytur në djersë iu shtrembë-rua nga dhembja.

Me mundim ai arriti të ngrinte edhe një herë kokën e të vështronte përpara. Gjithçka lëkundej e deformathej. Pastaj koka iu përplas përsëri në tokë. Fytyrën ia rrahën rrezet e diellit që po perëndonte. Sytë e hapur pasqy-ronin gjithë shkëlqimin e horizontit. Mbase prandaj i du-kej sikur shihte një zjarr që digjej pranë tij. I dukej sikur fëmijët hidheshin të gëzuar rreth zjarrit. Atëherë u kuj-tua se ishte festë. Ishte dita e verës. U kujtua për këpu-cët e filloi t'i kërkonte. Por u errësua e ai ndiente të ftoh-të. U drodh disa sekonda, rënkoi, e pastaj mbeti ashtu i shtrirë me fytyrë nga dielli.

Një rrëke gjaku, që i dilte nga kraharori, formoi nga-dalë një pellg të kuq. Në të pasqyrohej qielli, fytyra e tij pa jetë dhe pranvera që heshte.

## KOMSHIA

Isha i lumtur. Më dukej se isha më i lumturi në atë lumë njerëzish që mbushnin rrugët e Tiranës. Takoheshim çdo ditë në njërën nga stolat e parkut. Nuk e di pse edhe tani ai stol më duket ndryshe nga stolat e tjerë. Më duket sikur hesht i druajtur, pa ditur ç'të më thotë. Atë natë shkova në shtëpi shumë i gëzuar. I thashë nënës se do të fejoheja me Elsën. Nuk e di pse mendoja se edhe ajo do të gëzohej. Ftohtësia e nënës më ra si gozhdë në zemër.

— Gëzim!, — u hodh atëherë papritur motra ime.

— Ajo ka pasur një djalë kur ti ishe ushtar.

— Gënjën!, — thirra unë mekanikisht.

— Nuk të gënjej, Gëzim. Ti, po deshe, pyet.

E vështrova motrën drejt si i çakërdisur. Pastaj, pa thënë asnjë fjalë, dola nga shtëpia. Në fillim doja të shkoja drejt tek ajo, por nuk e di pse ndërrova mendim. I hipa autobusit dhe dola.

\*

\* \* \*

Elsa është vajza e vogël e komshiut tonë. Shtëpi-të tona i ndan vetëm një gardh. Kur u ktheva nga ushtria para disa muajsh, në fillim u habita me ndryshimin e saj. Mirë thonë se vajzat rriten shpejt. Unë isha mësuar ta shihja atë këmbëzbathur, duke vrapuar nga një qoshe e oborrit në tjetrën, të hidhej mbi gardh si mace, kurse tani ajo ecte ngadalë-ngadalë, hijerëndë. Në fillim më qeshej.

Pastaj as vetë nuk e di si fillova ta doja.

Më kujtohet një ditë, kur po rrija në shtëpi vetëm, më hipi një dëshirë e çmendur ta shihja. Prita pothuaj një orë në dritaren time. Pastaj u hodha në këmbë, vura një cigare midis buzëve dhe u nisa për te shtëpia e saj. Zëmra filloi të më rrihte fort. I trokita në portë.

— Hë, Gëzim?, — më tha ajo duke u munduar të më buzëqeshte.

Siguriqht e vuri re tronditjen time, prandaj u trondit edhe ajo.

— Nuk kisha shkrepëse, — i thashë duke i treguar cigaren.

— Elsa, — thirri e ëma nga kuzhina, — kush është?

— Gëzimi, mama, Gëzimi. — Pastaj m'u drejtua mua: — Po hajdeni brenda!

— Jo, jo, se kam punë.

Ajo vrapoi dhe më solli shkrepësen. Unë e ndeza cigaren dhe ia ktheva.

— Falemnderit!, — i thashë dhe u largova, por, kur kapërceva gardhin, dëgjova që më thirri nga prapa:

— Merreni. Mbase do t'ju duhet prapë. Ne kemi tjetër shkrepëse.

— Vërtet kujton se nuk kam shkrepëse?, — i thashë duke e vështruar drejt në sy. Ajo u hutua. — Erdha për ty, — i thashë i vendosur.

Elsa u bë flakë e kuqe...

Më kujtohet se të nesërmen kam qenë i mbërthyer nga një padurim që s'më linte të qetë asnjë çast. Kudo, kudo mendimet e mia plekseshin me të. Grumbulli i njerëzve, makinat, gjithçka që lëvizte rreth meje më bënë përshtypje. Vështroja trotuareve vajza të bukura që ecnin në grupe të qeshura a serioze, por, sado të bukura që ishin ato, më dukej sikur u mungonte ajo ngrohtësi e magjishme e dashurisë që tani më ziente përbrenda.

Zbrita nga autobusi dhe me duar të futura thellë në xhepa, po ecja kokulur. Në kokë më zienin mendime nga më të ndryshmet. Më dukej sikur gjithë ëndërrat e mia u bënë gërmadha.

— Ç'ke që je kaq i mërzitur?, — më tha një shoku im duke më rënë në sup nga prapa.

— Nuk jam i mërzitur, — i thashë. Por në të vërtetë kurrë ndonjëherë në jetën time nuk kisha qenë aq i mërzitur sa atë mbrëmje.

— Hajde, — më tha, duke më futur krahun, — hajde hedhim ndonjë gotë.

Nuk e kundërshtova jo pse doja të pija, por se nuk kisha forca të kundërshtoja. Ndihesha i plogët. Pasi kishim pirë nga dy shishe birre unë e pyeta:

— Do të martoheshe ti, Luan, me ndonjë vajzë që ka dashur një tjetër më parë?

Ai më vështrroi drejt, heshti disa sekonda, pastaj tha pa gjallëri:

— Nuk di ç'të të them, por njeriu, kur dashuron me gjithë zemër, mund edhe të gabojë.

— Domethënë ti e quan gabim të...

— S'do mend, pse, ka pak vajza?

— Por ja që ti do atë, — e ndërpreva.

— Shiko, Gëzim! — Ai më vështrroi edhe një herë drejt në sy. — Në rast se ti do ndonjë vajzë dhe ajo ka dashur ndonjë tjetër para teje, vendos pa pyetur njeri, vetëm se një gjë duhet të kesh parasysh, në qoftë se e fal duhet ta falësh me zemër dhe jo me llafe. Duhet ta harrosh atë që i ka ndodhur asaj. Në je i zoti ta bësh këtë, mirë, në rast të kundërt, në je nga ata tipa që do të të brejë gjithë jetën mendimi se ajo para teje... më mirë... S'di ç'të them më tepër... Hajde gëzuar, se m'u bë vonë.

«Po unë, mendova atë natë kur po kthehesha në shtëpi, në ç'gjendje jam unë? Mos më duket nga dashuria se jam i zoti të fal gjithçka? Po sikur nesër të pendohem? Po sikur vërtet të më brejë gjithë jetën mendimi se ajo... Si t'ia bëj, si?...»

Disa ditë iu shmanga takimit me të. Nuk vendosja dot. Një ditë në mëngjes, kur po shkoja në punë, e pashë që po më priste te stacioni. U trondita.

— Nga ke humbur kështu, Gëzim?

Sytë e saj po më vështronin me ankth. Unë e ndieja që isha zbehur.

— Pse s'më ke treguar?, — i thashë dhe në çast ndjeva të më hipte gjaku në kokë. Ajo u pre menjëherë. Filloi t'i merrej goja. Më tha se ishte matur disa herë, më tha se nuk kishte pasur guxim.

Ndërkaq erdhi autobusi. Unë u ngjita pa e vështruar fare atë. Por pashë që erdhi pas meje dhe m'u ul pranë.

— Mos kujto se kushedi ç'kam pasur me të, — tha Elsa. Unë e vështrova drejt. Buzët e saj ishin tharë. Ndjeva një dhembje therëse për të.

— Gëzim!...

— Pse s'më ke treguar më parë?, — i thashë unë gjithë inat.

Edhe tani më vjen çudi kur e kujtoj. Ndjenja të kundërta luftonin tek unë, duke fituar herë njëra e herë tjetra. E kjo ndodhte brenda sekondës.

— Nuk të fal dot, — i thashë. — Ik!...

— Mirë, — tha ajo. Buza e poshtme filloi t'i dridhej. Në stacionin e parë zbriti. Mbete vetëm. Autobusi filloi të ecte përpara.

— U ndava, — belbëzova. M'u duk sikur m'u shtrëngua zemra nga një dorë e akullt. Gjithë dashuria për të më hodhi në çast në këmbë. I thirra fort shoferit të nda-

lonte. Ai më vështroi i habitur. Sapo ndaloi autobusi, u hodha dhe vrapova si i çmendur. Trembesha se nuk do ta arrija dot. Por, sa dola te kthesa e pashë dhe, me ta parë, përsëri filloi lufta. Nuk e kuptova as vetë se si fillova t'i ngadalësoja hapat. Sa më shumë i afrohesha asaj, aq më i plogët bëhesha. Më në fund ndalova. E pashë se si u largua deri sa humbi në fund të rrugës.

Një plak më vështroi i habitur. Patjetër më ka marrë për të çmendur. Dhe kishte arsye. Fytyra ime atë çast nuk dukej ndryshe.

\*

\*

\*

Kanë kaluar dy vjet që atëherë. Është mbrëmje. Verë. Jam në dhomën time, me dritën të fikur dhe vështroj nga oborri i Elsës. Ai është bërë dritë. Të dielën ajo marotohet. Një fisarmonikë, një xhes, një kitarë nuk pushojnë. Unë ndjek me vështrimin e zymtë çiftet. Edhe Elsa vallëzon me një kushëririn e vet. Ajo është e qeshur. Duket shumë e bukur Elsa. Pse ta fshch, unë ende e dua atë. «Pse u ndava?» Të them të drejtën e kam zili atë djalin që të dielën do të bëhet burri i saj. Edhe atij mund t'i kenë thënë që ka pasur një djalë. Mund t'i kenë thënë edhe për mua. Sa qesharake më duket! E ç'kam pasur unë me të?... Nga gjëra të tilla thua e humba Elsën?..

Ndërsa mendoj kështu, tingujt rebelë të orkestrës depërtojnë thellë brenda meje. Ajo është në dritë, e gëzuar, unë në errësirë, i vetëm. Ky mendim më bëri të largohesha nga dritarja. Dola, rrëshqita fshchurazi nëpër oborrin tim dhe shkova te stacioni i autobusit. Nata ishte e ngrohtë dhe plot yje. Atje tej vezullojnë dritat e Tiranës. Por mua më dukej se brenda meje një vend i zbrazët nuk mbushej me ajër.

## NGJARJE NË RRUGË

Makina u ngjitej të përpjetave të Ndroqit. Unë ndiqja dy anët e rrugës, kodrat përtej, malet mavi të horizontit dhe një ndjenjë e thellë pendimi më dukej sikur më rëndonte frymëmarrjen. Ajo që ndodhi pak më parë më mallëngjeu shumë. Ndoshta nga që jam i moshuar, a ndoshta nga që nuk e prisja prej tij.

Kam plot pesë vjet që kam dalë në pension e kisha plot pesë vjet që nuk e kisha parë atë. Por e njoha sapo e pashë aty pak më parë, aty te plepat e plazhit. Ai gjithmonë më qe dukur arrogant, i prapë e njeri që i pëlqente vetja. Më kujtohet njëherë kur unë shkova në repartin e tyre. Kur hyra, ata po diskutonin me zjarr rreth një prese të madhe që kërkonin ta yinin në punë sa më parë. Kur u afrova, ata ndërprejnë bisedën.

— Si është puna?, — pyeta.

— Shoku drejtor, — tha njëri nga ata, — makina është gati. Unë them ta vëmë në punë menjëherë se, siç e dini, e kemi litarin në fyt.

Heshta. E vështrova atë makineri të re si të kërkoja mendimin e saj. Më dukeshin të vegjël të gjithë në krahasim me të, por megjithatë ajo qëndronte aty e heshtur. Ajo priste vetëm një shtytje të vogël me majën e gishtit, në atë butonin blu, që gjithë metali i saj të dridhej e të ulërinte, që gjithë ingranazhet e saj gjigante të kapeshin

dhëmb për dhëmb, duke vënë në lëvizje të gjitha levat dhe pulexhat e saj të mëdha, e të gëlltiste gjithë dengjet që grumbulloheshin gjithmonë e më shumë, t'i presonte e t'i kthente në pako të vogla!

— Po mirë, — pyeta, — pse kundërshton Spiroja?

— Më duket se vjen e shtrembër!, — u hodh Spiroja. — Është e mira të marrim ndonjë inxhinier që ta vërë në punë, se mos na ndodhë ndonjë gjë pastaj.

— Si thoni, të marrim ndonjë inxhinier ta shohë?, — arsyetova dhe unë.

— Shoku drejtor, — u hodh një i ri, — teknikisht kjo është shumë në rregull, s'keni pse të merrni njeri. Makina është vendosur shumë drejt. Ato që thotë Spiroja nuk kanë asnjë bazë. Për inxhinier s'ka nevojë, kot ta sjellësh atë këtu.

I riu i tha këto fjalë me shumë vendosmëri e pak si me ironi. Nuk e di se si më erdhi dhe i thashë:

— Rri, more, aty ti!... Na flet dhe me kompetencë të madhe.

Ai u bë flakë i kuq, më vështroi në sy, pastaj më ktheu krahët dhe u largua.

— Skënderi ka të drejtë, shoku drejtor, — tha shefi i repartit të tyre si me druajtje. — S'ka nevojë kjo punë për inxhinier, e bëjmë vetë.

— More Servet, unë kam hall mos na thyhet ndonjë vegël e saj.

— Jo, shoku drejtor, ju siguroj që asgjë s'do t'i ndodhë.

— Mirë, more djema, e vini në punë po qe kështu, — u thashë unë dhe dola.

Prej asaj dite, megjithëse nuk kisha arsye, fillova ta vështroja vëngër atë djalin e ri. Nuk e di përse. Ndoshta pse foli me ironi. Megjithatë e ndieja se nuk u solla mirë me të.



Një ditë u ndesha me të përballë në rrugë. Ai deshi të më përshëndeste, por unë i hodha sytë gjetkë. Nuk e di as vetë pse veprova ashtu, por prej asaj dite ai kurrë nuk më foli, kurse unë u pendova. Më vonë dhe desha t'i fli-sja disa herë, por ai, sa herë ndodheshim përballë, kthen-te kokën në anën tjetër. Kështu u trash kjo mesele.

Njëherë tjetër bile i hyra kot në hak. Patëm një de-fekt. Unë dhashë urdhër: «Asnjë të mos i fusë duart!» Ajo ishte një makinë e re dhe delikate. Shkova vetë dhe mora inxhinierin e kombinatit, por, kur erdha me të, e gjetëm makinën në punë.

— E rregulloi Skënderi, — më tha shefi i repartit me fytyrë të qeshur.

— Po unë si kisha urdhëruar?, — thirra me inat. Ai nuk m'u përgjigj. Kur dola jashtë, dëgjova Skënderin që i thoshte shefit të repartit:

— Në rast se nuk ka besim te ne, le të shkojë të gjejë të tjerë, qysh tani po largohem nga ndërmarrja. . .

Unë futa kokën në dritare. Ai ishte bërë flakë i kuq në fytyrë dhe sytë i shkëlqenin si xixa nga inati.

—Po largohesh nga ndërmarrja?, — e pyeta duke e vështruar nga poshtë lart. — Shko te shefi i kuadrit e merr likuidimin.

— Që tani!, —tha prerë ai dhe filloi me rrëmbim të hiqte kominoshet.

Por unë shkova më parë se ai te shefi i kuadrit dhe i thashë që të mos ia jepte largimin, pastaj ngarkova nën-drejtorin të bisedonte me të. E di që duhej ta kisha thi-rrur vetë e t'i thosha se fajin e kisha pasur unë, por një farë krenarie e sëmure apo egoizmi nuk më linte ta bëja një gjë të tillë. Nejse, mos ta zgjas, pas ca vitesh dola në pension. Shkoja ndonjëherë nga ndërmarrja, se më merrte malli. Shkoja edhe nga reparti ku punonte ai djali. Do të



dëshiroja të bisedoja gjatë me të, t'i kërkoja ndjesë për sjelljen time, por asnjëherë nuk e gjeta.

Dhe ja sot, kur po prisja te plepat për t'u kthyer në Tiranë, shoh një makinë të ndërmarrjes ku kisha punuar. U ngrita dhe i bëra me dorë. Makina ndaloi.

— I paske të dy vendet e zëna, — i thashë shoferit — Shko, shko.

Por në atë çast u hap dera tjetër dhe doli dikush.

— Hipni, drejtor, se unë gjej ndonjë makinë tjetër. Ai që i tha këto fjalë ishte Skënderi.

— Jo, jo, në asnjë mënyrë!, — kundërshtova.

— Patjetër të hipni, shoku drejtor. Ju jeni i moshuar e unë i ri.

Si tha këto fjalë, u gjend përjashta. Po të mos hipja, do ta fyeja. E përqafova. Desha të bisedoja gjatë me të, po s'ishte koha. I shtrëngova edhe një herë duart dhe e përqafova, si të ishte djali im.

Kur e lamë pas, unë nxora kokën dhe i tunda dorën. Ai qeshi dhe ma ktheu me dorë përshëndetjen.

— Është xhevahir djalë, — tha shoferi.

Unë desha ta pohoja këtë, po nuk fola dot. Isha shumë i mallëngjyer.

## MIRËMËNGJES, NJERËZ!

Ende nuk ishin shuar yjet. Një erë e fortë frynte nga lindja. Ngrita jakën e palltos dhe shpejtova hapat. Nga larg dëgjova vërshëllimën e trenit. Pasi preva biletën, iu afrova shinave dhe vështrova lokomotivën që po afrohej ngadalë, duke gulçuar.

Drita e vagonit ishte e zbetë. Zura vend në një kabinë pranë dritares. Treni u nis ngadalë dhe ashtu pa u ndier e shtoi shpejtësinë.

— Po ai ujë atje?, — pyeti dikush përballë meje.

— Ku?...

Nuk i dalloja dot mirë fytyrat e tyre. Vështrova nga dritarja. Larg, në fushë, drita e hënës binte mbi plastmasin që mbulonte shtretërit e nxhtë.

— Janë shtretërit e nxhtë të fermës.

— Sa bukur u dukërkën! Tamam si valë...

— Vërtet, — tha tjetri dhe përsëri në vagon ra heshtje.

Hëna po perëndonte. Ajo, si e lodhur, dukej sikur shpejtonte të mbështeste kokën në vargun e largët të maleve.

— Një poet i madh italian thotë se njeriu vrapon drejt vdekjes, — tha papritur njëri nga ata që ishin ulur përballë meje e që e quanin Vasil. — Nganjëherë më duket se i ka rënë në të rrufjani, — vazhdoi ai pastaj, e, si heshti një çast, foli si të kuvendonte me vete:

— Njeriu, kur është i vogël thotë: «Ah, sa të rritem». Pastaj: «Ah, sa të mbaroj universitetin!». Pastaj gjithmonë: «ah», dhe me padurim pret të ardhmen. Pse, a nuk të duket e vërtetë kjo, doktor?... A nuk themi ne gjithmonë sa të kalojë ky muaj, sa të vijë vera; a nuk presim ne me një padurim të pakuptueshëm të nesërmen?

Tjetri, që i thërrisnin doktor, nuk foli. Treni tani vraponte me të gjithë shpejtësinë përpara. Hëna ishte zhdukur përtej maleve në horizont dhe errësira ishte bërë edhe më e plotë.

— Vërtet, doktor, ç'mendon ti?

— Ç'mendoj unë?... — doktori luajti pak nga vendi, u kollit dhe vazhdoi i qetë:

— Kjo është filozofia e njerëzve të dobët, e njerëzve që jetojnë vetëm për vete. Kur ti flisje, mua m'u kujtua një njeri që s'do ta harroj kurrë...

U bë heshtje dhe për një çast u dëgjuan vetëm rrotat e trenit që rrotulloheshin mbi shinat. Përtej xhamit konturet e tokës shfaqeshin një çast e pastaj përsëri humbisnin në errësirë.

— Në vitin 1935 mbarova studimet dhe u ktheva në Shqipëri, — foli ngadalë ai që e thërrisnin doktor. — Në qytetin ku punoja ishim vetëm dy mjekë. «Do t'i marrësh paratë me thes, qerrata», — më tha një xhaxhai im që kishte një prirje të veçantë për të fituar. Por mua nuk më hynte asgjë në sy. Gjithçka më dukej bosh dhe pa kuptim. Gjendjen time e rëndoi më tepër një fëmijë që më vdiq në duar. Atëherë më mbytën mendimet nga më të errëtat. Më dukej vetja fare i pafuqishëm përpara asaj morie njerëzish të sëmurë, që grumbulloheshin çdo ditë përpara derës sime. Jeta m'u duk fare e zbrazët dhe e neveritshme. M'u duk se u dorëzova dhe nuk më mbetej asgjë që e vlen të jetoja.

— Do të mësohesh, biri im, — më tha një ditë kolegu.  
— Fillimi gjithmonë është i rëndë në zanatin tonë.

Por mua më dukej sikur nuk do të mësohesha kurrë.

Një ditë ai më mori me vete. Do të bënte një vizitë të një i sëmurë. Shkuam në periferi të qytetit, në një lagje me shtëpi përdhese. Sapo hymë, më ra në sy një varfëri e madhe. Dhoma ku lëngonte i sëmuri ishte e vogël, me tavani të ulët e me mure të zhveshura. Në njërin qoshe të vatrës ishte vënë shtrati. Mbulesa nën të cilën dergjej i sëmuri ishte fare e grisur, si i thonë fjalës s'kishte ku ta zinte qeni. Dritaret e vogla ishin pa perde. Vatra ishte pothuaj pa zjarr. Dhoma ishte shumë e ftohtë për një të sëmurë. Pranë shtratit ishin një tryezë e shtrembër e dy karrige të vjetra. Këto qenë të gjitha «mobiljet» e asaj dhome.

— Nuk e ka të gjatë ky miku, e shumta tre muaj,  
— më foli frengjisht kolegu im si kishte mbaruar vizitën. E vështrova të sëmurin. Edhe ai më vështroi. Fytyrën e tij të zbetë e gjallëronin vetëm sytë. Sytë e tij shkëlqenin në një mënyrë të çuditshme. Dukej sikur një zjarr i madh digjej në ta. Nuk e durova dot atë vështrim dhe u largova. Në një qoshe të dhomës më zuri syri ca libra. U afrova dhe mora njërin në dorë. Në çast më kaluan të rrëqethura në trup.

— Kush i lexon këto?, — pyeta me zë të ulët të shoqen e të sëmurit. Ajo bëri me kokë nga i shoqi. Unë nuk guxova ta ktheja kokën anej. Domethënë ai e kishte marrë vesh se do të vdiste pas tre muajsh. Librat ishin frengjisht. Ngriva në vend. Më dukej sikur e ndieja nga prapa vështrimin e tij që më mbërthente si gozhdë. Shokut tim patjetër kurrë nuk i kishte shkuar në mend se ai njeri që rronte në mes të një mizerje e një varfërie të tillë e njihite frengjishten. Ai vazhdonte të shkruante recetën. Kur do lëm përjashta dhe i thashë si qëndronte puna, atij nuk i

mbeti gjak në fytyrë. I zbetë më tha se kishte bërë një krim të vërtetë. Unë desha ta qetësoja, po nuk gjeta dot fjalët e përshtatshme. Atë natë pimë në një kafene deri vonë. Dëshëm mbase të harronim atë ngjarje, të tjera, a ndoshta deshëm të harronim atë natë, vetë jetën. Por alkooli ndonjëherë ta ndez më shumë fantazinë. Vonë duke u kthyer në shtëpi vështroja qiellin e ftohtë dhe më dukej sikur isha unë ai njeri që do të vdisja pas tre muajsh. Më kapi një mallëngjim i tillë, sa për pak qava. Mbase e kishin fajin edhe gotat e rakisë. Rruga ishte e shkretë dhe qyteti dukej sikur nuk merrte frymë. Por në atë çast nga skajti përballë rrugës u dëgjua një zë i lodhur si të vinte nga fundi i dheut. Dikush këndonte:

*Natën e mirë, o qytet i përgjumur,  
jam i fundit shëtitor që vetëm të lë,  
do të shkoj në një qoshë diku për t'u strukur,  
i uritur dhe sot si gjithnjë.*

Ishte një plak, një lypës që e kisha parë shpesh në rrugët e atij qyteti të vogël. Futa duart në xhepa dhe ia dhashë të gjitha ç'më kishin mbetur. Para se ai ta merrte veten, u zhduka. Tani isha bërë esëll. Jeta më dukej një humnerë ku vetëm mjerimi dhe kotësia vallëzonin si avuj pa fund. M'u duk se kot jetoja. M'u duk se njerëzimi ishte dënuar të rënkonte përjetësisht. M'u duk vetja si një krimb që nuk është i zoti për asgjë. Pastaj mendja më shkoi përsëri tek ai njeri që do të vdiste pas tre muajsh.

«Edhe ai me siguri nuk fle,» — mendoja. «E si mund të flejë ai», — thosha me vete. Ai patjetër tani do të vdesë më shpejt. Ankthi do ta shtrëngojë, do ta lërë pa gjumë, nuk do ta lërë të qetë asnjë çast e do t'ia shkurtojë me shpejtësi jetën, atë jetë që edhe ashtu ishte mjaft e

shkurtër. Patjetër ai nuk fle, të paktën sonte,» — thashë me vete dhe në çast më hipi një dëshirë e papërmbajtur për ta vërtetuar atë që mendoja. U ktheva nga rruga dhe u nisa në drejtim të kundërt. Besoj se do të kishte kaluar mesi i natës. Vetëm ndonjë qen që lehte dëgjohej që larg.

Kur iu afrova asaj shtëpie të ulët, pashë se dritarja ku ishte i sëmuri kishte dritë.

«Po» — thashë, — ai nuk fle».

U afrova si hajdut dhe vështrova brenda. Ai rrinte ndenjor mbi shtrat. Kishte hedhur mbulesën e vjetër kraheve. Kishte afruar pranë vetes atë tryezën e shtrembër. Mbi të ishte vendosur një llampë vajguri dhe përreth ish in shpërndarë letrat. Shkruante i thelluar në punën e tij. Dukej si në ethe. E kishte rrëmbyer një pasion që shihej qartë. Shkruante, vështronte në një libër të trashë, shfletonte një fjalor, i nxituar buzëqeshte dhe përsëri shkruante. Dukej që diçka përkthente. Fërkova sytë, se nuk e di pse për një çast m'u duk sikur po shihja një ëndërr. Pastaj e vështrova përsëri. Ai dukej i lumtur. I qeshte fytyra. Pastaj përsëri merрте pamjen e një njeriu të thelluar në një punë që i jep kënaqësi.

«Ai nuk e di që do të vdesë!», — thashë me vete. — Patjetër ai nuk e ka kuptuar atë që më tha frengjisht shoku im, ndryshe nuk kam si ta shpjgoj këtë që po shoh».

Pikërisht ky që shkaku që të nesërmen shkova tek ai. E gjeta duke punuar. Përsëri u trondita nga vështrimi i tij. Ai më vështroi ngrohtë, por në sytë e tij shkëlqente një zjarr i madh që të impononte t'i ulje sytë përdhe. Filloi të më fliste me një frengjishte shumë të pastër. Kjo më bëri që të më kalonin përsëri të rrëqethura në trup.

— Pse shqetësoheni, doktor?, — tha, si t'u kishte

hyrë në brendësi mendimeve të mia. — Kolegu juaj nuk më tha ndonjë gjë të papritur. Edhe babai im nga kjo sëmundje ka vdekur, pikërisht në këtë moshë. Unë e trashëgoj prej tij këtë sëmundje. Por... tre muaj nuk janë pak. Unë gjatë kësaj kohe do të përfundoj së përkthyeri Darwinin, patjetër do ta mbaroj.

Ai tani dukej sikur nuk më shikonte mua, sikur nuk shikonte asgjë e s'mendonte për asgjë në botë, vetëm për Darwinin, vetëm për përkthimin e tij. Ai e kishte harruar vërtet vdekjen atë çast. Se ai kishte një dashuri të paku-fishme për njerëzit. Dhe pikërisht ajo dashuri e bënte atë të mendonte mbi çdo gjë për punën, për atë punë që ndofta e bënte të harronte varfërinë, mizerjen që e kishte mbuluar dhe vdekjen që i rrinte mbi kokë.

— Ja se ç'mendoj unë, Vasil... — i tha më në fund doktori bashkëbiseduesit dhe përsëri vazhdoi: — Tani do të pyes unë ty: Cila të duket më e drejtë? Të rrosh vetëm duke pritur kohën e plazhit, Vitin e Ri, të dielat, apo të kesh një qëllim të vërtetë në jetë?

Tjetri nuk u përgjigj. Ndërkaq kishte filluar të zbardhte. Tani unë i shihja qartë fytyrat e tyre.

— Kështu, Vasil, — vazhdoi mjeku përsëri me zë të qetë, — ne shpesh ia hedhim fajin jetës për dobësitë tona, e ngushtojmë kuptimin e saj dhe mundohemi të justifikohemi kur kemi bërë një jetë boshe...

Treni ndaloi dhe mua më duhej të zbrisja. I përshëndeta dhe dola jashtë. U largova nga stacioni dhe mora përpjetë një rrugë këmbësorësh. Zhurma e trenit sa vinte e dobësohej, deri sa humbi thellë grykave ku tashmë kishin filluar të ndriçonin rrezet e para të diellit.



## FAN BADERA

Dikush e tradhtoi Zenel Lekën.

Dyqind e ca ushtarë të Mehmet pashës iu ngjitën heshtazi luginës dhe u rrethuan në shtëpinë e tij. Në mëngjes herë, pa dalë dielli, i propozuan disa herë që të dorëzohej, po komiti refuzoi me përbuzje.

Pas disa orësh lufte Zeneli u vra. Kur hynë turqit në shtëpi, gjetën të vrarë bashkë me të, të shoqen dhe një vajzë shumë të re. I vetmi rob i betejës qe një djalë rreth shtatëvjeç. Ai qëndronte i heshtur pranë kufomës së të atit. I vështroi turqit i ngrysur dhe, kur ata u orvatën ta merrnin me të butë, ai u egërsua.

Turqit e morën të lidhur brenda në një kosh, e ngarkuan në një mushkë dhe ia çuan pashës peshqesh nga shtëpia gjysmë e djegur e Zenel Lekës. Por edhe ai pas dy javësh vdiq. Vdiq i egër, ashtu si erdhi në kështjellë.

Pasha e vështroi i habitur. Kufoma e vogël e djalit nuk ngjante fare me vogëlushin e bukur që i kishin sjellë para ca ditësh. Ishte tretur pothuaj krejt.

— Gjithë këto ditë nuk futi asnjë kafshatë në gojë!, — tha dikush pas shpinës së pashës.

U shua edhe Zenel Leka, — tha pasha. — Thoshin se nuk e zinte plumbi!, — qeshi. — Përralla!... Por, sa për trim, ka qenë i rrallë. Trim i krisur fare! — Vështroi përsëri trupin e vogël të djalit të vdekur. Ai dukej sikur flinte i rraskapitur.

— Është interesante historia e këtyre Lekajve, — shtoi pas pak pasha i zyrtë. — Një gjyshi im më ka lënë një ditar shumë të lashtë të një farë Hafiz Gjylbegut, i cili shumë vjet më parë ka shërbyer po në këtë kështjellë si sekretar i njërit prej stërgjyshërve të mi. Në ditar bëhet fjalë për një Fan Badera. Hafiz Gjylbegu tregon për Fan Baderën gjëra të tmerrshme: «Ishte një ari i vërtetë, shkruan, një përpindsh, me një shkathtësi të çuditshme në përdorimin e shpatës...».

Fan Badera kishte qenë bari në fshatin ku lindi Ballaban Pasha. Kur Skënderbeu mori Krujën më 1444, Fani braktisi kopenë dhe shkoi vullnetar në Krujë. Skënderbeu, duke parë aftësi të rralla fizike tek ai bari matjan, e mori në gardën e tij dhe më vonë e bëri edhe kapedan të saj. Por edhe pas vdekjes së Skënderbeut, bile edhe pas rënies së Krujës, Fan Badera vazhdoi të endej si hije e frikshme mal më mal.

Ndonjë nga ju ndoshta do të pyesë se ç'hyn ky Fan Badera në muhabetin që patëm. — Pasha tundi kokën duke qeshur. — Kini pak durim!... Fan Badera, që i martuar me një dibrane, të cilën Hafiz Gjylbegu në ditarin e tij na e tregon të rrallë nga bukuria..., pasha kroj pak kokën. — Hë po, ku e lashë fjalën?

— I martuar me një dibrane..., — tha njëri nga ata që e dëgjonin.

— Tamam!.. Me të pati djalë. Në njërin nga ekspeditat tona në fshatrat e Matit ia rrëmbyem gruan dhe djalin. Djali nuk ishte më shumë se dy vjeç. E çuan në Turqi, më vonë në shkollën e jeniçerëve.

Pas shumë vitesh, kur kryengritja shqiptare ishte shuar pothuaj krejt, Idriz pasha, njëri nga stërgjyshërit e mi, i fali të birit të Fan Baderës, që i kishte shërbyer me trimëri, fshatin Lekaj.

Mehmet pasha përsëri heshti, pastaj vuri buzën në gaz:

— E shikoni se ç'djall fati kanë pasur këta djaj shqiptarë? I biri i Fan Baderës u vendos në Lekaj për të shtypur ata që deri në vdekje i kishte udhëhequr kundër nesh babai i tij! . . . Nejsë . . . Vetëkuptohet që i biri as që e dinte fare gjuhën e mallëkuar të këtij vendi. E thërrisnin Selim bej Leka. U martua pesë herë. Herën e fundit me një shqiptare që nuk i kishte mbushur të njëzetat. Me të lindi një djalë, pastaj nuk zgjati shumë e vdiq. Si duket e ëma shqiptare e rriti të birin me ndjenja jo të mira, o ndoshta në gjakun e tij u ndez rebelizmi i stërgjyshërve. Me t'u burrëruar, djali i Selim bej Lekës, Mersin Leka, në krye të një çete cubash mori malet. Pas tridhjetë e ca vjetësh u rrethua dhe u vra, pasi nuk dëgjoji të dorëzohej.

Nuk kaluan vetëm disa vjet, kur një nga djemtë e Mersinit ngrihet kundër nesh. Ky i fundit është i ati i Zenel Lekës.

— Thonë se edhe Zenel Leka kishte dy djem, — tha me druajtje njëri prej të pranishmëve.

Pasha psherëtiu:

— Të gjithë këta Lekajt janë raca e Fan Baderës, që përshkruan Hafiz Gjylbegu. Racë e mallëkuar e të pabindurit Fan Badera.

Pasha vështroi përsëri kufomën e djalit të vogël. Iu duk sikur ajo fytyrë e zbetë vuri buzën në gaz, si t'i kishte dëgjuar të gjitha. Mehmet pasha u rrëqeth. Hapi sytë mirë dhe vetëm atëherë e kuptoi se kishte qenë vetëm një iluzion, lindur ndoshta nga ato kujtime të lashta.

Pastaj u kthye dhe nxori nga një raft një libër të trashë me kapakë të zinj, e rrotulloi një copë herë në dorë, i ngrysur u ul pranë oxhakut, shtriu këmbët në shilte dhe u mbështet mirë.

Të tjerët të druajtur, vështruan njëri-tjetrin, pa ditur ç'të bënin. Kufoma e djalit të vogël, shtrirë pranë derës, dukej sikur flinte e qetë.

Pasha pasi kaloi gishtin e madh mbi kapakun e librit, e hapi atë nga fundi dhe filloi të lexonte:

«Lajmi se Fan Baderën po e sillnin të lidhur në kë-shtjellë, u prit me brohoritje që tundën muret...»

Pasha shfletoi më tutje dhe i heshtur ndoqi radhët e ditarit të Hafiz Gjylbegut:

— Fan Badera, — iu drejtua atij pashai ynë, — po të më kërkosh mëshirë, do të ta fal jetën.

Në fytyrën e plakut u fshi në çast ajo endje e lehtë ëndërimi. Sytë iu ndezën.

— Në rast se ti, Fan Badera, më jep fjalën se do të shkosh në male e do t'i kthesh të gjithë shokët e tu në-për shtëpi, unë të liroj që këtë çast dhe veç kësaj, të jap fjalën se të gjithë shokët e tu do t'i lë të qetë.

— Ne s'kemi shtëpi, — u përgjigj i qetë Fan Badera. — Ato na i dogjët ju.

— Unë të jap fjalën se ty të parit dhe më pas të gjithë të tjerëve do t'ju ngremë shtëpi të reja.

— Ne i ngremë vetë shtëpitë tona, po më parë duhet të ikni ju. Malet tona janë plot me gurë. Ju s'mund t'i ngreni dot shtëpitë tona, ashtu si nuk mund të na ktheni njerëzit tanë që dogjët në to. Ju jeni armiqtë tanë dhe të tillë do të mbeteni për jetë. Kurrë mos shpresoni se do të rrojmë në paqe me ju, kurrë, kurrë!

Një radhë dhëmbësh të bardhë i shkëlqyen përmes nofullave të gjera. U habita. Asnjë dhëmb nuk i mungonte atij plaku.

— Fan Badera, nuk kam ndër mend të të lutem!, — tha pasha. Ndërsa Fani qeshi. Një përçmim i thellë pasqyrohej në fytyrën e tij të egër.

— Më dukesh fare i vogël, — i tha ai pashës. — E si

mund të mendosh që do ta sjellim vetë ne atë që s'po mundesh ta fitosh me forcën e armëve? Ju kurrë nuk do të mund ta shuani zjarrin... Shtëpitë tona janë të ngritura për shekuj. — Ngriti dorën drejt maleve: — Ato nuk do të mund t'i digjni kurrë.

Ne vështruam padashur andej nga tregoi ai me dorë. Male të heshtura e të frikshme na vështronin nga çdo anë me kërcënim.

Pas ekzekutimit të Fan Baderës s'po e ndienim veten të qetë. Një frikë e çuditshme nuk po më ndahej. Më kot kishim menduar se pasi ta zhduknim atë, do të fitonim qetësinë. Ai na u fut këtu brenda, bashkë me tmerrin që të kallte emri i tij. Dhe me vdekjen e tij na rrëmbeu njëherë e përgjithmonë çdo shpresë për atë ditë paqeje në këtë tokë të mallëkuar.

Më duket se e shoh ende të gjallë, sikur qesh si xhind. Dhëmbët e tij të bardhë më fusnin frikën. Më duket sikur hakmarrja e tyre na rri varur pas qafës e nuk na lë të marrim frymë. Tani jam më tepër se kurrë i bindur që këta djaj arnautë kurrë nuk do të shtrohen...».

Mehmet pasha e mbylli i menduar ditarin. Pastaj ngriti sytë ngadalë dhe vështrimi i hasi në fytyrën e vdekur të djalit. Pashai u drodh, se përsëri iu duk sikur djali vuri buzën në gaz.

— Cili nga ju tha se Zenel Leka ka edhe një djalë tjetër? — pyeti.

— Kështu thonë, pasha, — tha me gjysmë zëri dhe me frikë njëri nga ata që qëndronin në këmbë.

Pasha shikoi edhe një herë kufomën e vogël.

— Kasëm!, — thirri si i xhindosur. Kur Kasëmi qëndroi përpara tij i gatshëm, pasha tha tepër i tronditur:

— Nxirreni jashtë Fan Baderën!

Kasëmi rrotulloi sytë i habitur pa kuptuar asgjë. Mehmet pasha i trubulluar edhe më shumë nga ai ur-

dhër i çakërdisur që sapo dha, vazhdoi: — Merreni, hiqeni, hiqeni shpejt!, — e ndëri dorën që i dridhej drejt djalit të vogël.

Të gjithë sa ishin në dhomë iu lëshuan kufomës dhe e rrëmbyen në çast. Po pashës ajo fytyrë e tretur fëmije i mbeti për shumë kohë përpara syve. Në të shkriheshin pafajësia dhe një egërsi e çuditshme për atë moshë.

Doli në dritare që të mbushej me ajër. Përreth vesh-troi male të zhytura në mjegull. Iu duk sikur ata i zunë frymën me madhësitinë e tyre të përjetshme.

## DASHURI DHE HIJE

Gruri kishte filluar të piquej. Një fshatar shkoqi një kalli në pëllëmbën gjithë kallo e plasa, u fryu halave dhe i hodhi në gojë, pastaj, duke u përtypur, vështroi pak më tej. Përpara tij ngrihej ndërtesa e fabrikës. Nga brenda vinin zërat e montatorëve, hekuri që kërciste nën goditjet e çekiçit dhe drita e saldatriçes që vetëtinte hope-hope. Atje larg muzgu kishte rënë ngjyrë plumbi mbi kodrat e Tiranës. Luani u la shpejt dhe doli.

Autobusi nuk u vonua, por ato pak minuta atij iu dukën shumë të gjata. Zbriti në stacionin e parafundit, e kaloi rrugicën me hapa të shpejtë, shtyu portën e një shtëpie njëkatëshe rrethuar me një kopsht të vogël dhe vetëm në oborr hapat i hodhi të matur.

Duke hequr këpucët në korridor, Luani dëgjoi zërin e Zhanit. Zemra filloi t'i rrihte më fort, kurse gishtat po i ngatërroheshin në lidhëset e këpucëve.

Sapo hyri, ndeshi vështrimin e saj. Sytë e saj të qeshur, vështrimi i saj plot dashuri e mbushën me gëzim. U shtrëngoi dorën vjehrrit dhe kunatës, pastaj shtrëngoi edhe dorën e saj, duke e vështruar nga afër. Iu duk sikur bashkë me atë vështrim u derdh brenda tij një valë ngrohtësie.

— Do të shkojmë në kinema me Dhimitrin dhe me Vjollcën, — i pëshpëriti shpejt ajo duke dalë nga dhoma.

— Ku është Dhimitri?

— Ja, do të vijë tani, ka shkuar të presë biletat.

Kur u ul, ai vuri re se kunata diçka i tha të atit dhe të dy ata vështruan si vjedhur këmbët e tij. Uli sytë dhe atëherë vuri re se njëra nga çorapet ishte grisur në nyje të këmbës. Ai kishte harruar t'i ndërronte.

— Ma ka djegur një xixë saldimi, harrova t'i ndërrroja, — belbëzoi ai duke u habitur edhe më shumë.

I vjehri gogësiu, kurse Vjollca vështroi diku në tavan. Hyri Zhani dhe, kur e pa ashtu të skuqur e me sy të egërsuar, i buzëqeshi. Ai u zbut në çast, por pa dashje shtrëngoi dhëmbët duke parë shprehjen e fytyrës së Vjollcës.

— Luli, çohu shpejt, nuk kemi kohë, — tha duke futur kokën Dhimitri. — Zhani, ti je gati?.. Hajde luaj, Vjollca, shpejt, se s'ka kohë!..

... Pas filmit ata e bënë rrugën të heshtur.

— Natën e mirë!, — tha ftohtë Vjollca. — Shkoni drejt në shtëpi, Zhani, se u bë vonë dhe kush e dëgjon pastaj babanë.

— Mos u merakos ti, — i tha i shoqi.

— Natën e mirë!, — e preu shkurt Luani dhe e tërhoqi Zhanin pas vetes.

— Është harbut, — i tha Vjollca Dhimitrit. — Nuk është e mundur ta durosh. Zhani, që është aq e edukuar vajti e u pleks. . .

— Pusho tani!, — ia preu i shoqi. — Na plase me këto budallallëqet e tua. S'të duhet ty të përzihesh në ca gjëra që u takojnë vetëm atyre. Për ty, çdo njeri që s'të vjen pas avazit, është harbut.

— Më vjen të pëlças, u rrëmbye menjëherë ajo, — i thashë të zmadhonte ca fotografi që të merрте ndonjë lek, ma preu që nuk donte të prishte dorën. Pikaava, kush nuk do të prishë dorën, na e mban veten piktor, hamalli!



— Pusho, të marrtë dreqi!... Një avaz dhe ti.

— As orë nuk i solli, asgjë prej gjëje nuk i solli. Pse, ç'është Zhani?! Bythëgrisuri, vetëm të shesë mend di. Tridhjetë mijë lekë i dha një shoku dhe mbeti pafille për vete. Ç'më duhet mua se iu dogj shtëpia shokut. Unë doja që, kur të fejohej me time motër, të fejohej si gjithë njerëzit.

— Pusho, more vesh, pusho!, — thirri Dhimitri dhe përplasi derën pas vetes.

Vjollca nuk foli. Hëngrën bukë në heshtje dhe pastaj të heshtur u shtrinë në të njëjtin shtrat, njëri me fytyrë nga muri, tjetri me vështrimin të mbërthyer diku në një pikë të tavanit.

\*

\* \* \*

Luani i shtrëngoi dorën Zhanit. Ndihej i lumtur. De-ti ishte i kaltër dhe qielli pa asnjë re. Ai mori frymë thellë.

Ajo tani ishte e tija, por ai prapë se ç'ndiente një boshllëk. Me sa dukej lumturia s'mund të ishte ndryshe. Iu kujtua dita kur kishin mbetur vetëm, në shtëpinë e një shoqes së saj. Ai e kishte puthur krejt papritur. Zhani ishte habitur aq shumë, sa ishte shtangur, pastaj kishte vështruar përreth si të kishte pasur frikë se mos e kishin parë. Kur kishte hyrë në dhomë Leti me një shegë në dorë, Zhaneta dukej shumë e tronditur, ndërsa Luani, ndonëse hiqej krejt i qetë, e humbi dhe ai. Leti e kishte vënë re tronditjen e tyre, por me zgjuarsi ishte sjellë krejt e shpenguar, dhe vetëm disa çaste ishin dashur e gjithçka ishte stabilizuar. Pastaj ata kishin dalë të dy dhe

Luanit i kujtohej mirë se sa i kishte rënduar heshtja në stacion.

— Autobusi, — i kishte thënë ajo.

— Aha, autobusi, — kishte përsëritur Luani dhe kishte hipur pas saj. Zhani ishte drejtuar nga faturinoja dhe i kishte zgjatur lekët. Atëherë Luani e kishte mbledhur veten. I kishte zënë dorën dhe i kishte thënë:

— Jo, biletat do t'i pres unë. — Njerëzit i kishin shtyrë nga prapa dhe ata kishin shkuar përpara. Ai akoma ia mbante dorën shtrënguar në të vetën. Zhani kishte ngritur sytë dhe i kishte thënë serioze:

— Lëshoma dorën!

Vështrimi i saj për pak e kishte çarmatosur, por megjithatë dorën nuk ia kishte lëshur.

— Pse? . . ., — i kishte thënë. — Unë po mbahem. — Ajo kishte qeshur, po kishte qeshur nga inati se s'kishte pasur ç'të bënte.

— Mirë, — i kishte thënë, — do të pendohesh.

Luani kishte thënë me vete: «Punë e madhe. Në qoftë se më do, do të vijë patjetër prapë, në rast se s'më do, aq më mirë që ndodhi kështu». Kur u ndanë, ajo i kishte thënë:

— Në rast se ti do të sillesh edhe një herë kështu si sot, me mua. . . ta dish. . .

— Mirë, mirë, — i qe përgjigjur dhe qe larguar para se ajo ta mbaronte fjalën.

Pastaj herën tjetër ai e kishte puthur. . .

— Ç'po mendon ashtu?, — ia ndërpreu fillin e mendimeve Zhani. — Si thua, hyjmë në det?

— Jo, rrimë edhe pak. Sapo dolëm nga deti, — i tha ai, Zhani vuri buzën në gaz.

— Ti më do shumë, Luan. . ., — tha ajo.

Ai nuk foli, vështroi përsëri gjithë trupin e saj, flokët e lëshuar e të lagur, kokrrizat e rërës ngjitur te supi dhe psherëtiu lehtë.

«Jo, — tha pastaj me vete, — duhet gjetur një fjalë tjetër, me siguri duhet gjetur një fjalë tjetër,» — dhe e hodhi vështrimin larg në kaltërsinë e detit të pafund. Dhe atë çast iu duk sikur ajo hapësirë e kaltër e shkumëzuar nga valët i ngjante ndjenjës së tij. Por ai kurrë nuk do t'i thoshte asaj të tilla fjalë. Shpesh ato që na duken të bukura, kur i themi me vete, bëhen fare qesharake, kur ua themi të tjerëve.

— Ç'ke sot kështu ti?, — e pyeti ajo dhe i ledhatoi dorën. Ai u rrëqeth. I dukej sikur do të qante dhe pikërisht për këtë qeshi. Zhani e vështroi krenare dhe e ndjeu gjithçka që ziente tek ai. E ndjeu tërë dashurinë e tij që ia kishte kyçur gojën atë ditë.

Pak më tej një djalë i ri ia kishte qepur sytë asaj.

Një grup djemsh, që kaluan aty pranë, kthyen kokën dhe e panë me vëmendje. Zhaneta gati sa nuk fluturoi nga lumturia!

Nuk kishte më pikën e dyshimit, e motra kishte të drejtë.

Zemra filloi t'i rrihte fort dhe ndjeu një farë dehjeje.

— Hajde ngrihemi, Luli, bëjmë një shëtitje. . .

— Jo, mirë jemi këtu, — tha ai i dehur nga dëshira për të ndenjtur pranë saj dhe vetëm me të ndërsa ajo, e dehur nga bukuria e saj, donte të lëvizte sa më shumë.

— Hajde, hajde! . . ., — iu përkëdhel si mace dhe e tërhoqi për dore. Luani u ngrit dhe të dy filluan të ecnin buzë detit.

Një erë e lehtë ngriti miliarda valë të vogla mbi sipërfaqen e lëmuar të detit. Më vonë ato valë i ngritën më shumë shpinat e tyre të kaltra e u derdhën me zhurmë në ranishten e lëmuar. Vetëm vonë, kur po perëndonte dielli, era u qetësua dhe deti u bë ashtu siç ishte në mëngjes, fare i palëvizur, por ishte vonë dhe u duhej të nxitonin për të arritur trenin.

Që atë ditë Zhaneta filloi t'i vinte re më shumë vështrimet e djemve, të mbante vesh se ç'flisnin ata, ta dëgjonte Vjollcën më me ëndje. Bile filloi t'i vinte plasje, kur dikush nuk e vinte re prezencën e saj. «S'i kanë sytë në ballë?». Një pasdite mbeti pothuaj dy orë përpara pasqyrës. Vështronte fytyrën, sytë, këmbët, kofshët, veshi fustane pas fustanesh, u zhvesh e u vesh me rroba banjoje dhe për të gjitha rastet e vështroi veten me hollësi.

«Po, po, motra ka shumë të drejtë», — dhe iu mbush mendja përfundimisht se dashuria e Luanit ishte e paktë. Iu mbush mendja se bukuria e saj duhej të sundonte pa diskutim.

— Mos u sill keq me Vjollcën!, — i tha një ditë Luanit prerë, në formë urdhri.

— Unë kurrë nuk jam sjellë keq me të, — i tha ai dhe iu afrua e e kapi për beli.

— Ç'bën, se mund të vijë mamaja, — i tha ajo e pakënaqur dhe iu shkëput nga krahët.

— Mamaja është poshtë, ne e dëgjojmë kur të ngjitë shkallët, — dhe ia hodhi përsëri duart rreth belit.

— Ik pra tani, pse bëhesh i mërzitshëm?

— I mërzitshëm?! — Fytyra e Luanit në çast u err. Por ajo e kapi menjëherë shprehjen e syve të tij dhe pasi i dha një të puthur të shpejtë, e qeshur doli me vrap nga dhoma.

\*

\* \* \*

— Ti duhet ta nënshtrosh atë. Ai të vijë pas teje dhe jo ti pas atij. Ai është i krisur, për të është e nevojshme që të ketë një dorë qe ta drejtojë, — i tha një ditë Vjollca, kur po rrinin të dyja në kopsht. — Pa thyeja një herë,

do të shohësh se si do të të vijë pas si manar. Mos u tremb po u zemërua, mos u tremb edhe po iku, prapë vetë do të vijë. Bukuria jote, jo atë, por edhe tigrin e bën të butë.

Zhaneta u mësua me këto arsyetime, bile tani ato sikur e përkëdhelnin, sikur e kënaqnin dhe, në fund të fundit, Vjollca kishte të drejtë dhe të mirën i donte, se motra e saj ishte, nuk ishte bota. Dhe ja një ditë plasi ajo që pritej. Gjithë urretja e Vjollcës e grumbulluar në heshtje, plasi si bombë për hiçgjë.

— Ti nuk do ta marrësh motrën time!, — i thirri ajo flakë e kuqe në fytyrë Luanit. — Nuk do ta marrësh, sikur dhëmbin kaq ta bësh. Ti je njeri pa edukatë. Gjithmonë kështu ma bën, mama.

— Pusho, se është turp!, — iu kanos e ëma e zbehur në fytyrë nga tronditja.

— Gjithmonë kështu ma bën, mama.

— Ti vetë do të grindesh, — i tha i zbetë Luani. — Unë nuk të thashë asgjë me thumb, unë të fola fare pa djallëzi. Por ti, ku e di unë si e ke hallin!..

— Ti nuk do të martohesh me motrën time sa të jem unë gjallë!, — vazhdoi ajo dhe sytë iu mbushën me lotë. — Kurrë nuk do ta lë unë të bëhet ajo gruaja jote. Të jesh i sigurtë për këtë!..

— Pusho, moj korbë, se është turp, ç'bën kështu?, — thirri e ëma.

Një çast sherri u mbyll dhe u duk sikur me kaq mori fund, por Vjollca, si të ishte kujtuar, papritur thirri duke u dredhur:

— Ke një vit i fejuar, çfarë i ke sjellë ti asaj? Më thua, çfarë i ke sjellë? Pse, si kujton ti, nuk i vjen turp asaj nga shoqet?... Opingën e Sheros i ke sjellë!.. Vetëm llafe i ke sjellë, vetëm teorira dhe filozofira!..

— Ti mos ndërhy atje ku nuk të takon, — tha me një fije zë Luani i zbetë në fytyrë.

— Ja, mbaje mend këtë që po të them. Ja, ashtu siç jam e sigurtë që do të pi këtë kafe që po ftohet në tryezë, ashtu jam e sigurtë që do të të ndaj nga Zhani, se ajo, sa më do mua, nuk të do ty.

— Ti për asgjë nuk mund të jesh e sigurtë. — Luani u ngrit në këmbë me rrëmbim. — Edhe për këtë kafe nuk je e sigurtë... Ai ia rrëmbeu filxhanin dhe e përplasi në çimenton e ballkonit. Porcelani u bë njëqind thërrime, kurse kafeja u përhap e zezë në çimento.

— Ja, më në fund e tregove veten se sa injorant je!, — tha ajo dhe i shkëlqyen sytë nga një gëzim i egër.

— Ti je e poshtër!, — tha Luani dhe u largua me hapa të shpejtë.

Zbriti shkallët me rrëmbim i nxehur më tepër me veten se me Vjollcën. I vinte plasje. Kishte rënë plotësisht në kurthin e saj. Përpara syve i shihte ende sytë e saj me një gëzim të keq. Ajo ia kishte arritur qëllimit, e kishte nxehur dhe më në fund ai e kishte humbur kontrollin e vetvetes. Ishte treguar ashtu si kishte dashur ajo.

«Pse vallë, ç'dreq ka me mua?, — tha ai me vete dhe me duar në xhepa, i humbur në mendime, po ecte ngadalë.

— Hë, Luan, — i foli Dhimitri dhe ai për një çast u ndodh aq në befasi, sa u tremb.

— Hiç, asgjë nuk kam. — Luani u mundua të buzëqeshte për të fshehur tronditjen, pastaj mendoi: «Po sikur t'ia them këtij?». Por në çast ndërroi mendim dhe heshti.

— Zhani nuk ishte në shtëpi?

— Jo, atje ishte.

— Po pse nuk dole me të?

Ai nuk diti si të përgjigjej, por pastaj e mblodhi veten dhe tha:

— Ç'është e vërteta, unë nuk i thashë...

— Mos u grindët? — Dhimitri ia mbërtheu sytë me një dashamirësi aq të thellë e të sinqertë, sa që e mallëngjeu Luanin. — Mos u mërzit, kështu e kanë këto punë. Edhe ndonjë grindje të vogël do të ketë, ndryshe nuk ka kuptim, po hajde, hajde, kthehemi të dy dhe e marrim bashkë.

— Jo, jo, falemnderit, Dhimitër. Më dhemb ca koka. Dua të shkoj të shtrihem në dhomë.

— Mirë atëherë, si të duash. Mirupafshim!

— Mirupafshim!, — u përgjigj Luani dhe i shtrëngoi dorën.

Sapo hyri në oborr, Dhimitri dëgjoi zërin e së shoqes. Ajo fliste me nerva dhe fjalët ia ndërprisnin dëncsat. Dhimitri mbajti këmbët.

— Jo, kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë. Kësaj i thonë të hash bukën e të përmbysësh kupën. Ç'do të thotë kjo, ç'do të thotë? Mos qaj, de, tani, mjaft!

Dhimitri njohu zërin e të vjehrrit.

— Edhe ti, dëgjove, të bukur dhëndër na solle në shtëpi.

— Mirëmbrema!

Me të hyrë i shoqi, Vjollca ndërroi pamjen e fytyrës dhe fshiu lotët. I ati e ndërpreu bisedën. Zhani psherëtiu.

— Ç'ke ti?, — e pyeti ai Vjollcën.

— Ç'të ketë?!, — u përgjigj në çast i vjehrrit. — Vetëm se nuk e rrahu ai i çmenduri.

— Ta kishte rrahur, do të kishte bërë shumë mirë, — u përgjigj tërë inat Dhimitri, duke e marrë me mend se flitej për Luanin. — Ç'punë ke ti me të, moj?... Ç'përzihesh ti në punët e tyre?... — Pastaj iu kthye tjetres: — Zhani mos e dëgjo këtë, mos e dëgjo, nëse s'do të marrësh veten në qafë.

— Mirë thotë, — u hodh atëherë plaka, që kishte

heshtur deri atë çast. — Ti vetë ia solle në majë të hundës. Ti qe shkaku i sherrit. Ai asgjë nuk të tha në fillim. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt. Ti vetë i re në qafë.

— Pusho, moj ti, aty! na u hape edhe ti si vaji në uthull!, — iu kanos i shoqi plakës.

— Jo, nuk pushoj, mjaft të kemi dëgjuar ty gjithë jetën.

— Pusho, se t'i thyej turinjtë, dëgjon apo jo?, — iu hakërrye plaku.

— E di unë kush i ka fajet për të gjitha këto, e di unë kush është e zonja të ngatërrojë një dynja të tërë.

Dhimitri, i zbetë, po vështronte Vjollcën. Kurse ajo nuk ndihej, vetëm filloi të qante përsëri në heshtje.

— Çdo gjë ka një farë kufiri, — foli plaku, pa vështruar asnjërin. — Jo, të tilla gjëra... s'lejohen, të flakësh filxhanin e kafesë e ta bësh copa-copa. Ç'do të thotë kjo? Sado faj të ketë Vjollca, sado faj të ketë, kjo është e pajustificueshme!...

— Hajde!, — i foli së shoqes Dhimitri. — Natën e mirë!, — dhe doli në oborr. Vjollca hodhi trikon supëve dhe doli menjëherë pas tij.

Një copë rrugë e bënë të heshtur.

— Pse i ngatërron këto gjëra?, — foli ai pa e ngritur zërin.

Ajo nuk u përgjigj.

— Dëgjo këtu: mos e merr tët motër në qafë, se është gjynah. Luani nuk është djalë i keq. Ti nuk ke për të jetuar me të. Në s'të puqet ty karakteri, kjo s'prish asnjë punë. Mos ia shkatërro jetën sat motre për të plotësuar një teke tënden. Mos e bëj këtë, se do të të vrasë ndër-gjegjja më vonë. Besomë mua, se do të pendohesh dhe do të të kujtohen fjalët e mia.

Dhimitri heshti dhe e shoqja nuk foli më. Të dy vazhduan rrugën pa shkëmbyer asnjë fjalë. Një dritë neon



dridhej mbi një shtyllë gize të përkulur. Ajo dridhej e dridhej, si të jepte sinjale telegrafike. Dhimitri psherëtiu, i kapi krahun së shoqes dhe e afroi nga vetja. Ajo e vësh-troi e qeshur, por në thellësi të syve të saj kishte ende shkrep-tima të një zjarri që nuk shuhet lehtë.

\*

\* \* \*

Ç'është e vërteta, e motra kishte ca të drejtë. Pse vi-shej ashtu Luani? Ai lekë merrte mirë. Kostumi i tij ish-te vjetëruar dhe moda e tij kishte fluturuar me kohë. Këpucët nuk i kishte elegante. Ai e kishte mendjen vetëm te bojërat e tubetat. Gjithë lekët i bënte bojëra e tubeta. Si s'i kishte vënë re ajo këto gjëra më përpara, kurse Vangjeli, ç'është e vërteta, rrinte king. Kostumi, këpucët, këmisha, kravata, të gjitha shkonin aq mirë me njëra-tjet-rën, sa kishe qejf ta shikoje.

«Pastaj edhe babai ka një farë të drejte, — mendoi ajo. — Gjithë jeta nuk shkohet me tralalala. Njeriu i mençur bën gjithmonë llogari». «Po të martohesh me Lu-anin, — i kishte thënë ai, — do të jesh një grua punë-tori. Kurse me atë tjetrin ndryshon puna. Shtëpinë e tij e ka vilë. Televizor ka. Është doktor.»

— Pse mendohesh?, — e pyeti ai.

— Hiç kot.

Asaj iu mor goja. I buzëqeshi si të kishte frikë se ai po ia lexonte mendimet. Por Luani s'kishte se si t'i le-xonte mendimet. Buzëqeshja e saj e bëri menjëherë të gëzuar. Por ai përsëri ra në trishtim. E ndiente që diçka nuk ecte si më përpara. Buzëqeshja e saj u shua dhe u bë përsëri e menduar.

— Ç'ke, Zhani?, — filloi ai me zjarr. — Nuk ke be-

sim tek unë? Në janar do të marrim shtëpi. Do të martohemi që atë ditë.

— Po si do të martohemi?, — tha ajo me druajtje.  
— Ne s'kemi gjë prej gjëje.

— Vërtet mërzhitesh për të tilla gjëra, Zhani?...

— Ah, Luli!, — e ndërpreu ajo pa e mbaruar mendimin. — Luani vështroi drejt në sytë e saj të hirtë. Ç'kishte ajo? Kush ia prishte gëzimin asaj?

— Ç'është kështu me ty, Zhani? Ti nuk ke pasur mendime të tilla. Më fol pa druajtje, më fol me zemër të hapur, si e ke hallin?

Ajo uli sytë, rrotulloi një çast në dorë gotën e birrës, psherëtiu, ngriti sytë e nisi të fliste e zymtë:

— Ti e di, Luli, që babai nuk donte të fejojeshim bashkë. Unë bëra të pamundurën dhe më në fund e binda. Ti vete ngatërrohesh me Vjollcën. Nuk e di, Luli... Ti, po të më kishe dashur mua, patjetër duhet të tregohesh më i përmbajtur. Ti vajte e hodhe filxhanin e kafesë në çimento në sytë e nënës. Ata më thonë tani se si mund të jetoj me një njeri të tillë. Babai thotë që ti do të më rrahësh që vitin e parë të martesës. Ai në asnjë mënyrë nuk pranon.

— Shiko, Zhani, unë mbase bëra shumë gabim atë mbrëmje, por ajo më shtyu, ajo...

— Oh, Luli, për çfarë flas unë e përse më flet ti!...

— Në fund të fundit, mua s'më duhet gjë me ata, — mori zjarr Luani. — Ti, më thuaj ti, mendimin tënd, ma thuaj copë, pa druajtje.

— Ç'të them, Luli, edhe unë nuk e di si të bëj, nuk shkohet kundër gjithë familjes.

— Të dy heshtën gjatë. Tingulli i kitarës vinte nga orkestra me një notë çuditërisht të dhimbshme. Të paktën kështu i dukej atij.

— Po, vërtet nuk shkohet kundër gjithë familjes, ke

të drejtë, — tha Luani dhe vuri buzën hidhur në gaz. — E kuptoj shumë mirë. Ti kohët e fundit ke ndërruar krejt. Ne rrinim bashkë e unë nuk dija ç'të thosha, si të kishte shterur gjithçka. Qëndrimi yt, po nejtse, nejtse... — Ai psherëtiu, e ktheu gotën e birrës deri në pikën e fundit, pastaj vazhdoi duke vështruar nga pista e vallëzimit, diku në një pikë në hapësirë.

— Kuptohet që ti do të ndahesh nga unë, po nuk më thua dot. Kjo është e vërtetë, po, po, kjo është e vërtetë.

Zhani nuk foli. Luani nuk e priste këtë. Ai i tha vërtet ato fjalë, por mendoi se ajo do t'i kundërshtonte me zjarr. «Domethënë mbaroi?», — mendoi ai dhe ia qepi sytë fytyrës së saj. Iu duk krejt e huaj dhe e ftohtë. Për pak desh e kapi për supesh e ta shkundte me tërë fuqinë, si të donte ta zgjonte. Nuk po i besohej. Por Zhani e ngurosur i qëndronte pranë pa guxuar ta vështronte, si një copë mermer i skalitur në lashtësi, që vështron gjithçka me indiferentizëm. Ai e ndjeu se po i merrej fryma. Ndjeu se po i dhembte fyti dhe po i digjnin sytë.

Për të fshehur tronditjen, filloi të kollitej i përkulur anash. Pastaj me një sforcim të egër i dha fytyrës një shprehje të ftohtë dhe tha me një zë, që iu duk si i huaj:

— Çohemi!..

Dolën të dy pa folur. Rrugët kishin mbetur pothuaj të shkreta.

Ndaloj autobusi. Luani preu biletat dhe iu afrua asaj. Iu duk çuditërisht e huaj. Sytë e saj të hirtë vështronin ftohtë përtej xhamit. Atij i kaluan të rrëqethura në trup... Jo, ajo nuk ishte Zhani, ai nuk ishte vështrimi i saj. Ndjeu përsëri t'i digjnin sytë e t'i merrej fryma.

Autobusi u ndal dhe ata zbritën. Tani ecnin në rruvicën e errët, ku ai e puthte me zjarr, sa herë e përcillte për në shtëpi. E kaluan të heshtur. Ja edhe porta e saj e hekurt. Luani u ndal. Edhe Zhani u ndal dhe iu afrua.

— Natën e mirë!, — tha ai dhe u kthye me rrëmbim.

Kjo e goditi Zhanin krejt papritur. Ajo sikur u zgjua në çast. Për pak thirri «Luan». Deshi të vraponte pas tij dhe ta arrinte. Por përsëri ra në plogështinë e ditëve të fundit. Muskujt nuk iu bindën dhe mbeti ashtu e palëvizur. Hapi ngadalë derën dhe hyri e zyrtë në shtëpi.

— E, si u bë?, — e pyeti me ankth e motra.

— U ndava!

— Të marrsha të keqen. Zhani, të marrsha të keqen!...

Vjollca e puthi disa herë. Zhani për herë të parë vuri re në sytë e së motrës një gëzim që iu duk i lig. Por mbase ishte tepër vonë. Ajo tani kishte hyrë në një valle dhe këmbët i hidhte mekanikisht si një somnambul. Përpara saj hapej një rrugë tjetër. Në mjegullën e ëndërrimeve iu shfaqën turbull dy tablo: njëra i përkiste së kaluarës. Ajo ishte fare e thjeshtë, tjetra ishte e panjohura që e priste. Duke u zhveshur, dëgjoi të motrën që thirri:

— Baba, do të të jap një lajm të mirë, baba!...

\*

\* \* \*

— Do të të kalojë, — i thoshte e motra dhe ajo mendonte se Vjollca kishte të drejtë. Patjetër do t'i kalonte. Vërtet ca kujtime nuk e linin të qetë, por fundja kujtime ishin. Dhe kujtimet tremben e zbehen me kalimin e kohës. Por edhe s'tremben kujtimet. Ndonjëherë ato janë shumë kryeneçë e të guximshëm. Sa çapkëne janë, aq edhe të prapa janë. Ato të vijnë kudo. Me vend e pa vend. Ato futen në shtrat bashkë me ty. Fshihen nën fushën e një ore të bukur grash. Futen ndërmjet një së pu-

thure të ftohtë. Trazohen me mendimet e tua. Ta turbullojnë gëzimin e s'të lënë të qetë. Dhe janë aq të fuqishme ndonjëherë ato, që bëjnë akull çdo gjë. E si të mos jenë të fuqishme. Janë copëza jete. Copëza nga jeta jonë që lamë pas.

\*  
\*   \*  
\*

Zhani, e mbështetur në krahun e Vangjelit, psherëtiu.

— Çfarë ke, Zhani? — Ai e vështroi nga lart. — Sonte kemi një kanconisima të shkëlqyeshme: Xhani Morandi, Milva, Iva Zaniki, Luçio Dala, Mikele. Sonte do të kënaqemi...

Po Zhani vetëm sytë mbërtheu atë mbrëmje në ekran. Kujtimet dilnin përpara ekranit e nuk e linin të shihte. Ato i nxirrnin gjuhën Milvës e talleshin me mjekrën e Luçio Dalës. I shkelnin syrin Zhanit dhe e përqeshnin kur ajo psherëtinte.

— Ti ke të ftohtë?, — i tha Vangjeli kur po e përcillte për në shtëpi dhe i hodhi krahun e e shtrëngoi pas vetes. Rrugica ishte e errët si çdo natë. Ai e ktheu dhe e puthi.

— Do të vish nesër, Zhani? Nesër do të vish patjetër.

— Mirë, do të vij, — i tha ajo dhe u shkëput. — Jo këtu, se mund të na shohin.

— Ke të drejtë, Zhani, më fal, Zhani, por vetëm eja, Zhani!

— Jo, jo..., — dhe ajo uli dorezën e portës.

Babai e priti Vangjelin duke i shtrënguar të dyja duart. Pastaj të dy filluan biseda shkencore.

Zhani shkoi në dhomën tjetër dhe filloi të zhvishej. «Do të më kalojë, — tha ajo, — patjetër do të më kalojë».

Dhe pikërisht të nesërmen e asaj mbrëmjeje, Zhani e pa Luanin në rrugë. Ai kalonte përpara kinema «Republikës», në anën tjetër të bulevardit. Ishte i parruar, me rrobat e punës, shumë i zymtë. I theri në zëmër asaj dhe diçka iu mblodh në grykë. Zhanit iu mbushën sytë me lotë dhe vrapoi për në shtëpinë e së motrës aty pranë.

— Ç'ke, — i thirri e tmerruar Vjollca sapo e pa. — Babai?!... Babai?! Fol, fol!...

— Ah, jo, Vjollca. Ç'bëra unë, Vjollca!... Unë e dua atë, e dua Luanin, e dua, — klithi dhe u përmbys mbi kanape.

— Ti je e çmendur, — belbëzoi Vjollca, duke u dridhur e tëra. — Më ngriu gjaku, pandeha për babanë. — E vështroi duke vënë lehtë buzën në gaz me cinizëm, pastaj iu afrua, e përkëdheli te supet dhe i foli ngadalë:

— Budallaqe, mërzitësh kot. Nuk na kishte hie ne kru-shqia me një capacuq. Ti tani do të jetosh si zonjë, nuk do të të mungojë asgjë, nuk thua shqyrr që ndodhi ashtu?...

Zhaneta u ngrit përgjysmë. Në fytyrën e ngrirë dhe lotët sikur ngrinë në mollëzat e saj një çast.

— Po, — u përgjigj me zë të shuar ajo. — Vërtet asgjë s'do të më mungojë... Vetëm dashuria.

## PELLGU

Isha përkulur mbi një elektromotor dhe po mundo hesha të hiqja pulexhën. Brigadieri më erdhi njëherë rrotull, u mat dy-tri herë të më thoshte diçka, pastaj, si i penduar, papritur qe larguar.

«Ç'të ketë ky?», — thashë me vete duke e vështruar tek po largohej. Por ai, si të donte të mos e linte pa përgjigje pyetjen time, u kthye përsëri, vështroi një copë herë elektromotorin, pastaj belbëzoi:

— Si thua ti, Luan, shumë vajzë e mirë kjo Vjollca, eëë, si thua?

E vështrova i habitur dhe vura re se ai nuk pyeste kot. Ishte si i hutuar dhe dukej sikur kishte diçka shumë të rëndësishme për të thënë, pastaj, nuk më shkante ndër mend që të më fliste për Vjollcën.

— Hë, si thua?, — më pyeti përsëri si të priste një përgjigje vendimtare, sikur nga fjala ime varej se vlen-te a nuk vlen-te Vjollca.

— Shumë vajzë e mirë është, — i thashë.

— Kam një nip, — mori zemër ai nga përgjigjja ime duke më vështruar drejt në sy, — them t'ia bëj atij.

Kafshova buzën e poshtme nga brenda që të mos ia shkrepja të qeshurit. Ula sytë mbi motorin ku punoja dhe për një çast e ndjeva veten si mbi gjemba, pastaj as vetë nuk e di si i fola krejt vetvetiu:

— Lëre, o xha Riza, lëre nipin ta gjejë vetë nusen.

Brigadieri im nuk është aq i vjetër, por kështu i thërrsin të gjithë, mbase nga flokët që i janë thinjur para kohe.

Ai nuk foli. Vura re që u pre në fytyrë. Si duket prishte që unë t'ia aprovoja planin që kishte ndër mend.

— Jo xhanëm, — unë kot thashë, — vazhdoi ai shumë i penduar që ma kishte hapur këtë bisedë. Pastaj pas pak u largua. Unë qesha. «Djall, o punë», — thashë me vete dhe m'u kujtuan ditët e para kur erdhi Vjollca.

Xha Rizai ishte hedhur përpjetë, nuk donte në asnjë mënyrë që ajo të vinte në brigadën tonë.

— Edhe fustani na duhej, — tha ai, — po, po... tani marrim edhe një që t'i bjerë muzikës dhe tym të bëhet. Ballo duan çunat, po, po. — I shkoi nëndrejtorit në zyrë, i tha se nuk ishin vajzat për punë me hekura, i tha se i kishte të gjithë të rinj e se do të binin pas saj e do ta merrte djalli punën. I tha të mos e turpëronte tani në pleqëri, por, kur të gjitha këto nuk i pinë ujë, doli nga zyra e nëndrejtorit dhe për herë të parë në jetën e tij ndjeu ftohtësi për punën, plogështi dhe një revoltë të hidhur kundër atij «qeni» që ishte bërë sebeb që ia kishte sjellë atë vajzë në brigadë.

Hyri në oborrin e fabrikës, pështyu me inat përtokë dhe i ra fort një guri me këmbë, si t'ia kishte ai të gjitha fajet.

Pastaj xha Rizai u përpoq t'ia bënte Vjollcës gogol punën. E çonte në punët më të rënda. Një ditë arriti deri atje sa e bëri pellg me varvolinë si pa dashje, por vajza e heshtur si përherë i buzëqeshi. Kjo e vrau shpirtërisht xha Rizanë. Për herë të parë i erdhi keq për të dhe për herë të parë pranoi se ajo punonte me gjithë shpirt.

Nga ajo ditë xha Rizai, kuptohet, filloi të sillej ndry-



she me Vjollcën. Atëherë si duket i hipi në kokë ky mendim që sapo ma tha.

Kur dola nga puna, ai më vështroi vjedhur si të donte të më blinte mendimet. Disa ditë më vonë kjo histori pothuaj u harrua krejt dhe çdo gjë vazhdoi si më parë. Vetëm ndonjëherë, kur unë bisedoja me Vjollcën, ai dukej i shqetësuar dhe sillej aty vërdallë për të kapur ndonjë fjalë nga bisedat tona. Kurse mua më qeshej, se e merrja me mend ç'mendonte ai. Po kurrë nuk ia zura Vjollcës në gojë atë që më tha xha Rizai. Mendova se ai i kishte vënë kryq atij muhabeti dhe pikë.

Sigurisht që kurrë nuk do ta kisha marrë me mend atë që ndodhi pas disa ditësh sikur vetë xha Rizai të mos më kishte futur në brendësi të çështjes.

Pashë në oborr një mesogrua dhe një djalë rreth 22 a 23 vjeç që prisnin dikë. Të dy nuk i nxinte vendi, kërkonin me sy sa në njërën anë në tjetrën. Bisedonin të shqetësuar dhe gruaja, me sa dukej e ëma e djalit, herë pas here i rregullonte të riut jakën e këmishës, kollaren, a i hiqte ndonjë qime nga kostumi. Kishin edhe një vajzë të vogël me vete. Vajza m'u afrua dhe po vështronte me kureshtje veglat që kisha unë në duar.

— Kë kërkon?, — e pyeta.

— Xhaxhanë, — tha ajo.

— Si e quajnë xhaxhanë tënd?

— Riza Sula.

— Hajde, Alma!, — e thirri gruaja vajzën e vogël. Në këtë çast djali i ri u afrua dhe zuri vajzën, me një dorë e ngriti përpjetë dhe më vështroi mua si të donte të tregonte që nuk ishte vetëm i pashëm, por edhe i fuqishëm.

Menjëherë më shkoi mendja te biseda e shkurtër që kisha bërë para disa javësh me brigadierin tim. Hyra në oficinë.

— E ke parë Vjollcën?, — më pyeti një mekanik.

— Jo, pse?

— E kërkonte brigadierin. ., ja, e paska gjetur.

Xha Rizai ishte i tronditur, kurse Vjollca dukej krejt e qetë. Nuk e di pse filloi të më rrihte zemra fort dhe e ndjeva se u zbeha. Pata përshtypjen atë çast se asaj po i punonin një grackë. Unë e dija se ajo donte një djalë dhe të dy e donin shumë njëri-tjetrin. Unë e dija se ata nuk kishin ç't'i bënin asaj, se ajo është vajzë e zgjuar dhe e pjekur. Unë e dija se përçapja e xha Rizait ishte qesharake dhe do të dështonte patjetër, por megjithatë isha i tronditur ato çaste. Më dukej sikur përpara syve të mi po e poshtëronin, po e mashtronin. Më dukej sikur kjo që po ndodhte po përlyente dashurinë dhe gjithçka të bukur të rinisë.

— Ç'ke, — më pyeti një shok.

— Asgjë, — thashë dhe dola me rrëmbim në oborr.

Djalit i qeshnin sytë nga kënaqësia. Gruaja e vështronte Vjollcën si një orendi që kishte ndër mend ta blite. Xha Rizai m'u duk si ata matrapazët që kam parë kur isha i vogël në pazarin e kafshëve. Vjollca buzëqeshte pa të keq. Ajo patjetër nuk e mernte me mend se nuk i kishte takuar rastësisht ata njerëz. Ajo ishte e çiltër dhe fare e qetë. Qetësia e saj filloi të më qetësonte dhe mua. Bëhesha kot budalla. E ç'mund t'i bënin ata asaj? E ç'mund t'i bënin ata dashurisë së saj? Ata ishin si një pellg me ujë të ndenjtur që herët a vonë do ta rrëmbente rrjedha e lumit a do ta thante dielli.

Kur kalova pranë tyre, xha Rizai u zbe edhe më shumë. Më kot u mundova të kaloja i qetë. Sytë më lëshuan xixa, kur vështrova sytë e tij që i përpëliteshin. I buzëqesha Vjollcës dhe u largova.

## A I

I vogël është qyteti ynë. Por megjithatë ai ka një stadium, një kinema, një shtëpi kulture dhe një estradë që herë pas here vë në skenë edhe ndonjë pjesë teatrale, sigurisht nga diletantë.

Rrugët këtu nuk janë të gjera, si bulevardet e qyteteve të mëdha. Pallate të reja janë ngritur, por tani po ngrihen edhe më shumë; edhe rrugët tani po zgjerohen. Po megjithatë ai për ne është shumë i bukur.

Kur je larg tij të merr malli. Nuk të hyjnë në sy as rrugët e gjera, as mrekullitë e zbukurimet e ndonjë qyteti të madh. Sa të dashura janë qoshet e rrugët e ngushta të qytetit tënd që të kujtojnë çapkënlleqet e ditët plot gjallëri të rinisë.

Ishin ditët e para të shtatorit. Tek isha duke shëtitur me Skënderin, mësova se Dragushi ishte ftuar nga estrada e qytetit tonë dhe kishte ardhur të këndonte dytri këngë. Përnjëherë mora me mend se sa kujtime do t'i zgjoheshin atij dhe sa të mallëngjyer do ta ndiente veten përpara publikut, që e kishte duartrokatur për herë të parë, po në atë skenë të vogël ku do të këndonte edhe sot.

Ai këtu ishte rritur. Më kujtohej këmbëzbathur, më kujtohej se si luanim me topa lecke me të. Pavarësisht se ai ishte bërë artist i dëgjuar tani, a nuk qemë ne që e brohoritëm atë më parë se kushdo. Prandaj ne kishim të drejt-

të që gëzoheshim atë ditë, kështu shpjegohet dhe prishja e radhës-përpara sportelit të biletarisë.

Pse ta fshehim, gjatë këtyre vjetve që Dragushi nuk është dukur asnjëherë në qytetin tonë, ne mund të kemi menduar edhe pak keq për të, por ja, ardhja e tij i copëtoi mendimet e këqija.

Më qeshet me veten time. Si mendoja unë se ai i kish-te harruar këto rrugë? Sado të mëdha të kenë qenë sallat ku ka kënduar ai në kryeqytet, ai nuk mund ta harrojë suksesin e tij të parë.

Skënderi, shoku im, i djersitur, por i qeshur, doli nga grumbulli me dy bileta në dorë.

— Të lumtë!, — i thashë. — Unë nuk do të kisha mundur të merrja.

— Më lumtë vërtet, — tha duke vënë buzën në gaz dhe zgjati dorën e më tregoi njerëzit që vazhdonin të sulmonin drejt atij kuadrati të vogël.

— Ngreje jakën, se do të ftohesh.

Skënderi ngriti jakën e palltos dhe shkuam e hymë në një kafene. Zumë një tryezë në një qoshe dhe po pritnim kafetë.

Po pinim kafetë, kur pashë që hyri Dragushi. Ishte me një vajzë të re. I hodhi një vështrim të shpejtë lokalit dhe u drejtua në një tryezë të lirë pranë nesh. E përshkoi sallën pa vështruar pothuaj fare përreth.

Porositi një kakao për vajzën dhe një dopio fërnet për vete. Vajza se ç'i tha si me qortim, por ai me sa dukej nuk ia vuri veshin. Pastaj dopion e parë e pasuan disa të tjera.

Nuk e di pse ndjeva të më hipte një avull në kokë, sikur fërneti që pinte ai vepronte tek unë.

Pashë Skënderin drejt në sy. Sytë e tij ishin ndezur. Futi ngadalë dorën në xhep dhe nxori biletat. E mora me mend se ç'donte të bënte ai.

— Mos!, — i thirra. — Pse t'i grisësh? Në nuk do të shkojmë vetëm për atë në shfaqje. Pastaj kam qejf të shoh a do të duartrokasim sot. — Pa dashje kisha folur me zë pak të lartë. Ai ktheu kokën dhe vështroi nga ne. Sytë e tij të turbulluar nga alkooli vështruan me përcimim. Por edhe ne nuk e vështruam me dashuri.

Pas pak Dragushi u ngrit dhe bashkë me atë vajzë doli pa vështruar njeri, ashtu si kishte hyrë.

Filloi të errej. Mua më zunë ca si ethe të një ankthi të pakuptueshëm. Më dukej sikur ai e kishte fyer qytetin tonë. Prandaj doja të dija se ç'qëndrim do të mbanin njerëzit me të. Të them të drejtën, unë atë mbrëmje dëshiroja dështimin e tij. Çdo gotë fërnet që kishte pirë ai, më dukej si një shi indiferentizmi rënë mbi rrugët tona.

«Ah, sikur t'i dinin këto gjithë ata njerëz që mbushnin sallën!... Ah, sikur ta dinin qëndrimin e tij karshi tyre!...» Po mendoja kur salla buçiti nga duartrokitjet, sapo doli ai.

Vetëm unë e Skënderi qëndruam si të ngrirë, mes asaj gjallërie të ndezur. Njerëzit duartrokisnin njeriun e tyre. Ata s'kishin faj. Ata nuk mund të dinin se çfarë mendime kishte ai për ta. Dragushi tani buzëqeshte dhe përkulej me respekt. Përkulej, përkulej vazhdimisht.

Pastaj publiku heshti dhe priti të dëgjonte këngën e tij. Por kënga e tij ishte si e mpirë dhe e çakërditur. Ai dukej pa forca. Dukej sikur nga çasti në çast do të shembej në dyshemenë e skenës. E mbuluan djersët. E kuptoi edhe vetë se po këndonte për faqe të zezë. Por publiku u ngrit në këmbë dhe e duartrokiti me zjarr kur mbaroi.

— Nga emocioni, — tha dikush pranë nesh dhe vazhdoi të duartrokiste me forcë. Njerëzit duartrokisnin, edhe pse ai këndoi pa sukses, se ata e quanin atë birin e tyre. Se populli e ka zemrën det për ata që i quan bijtë

e tij. Ai e kuptoi patjetër këtë. Më thanë se pas shfaqjes e kishin parë duke qarë. Dhe mua më erdhi keq për të. Më erdhi keq dhe e ndjeva veten krenar. E si të mos e ndieja veten krenar? Ai e kuptoi se sa i vogël e i pa-fuqishëm ishte përpara një mase njerëzish. Dhe unë e di-ja pse kishte qarë ai. Se populli e kishte ngritur në pë-llëmbën e tij të madhe, kur ai e kishte hedhur veten në baltë. Isha i bindur për këtë.

## PËRSËRI FRYN AJO ERE E NGROHTE

Ajo ditë më ka mbetur në kujtesë me të gjitha hollësitë. Në mëngjes u ngrita më shpejt se herët e tjera.

Një shqetësim i çuditshëm më trazonte e ndonëse isha e gëzuar, ndieja edhe një frikë për të panjohurën që më hapej përpara. I rregullova pantallonat përpara pasqyrës e pastaj qesha me vete duke i hedhur flokët prapa me një lëvizje të kokës.

— Ç'bën, të luajtën vidhat?

Nëna me sy të përgjumur u habit kur më pa të veshur.

— Po ora është akoma katër, moj qyqe, ti s'pasje fjetur tërë natën! Dale, dale, pa të shohim sa do të të mbajë ky qejf...

Unë u afrova dhe e putha nënën, pa i thënë asnjë fjalë.

— Kisha frikë se s'më dilte gjumi, — i thashë me zë të ulët.

— Po të thashë që të ngre unë!...

— Më doli gjumi, e dija se s'do të më zinte më, prandaj u vasha...

— Po këtu përpara pasqyrës ç'po bën tani?

Nuk dija se t'i përgjigjesha dhe e ndjeva se u skuqa.

— Do të të luajnë vidhat, moj qyqe!, — tha përsëri nëna dhe doli.

Unë përsëri mbeta vetëm dhe kurrë ndonjëherë nuk më është dukur më e gjatë se ajo orë që më mbetej për të pritur ende.

Jashtë po binte një shi i hollë dhe ishte fare errë-sirë. Vështroja nga dritarja se si rrëshqisnin pikat e ujit në anën tjetër të xhamit.

— Tët bijë nuk e ka zënë gjumi tërë natën, — dë-gjova nënën t'i thoshte babait. Toni i saj ironik më bëri të skuqesha përsëri dhe për pak do t'ia kisha shkrepur të qarit, por, për habinë time, babai u soll krejt ndryshe nga ç'e prisja. Ai hyri i qeshur në dhomë, më përkëdhe-li dhe zëri i tij dridhej nga mallëngjimi. Më tha se i bë-hej qejfi që unë isha ngritur aq shpejt atë ditë. Më tha se edhe ai, kur kishte filluar punën për herë të parë, aq-sh-tu ishte ngritur, pa gdhirë. Më tha se unë i ngjaj atij dhe do ta doja gjithmonë punën.

U futa nën çadrën e madhe të babait dhe, duke u shtrënguar pas krahut të tij, e ndieja veten të gëzuar e të lehtë. Atë mëngjes, babai me sjelljen e tij të ngrohtë më dha një besim të madh në vetvete, që ishte i nevojshëm në ato çaste për mua.

Në stacionin e autobusit më shtrëngoi dorën fort du-ke më vështruar drejt në sy i qeshur e më tha me zë të butë:

— Punë të mbarë, bijë e babait!

Një vajzë që ishte prapa autobusit, më foli duke më kapur për supi:

— Teuta, po ti këtu?

— Shtyjeni derën, çupa, shtyjeni derën. Vëri atë gan-xhën, se nuk qëndron!, — më tha faturinoja dhe unë mbylla derën e autobusit.

— Në fabrikë!..., — i thashë pastaj asaj vajzës që më pyeti, duke u munduar t'i kujtoja emrin.

— Po... e mbarove gjimnazin ti?



— E mbarova.

— Çfarë do të punosh në fabrikë?

— Elektriciste!

— Elektriciste!?. . .

— Kemi marrë kategorinë e tretë të gjithë në shkollë.

— Po, po, e di!, — ma preu ajo fjalën. — Më kujtohet. Edhe në fabrikën tonë vinin e bënin praktikën nga shkolla e mesme.

Kur zbritëm nga autobusi, ora ishte pesë e gjysmë.

— Po këtu vetëm punë me turne ka për elektricistët. . .

— E di, — i thashë, — Punë e madhe!

— A, jo, mos thuaj ashtu, turni i tretë nuk hahet fare, ja, do ta shohësh vetë. . .

— O, hajde, je e porsaardhur, — i tha përgjegjësi i ofiçinës. — E ke letrën nga drejtoria?

— E kam.

Hymë në një dhomë të vogël, ku ishin tri-katër vajza dhe një burrë rreth të dyzetave.

Thashë mirëmëngjes me gjysmë zëri dhe filloi të më rrihte zemra fort. I ndieja të gjitha vështrimet që më ishin qepur dhe kjo më bënte më të ngathët.

— Po, — foli ai burri pasi lexoi letrën dhe më hodhi një vështrim nga koka te këmbët, si të donte të më çmonte në vleja apo nuk vleja unë si elektriciste. — Do të punosh me Bashkimin, — tha pastaj, sikur ky Bashkimi të ishte njohur me mua qysh dhjetë vjet më parë. — E di ç'ke ti, mbylle mirë atë derën, — i tha pastaj njërës prej vajzave, e cila, pasi e shtyu derën, i vuri llozin. — Ke parë ti që filloi shpejt të ftohtët sivjet?!, — foli pastaj

— Bubu, me Bashkimin!, — më zuri veshi që i tha njëra nga vajzat me zë të ulët shoqes së saj.

— Pse?!, — u përgjigj tjetra si pa të keq me zë të

lartë. — Bashkimi është shumë i mirë. Vërtet është pak nevrík, por është i drejtë...

Dhe unë fillova ta përfytyroja këtë Bashkimin në njëqind mënyra, por në të gjitha përfytyrimet e mia ai mbetej një burrë i thinjur e i rreptë, që nuk i qeshte buza kurrë.

Dera u drodh nga një e shtyrë nga prapa, por askush nuk ia vuri veshin. Atëherë dridhjet dhe të tronditurat u bënë më nevríke.

— Ç'është ai pykë që e shtyn me aq forcë?, — thirri përgjegjësi dhe u ngrit ta hapte derën. — O, më fal, tha pastaj, — qenka i zoti i shtëpisë. Po ngroheshim pak, ke parë ti që filloi të ftohtët!...

— Shiko, Spiro! Këtu kafene nuk është. Pse ma ke varur këtë tabelë në derë, për të bukur?.. — Ai tregoi një copë llamarinë, ku kryqëzoheshin dy eshtra nën një kafkë të vdekuri e poshtë fare shkruhej me shkronja të zeza: «Rrezik vdekje! Ndalohet hyrja pa punë!». — Han është këtu, apo kabinë elektríke?..

Unë e vështrova dhe menjëherë e kuptova se ai do të ishte ustai im. Më vinte të qeshja se përfytyrimi im kishte qenë shumë larg së vërtetës. Ai ishte i ri, kishte një trup të gjatë, të drejtë e të fuqishëm dhe s'që i kërrusur e i plakur, si e kisha imagjinuar unë.

— Mirë, mirë, ke të drejtë. Hajde, dilni, çupa, po jo ti, — m'u drejtua përgjegjësi mua. Pastaj i tha atij:

— Bashkim, kjo do të jetë ndihmësja jote. — Ai më vështroi drejt dhe u bë flakë i kuq. Siç duket s'më kish-te vënë re më parë.

— Ç'prezantim!, — tha pastaj kur kishim mbetur vetëm. — Më falni që fola ashtu, por... — Atij filloi t'i merrej goja e si duket nga kjo u hutua edhe më shumë e vetëm belbëzoi diçka pa kuptim.

Për një çast mbetëm të dy në këmbë përballë njëri-

-tjetrit dhe secili e ndiente se sa rëndonte heshtja ato sekonda, por ç'mund të thoshim? Ai e mblodhi veten më parë nga unë dhe, pasi mori i rrotulloi pincat në dorë, i la atje ku ishin përpara dhe më pyeti:

— Si ju quajnë?

— Teuta, — thashë unë me gjysmë zëri.

Ai vështroi njëherë përreth si t'u kërkonte ndihmë dorezave elektrike, çelësave, siguresave. . . Pastaj tha:

— Ku keni punuar më përpara?

— Nuk kam punuar. . .

— Aa, mirë, mirë. Atëherë kini kujdes në fillim, mos prekni asgjë me dorë pa qenë unë. — I tha këto fjalë si të më jepte urdhër. Por, me sa duket e kuptoi edhe vetë atë që po mendoja unë dhe shtoi: — Sigurisht, kuptohet, e kam fjalën. . . — Por, duke dashur të më sqaronte, u ngatërrua edhe më shumë dhe i hutuar po jepte e po merrte.

— Ju kuptoj shumë mirë, — desha ta ndihmoja.

— Po, po, patjetër që më kuptoni. . . — Po në atë çast u hap dera dhe ai s'e mbaroi fjalën.

— Bashkim, — një vajzë që sapo hyri, më hodhi një vështrim mospërfillës nga koka te këmbët, pastaj vazhdoi: — Hajde, se do të lëshojmë «gjigantin».

— Kështu i themi një elektromotori të madh, — m'u drejtua ai kur mbetëm përsëri vetëm. — Do të vini ta shikoni si do ta lëshojmë?

Dolëm të heshtur dhe shkuam te motori i madh. Ai ishte vërtet gjigant.

Filloi të më rrihte zemra fort, kur ai iu afrua kuadrin elektrik.

— Shiko!, — tha dhe kjo që e para herë që më foli me ti.

— Përpara se ta lëshojmë, shigjetën e reostatit e shpiem te njëshi.

Unë i kisha ngulur sytë dhe po e vështroja me vëmendje të madhe.

— Pastaj i japim dorezës përpara. Tani kërkojmë thikën.

Ai me një lëvizje shumë të shpejtë e ngriti dorezën lart. Pulexha e madhe e elektromotorit filloi të rrotullohej ngadalë. Një vërshëllimë e mbytur e drodhi të gjithë ajrin përreth.

— Tani e çojmë shigjetën e reostatit me intervale deri në fund.

Ai filloi të rregullonte dorezën me hope dhe në çdo lëvizje të dorezës, motori vërshëllente më fort dhe pilexha e shtonte shpejtësinë. Në fund fare zhurma u bë shurdhuese.

— Tani s'duhet të harrojmë këtë dorezën tjetër!, — thirri fort ai, për të mposhtur zhurmën. — Këtë s'duhet ta harrojmë kurrë!, — thirri dhe më tregoi mbi motorin një dorezë të shkurtër. — Duhet ta çojmë përsëri në vend. — Dhe me një lëvizje të lehtë i dha dorezës prapa.

Unë u hutova aq shumë nga zhurma, sa për pak vura duart te veshët. Por pikërisht në atë çast më erdhi në ndihmë ai. Më kapi për krahu fare pa të keq dhe unë e ndoqa pas. Kur hymë në kabinë, qeshi dhe më tha:

— Mos u mërzit! Në fillim është pak vështirë, por do të shihni që do të mësoheni shpejt.

Ai pati të drejtë. Kaluan vetëm disa ditë dhe unë u mësova me atë zhurmë që më dukej në fillim e tmerrshme. U mësova, ose më mirë të them më doli frika nga çdo dorezë, kuadër, panel a siguresë tubolare, që ditët e para më dukeshin gogol dhe ai që i zinte me dorë më dukej njeriu më i guximshëm në botë.

Kështu kaluan javët e para dhe ne nuk rrinim më të druajtur si ditët e fillimit. U mësuam me njëri-tjetrin

dhe kishim filluar bile të bënim rrallë edhe ndonjë shaka.

— Kujdes, — më tha ai. — Kurrë mos shtrëngo me çelës kur i ke duart me graso. Ja, e shikon, qenke vrarë. Shko e mjekoje dorën.

— Nuk e kam vrarë, vetëm pak e gërvisha...

— M'i jep mua çelësat!... Shko mjekoje dorën!...

U ngrita dhe dola.

— Teuta!, — më thirri ai nga brenda.

— Urdhëro!, — i thashë dhe u ktheva.

— Pasi ta mjekosh dorën, shko merr pak estraktorin.

Mjekova dorën dhe mora estraktorin. Kur u ktheva dëgjova që ai bisedonte me dikë brenda.

— Hë, mor, edhe ti, mos u hiq kaq i shenjtë.

— Pusho tani, mos u bëj hajvan, se mos vjen e të dëgjon.

— Ta paska mbledhur, më duket, të paska hyrë frika.

— Shiko, Xhevo, më ler rehat po të them, të lutem më lërë rehat...

Unë u ktheva dhe u largova. Nuk desha të hyja. Atij do t'i vinte shumë rëndë se s'desha ta vija në pozitë të vështirë. E ndieja tani se ai nuk ishte njeri i keq. Edhe ndonjëherë, kur më vështronte drejt, asgjë e keq nuk dallohej në sytë e tij. Unë ndonjëherë mendoja me vete se ai kishte filluar të më donte, po kjo mund të ishte vetëm hamendje, siç ishte hamendje se edhe tek unë kishte filluar të dridhej diçka si një mallëngjim. Por të gjitha këto, në fund të fundit, ishin ende shumë të zbeta dhe nuk mund të thoshe asgjë me saktësi.

Një ditë harrova ta shtyja para dorezën e gjigantit pasi e vura në punë atë. Gjithë reparti u mbush me tym. Era e gomës së djegur të përcëllonte fytin. E ndalova motorin dhe për një çast mbeta si e ngrirë, pa ditur ç'të bëja. Ai po montonte në kabinë ca llampa neon. Unë besoj isha bërë në fytyrë dyllë...

— Çfarë ka ndodhur?, — më pyeti dhe u ngrit menjëherë.

— Harrova të rrotulloja dorezën e «gjigantit».

— U dogj kablli?

— Po, — thashë dhe gati ia shkrepja të qarit.

— Asgjë me rëndësi... Prandaj qenke zverdhur ti?..

Eh, sa herë e kam djegur unë... — Ai kurrë nuk e kishte djegur, isha e sigurtë për këtë. — Mos u bëj budallaqe. Ç'më rri ashtu? Merr tre metra kabëll dhe hajde ta ndërrojmë... As dhjetë minuta punë nuk ka.

Elektromotorin e madh e kishte rrethuar një grumbull vajzash. Të gjithave u vintë keq për mua, vetëm një-rës, megjithëse mendohej ta fshihte, i shkëlqente fytyra. Ishte ajo vajza që e kishte thirrur Bashkimi ditën e parë...

— Hë, çfarë ka?... Po e qani? — Ato u shpërndanë duke qeshur.

Kur dolëm nga puna, binte shi. Në autobus u ulëm pranë dhe unë po vështroja nga xhami.

— Akoma mendjen te doreza ti?!

Unë qesha. Një çast u vështroam drejt në sy. Ai u bë flakë i kuq, por edhe unë ndjeva faqet që m'u nxehën dhe zemrën që më rrahu fort.

Tanimë kot mendohej t'ia mbaja fshehur vetes. Sapo u ndava nga ai, e ndjeva atë që trembesha ta pranoja, e ndjeva në të gjithë trupin tim. Më dukej sikur gjaku qarkullonte më me rrëmbim, më dukej gjithçka e bukur, bile edhe shiu m'u duk i bukur atë natë.

Pastaj pas shirave të dimrit erdhi pranvera e pastaj vera. Ai vit fluturoi ashtu si fluturon koha, kur ke për se të mendohesh përpara se të të zërë gjumi në darkë, kur ke për se të gëzohesh, kur hap sytë në mëngjes.

Çdo ditë mezi prisja të filloja punën. Pastaj orët e punës mbaronin çuditërisht shpejt.

Disa herë e kishim bërë rrugën nga fabrika në qytet në këmbë. Sidomos një natë nuk do ta harroj kurrë.

... Ishim turni i dytë. Njëri nga lëshuesit i digjte vazhdimisht siguresat. Ai erdhi e pa dhe më tha:

— E ke montuar gabim.

Unë e vështrova e hutuar dhe u bëra flakë e kuqe.

— Bëj skemën!

U ula dhe fillova të hiqja vija në një letër të bardhë. Dora më dridhej dhe merret me mend sa të bukur e bëra skemën.

— Shumë mirë, ndiqe tani me vëmendje çdo fije në lëshues.

— Ja, mirë i kam, — thashë unë.

— Si mirë i ke, po kjo fije e bobinës, ç'kërkon këtu?...

— A, po, — qesha unë dhe ndërrova pozicionin e përcjellësve.

Po nuk liroja dot njërin nga vidhat, se ishte ndryshkur. Më vinte të pëlcsija, aq më tepër se ndieja vështrimin e tij.

— Dale, — tha ai dhe me lehtësi e liroi vidhën.

Pasi lidha të gjitha fijet, vura përsëri të gjitha siguresat.

— Shtype butonin tani!

— Kam frikë se do të digjen prapë siguresat.

— Nuk digjen më, shtype!

Unë e shtypa butonin blu dhe elektromotori në çast vërshëlleu. Ai qeshi dhe m'i nguli sytë drejt. U hutova aq shumë duke e vështruar drejt në sy, sa që për pak u rrëzova duke u penguar në një ingranazh të madh. Ai më kapi për krahu dhe unë ende ndieja gishtat e tij dhe pasi ai e kishte hequr dorën. Kur dolëm nga puna, më tha:

— A shkojmë edhe sonte në këmbë?

Zëri i dridhej dhe unë e kuptova se ai kishte shumë dëshirë që unë të pranoja.

— Mirë, — i thashë, — si të duash.

Nata ishte e ngrohtë dhe e qetë. Dy radhë llampash neon zgjateshin përpara nesh në një kënd të ngushtë e atje larg, në fund të rrugës, ato dukeshin sikur bashkoheshin në një pikë.

— Sa e bukur kjo natë!, — thashë padashur unë dhe e ndjeva se u trubullova në çast. Zemra m'u duk sikur m'u ngushtua nga një mallëngjim i çuditshëm e më dukej sikur nuk do të përmbahesha dot, po do të qaja ashtu kot.

Herë-herë ndieja bërrylin e tij që prekte në krahun tim dhe për çdo herë më dukej sikur po më merrej fryma, më dukej sikur isha në ëndërr.

Por heshtjen e natës e prishi një sirenë vapori, që u zgjat prej diku larg, nga ërrësira e detit. Pastaj një kor sirenash iu përgjigjën përshëndetjes së saj. Një veturë rrëshqiti shpejt në asfalt.

— Teuta!, — tha ai papritur.

Mua m'u duk sikur nga çasti në çast do të më pushonte zemra.

— Gjithçka jeton, a e ndien ti këtë?... Ja, zhurma e valëve, ato sirenat pak më parë, gjithçka, gjithçka...

Asgjë nuk kuptova nga fjalët e tij, por vetëm ndjeva se edhe ai ishte në gjendjen time.

— Bashkim, harrova të të thosha se më doli bursa, — i thashë unë pas disa çastesh heshtjeje. Ai kushedi çfarë bluante në mendje dhe në fillim as që i mori vesh fjalët e mia. Pas pak si duket e mblodhi veten dhe pyeti:

— Si the?

— Më doli bursa.

— Të doli bursa?!

— Po, pse habitesh?



E vështrova drejt. Fytyra e tij u pre menjëherë.

— Për çfarë?

Ai ende s'e kishte mbledhur veten.

— Për inxhinieri elektrike.

— Aa, shumë mirë, shumë mirë.

Por fytyra e tradhtoi. E vështrova e habitur dhe ende nuk po e kuptoja shkakun e këtij ndryshimi të befasishëm. Gjatë gjithë rrugës nuk e hapi gojën. E vështrova edhe një herë e shqetësuar. Por ai as që e ktheu kokën fare.

— Pse, — thashë padashur. — Si thua, Bashkim?, — zëri im u drodh aq shumë, sa m'u duk si i huaj. — Të shkoj, apo jo?

— Patjetër, të shkosh si të mos shkosh, — tha ai me zë fare të shuar.

«Pse?», — thosha unë me vete atë natë, kur u shtriva të flija. «Pse?», — dhe lotët më rrodhën mbi jastëkun e bardhë.

Pastaj erdhi vjeshta dhe unë shkova në shkollë. Kujtoja ditët që kishin mbetur dhe kudo që isha ndieja një zymtësi plumb të rëndë. Nuk e di pse më ishte fiksuar se gëzimi kishte fluturuar njëherë e mirë për mua. Një pasdite rrija në dritare dhe vështroja retë që vinin të ngjeshura nga jugu. Era trazonte flokët e gjelbër të ekualipteve dhe mua më dukej se asnjë stinë nuk mund ta ushqejë brengën si vjeshta. Të gjitha, të gjitha më dukeshin të zymta. Ajo erë e ngrohtë, retë dhe ekualiptet që dallgëzoheshin. Por papritur zemra më rrahu fort. Në fillim kujtova se më bënë sytë. Qepallat m'u përplasën disa herë me njëra-tjetrën. Po më merrej fryma. Ai poshtë konviktit tonë pyeste një vajzë dhe ajo e drejtoi dorën këtej. Desha të thërrisja fort Bashkim, por nuk munda. Zëri më mbeti në grykë.

Vrapova poshtë shkallëve duke fshirë sytë.

Përsëri frynte një erë e ngrohtë, që i tundte flokët e gjelbër të ekualipteve. Retë si më parë vozisnin të zymta drejt veriut. Por tani kush kishte kohë të vështronte retë, vjesh tën e flokët e gjelbër të ekualipteve? Ne zbrisnim të tatëpjetën e qytetit të studentëve, kapur si fëmijët për dorë dhe të gjitha na dukeshin të bukura. Edhe shiu, që filloi të binte me pika të mëdha ishte i bukur atë ditë. Gjithçka ishte e bukur, gjithçka ishte e bukur!

## ZGJIMI

Ishte korrik. Bënte vapë. Isha me shërbim në një qytet të vogël. Sa kishim lënë punën, u nisëm me Astritin të hanim drekë në një restorant në qoshe të rrugës. Vështruam përreth tryezat. Ishin të gjitha të zëna dhe, kur po bëheshim gati të dilnim, dikush e thirri Astritin:

— Hajdeni, jam vetëm dhe s'pres njeri.

Ishte një burrë nja pesëdhjetëvjeç, trupmadh, me një fytyrë të gjerë eshtake e me vetulla të trasha që i rrinin si strehë mbi sytë e mëdhenj e të zinj. Kur më shtrëngoi dorën, dora ime humbi në të tijën. Çdo gjë tek ai dukej e madhe, e fuqishme.

Vura re në tryezë një gotë rakië të boshatisur dhe një dopio që sapo e kishte filluar.

— Çfarë do të merrni, raki apo birrë?

— Po marrim ndonjë birrë, — tha Astriti.

— Kamarier, — thirri ai.

Kamarieri, megjithëse ishte i mbytur në punë, vra-poi në çast te tryeza jonë. Më erdhi pak çudi. Në të njëjtën kohë po e thërrisnin nga shumë tryeza.

— Dëgjo: Sillu shpejt këtyre nga një birrë dhe merru porosinë çfarë do të hanë, — tha ai me ton urdhërues të prerë.

— Si urdhëroni, — tha i bindur kamerieri. Mua më erdhi për të qeshur nga ajo gatishmëri jo e zakonshme. Dhe vërtet ato që porositëm erdhën shumë shpejt.

— Nuk e kanë marrë vesh të gjithë, — foli ai duke vështruar drejt Astritin, — ndryshe juve nuk do t'ju kishin ardhur gjellët aq shpejt.

Një buzëqeshje e hidhur u end në fytyrën e tij.

— Akoma më ka mbetur pak hije...

— Jo, Vasil, mendon gabim, — i tha shtruar Astriti.

— Leri ato, eh, do vite të tëra ndërgjegjja. Ç'mendon ti, se ai kamerieri e ka ndërgjegjen akull të pastër? Asnjë nuk e ka ndërgjegjen ashtu si thua ti. Për ta përmbysur ndërgjegjen e vjetër do të na duhen shumë vjet, Astrit, se jemi me myk ne këtu brenda, — dhe tregoi me gishtin e tij të madh kokën.

— Këta janë më ndryshe, — tha duke bërë me kokë nga unë. — Janë të rinj. E reja nuk ka shumë ndryshk.. Hajde, gëzuar!, — dhe e përplasi gotën me gotat tona menjëherë.

— Kamerier, — thirri, — edhe një dopio!

E vështrova drejt, nuk e di pse u rrëqetha. Në fytyrën e tij dukej qartë hija e një trishtimi të fortë. Ashtu si tiparet e tij ishin të prera dhe të theksuara, ashtu duhej të ishin të ashpra, të forta, të prera edhe ndjenjat e tij.

— Vasil, nuk bën mirë që pi kështu, ti nuk duhet të dorëzohesh. Fatkeqësia për njerëzit është.

— Çfarë fatkeqësie?, — e ndërpreu ai Astritin dhe fytyra iu bë në çast e rreptë. — Pse, ç'më kujton mua ti?

Unë mendova se kaq e pati kjo punë. Gjithë ato gota raki do ta bënin të vetën.

— Pse të më konsiderosh fatkeq?

Papritur zëri i tij u zbut, si ta kishte nuhatur mendimin tim.

— Jo, Astrit, gaboresh... Pse pi raki?... Nuk do të më shikosh më kurrë. — Ai bëri me dorë duke treguar

gotat mbi tryezë. — Kurrë nuk do të më shohësh mua kështu si sot.

Nuk e di ç'kishte në zërin e tij që të bënte t'i besojë ato që thoshte.

— Ti mendon se unë jam një fatkeq i dëshpëruar?, — qeshi hidhur. — Një njeri që ka humbur postin, kolltukun, veturën, dhe qan tani për to... dhe pi raki i mbytur në pesimizëm. Jo, Astrit vëllai, jo... Unë dëshpërohem vetëm për një gjë: se më kishin zënë sytë lesh... Pse e kisha harruar klasën që më lindi? Njerëzit me të cilët duhej t'i vija gjoksin punës i kisha harruar. I shihja me mospërfillje hallet e tyre. U rrëshqisja, më bezdisnin, doja t'i hiqja qafe. Po, po, doja t'i hiqja qafe, se më bezdisnin.

Heshti, nxori paqetën, ndezi një cigare, pastaj vazhdoi me vështrimin të thelluar diku, si të rrëmonte në kujtime:

— Më erdhi njëherë një djalë i ri si ky, — bëri nga unë me kokë. — Ishte mësues në shkollën e natës, këtu në gjimnaz. — «Nuk kam shtëpi, — më tha, — dua të martohem. Shtëpinë e kam të vjetër, jashtë përdorimit, ja raporti teknik». — dhe më zgjati një letër.

— Po mirë, pse nuk e rregullove shtëpinë?, — e pyeta.

— Nuk ia vlen barra qiranë. Rregullimi kushton më shumë sesa ta bësh të re.

— Po mirë, ore, bëje të re atëherë.

Ai më pa i habitur.

— Si ta bëj të re, ku t'i gjej lekët?...

— Pse, ç'i bën lekët ti, — ia ktheva unë, — raki i pi lekët?

— Jo, unë nuk pi raki, — tha flakë i kuq. — Po që të mbledh aq lekë sa duhen për një shtëpi... Ju e kuptoni vetë...

— More, hiçgjë s'kuptoј unë. Ju të shkollës së natës i lini nxënësit e kërcisni në kinema. Pastaj na vini këtej dyerve të komitetit: «Duam shtëpi të re, duam këtë, duam atë». Ndonjë ditë do të na kërkoni t'ju gjejmë edhe nuse. Pse, ore, ç'u bë këtu? Rregulloje, ore, shtëpinë, mblidh ca shokë dhe puno! — Më kujtohet si ta kem edhe tani përpara fytyrën e tij. E mbuluan djersët. Por unë atë çast doja vetëm ta hiqja qafe. Prandaj u kënaqa që ai e ndiente veten ngushtë. Kështu do ta kisha më lehtë ta përcillja. Dhe vërtet, ai, kur u ngrit për t'u larguar, mori frymë si të ishte çliruar nga një barrë. Unë qesha pasi iku ai dhe i thirra sekretares të sillte tjetrin. U ula dhe mora pamjen time të zakonshme hijerëndë. Përsëri hyri një i ri.

«Edhe këtë do ta përcjell shpejt», — thashë me vete.

— Ku punon ti, djalë?, — e pyeta i ngrysur në fytyrë pa ia kthyer përsëndetjen.

— Në bankë, — u përgjigj ai.

— Nuk ke punë tani ti?...

— Kam...

— Po pse atëherë ke ikur nga puna, kush të paguan ty për këtë kohë?, — ia ktheva unë.

— Kam marrë lejë, — tha ai i qetë.

— Çfarë lejë, more? Do ta shohim edhe atë lejën tënde. Pse, ore, çfarë u bë puna e shtetit, han?...

— Orarin tuaj të pritjes e keni vënë ju dhe jo unë, — ma ktheu shkurt ai.

— Shiko këtu, mos më shit mend mua, po shko shpejt në punë, se ndryshe të pushova në vend. Të pushoj, për ideal, të pushoj, që këtë çast të dërgoj në fermë!

— Unë nuk kam frikë nga puna, — tha ai pa ia bërë tërr syri. — Në fermë dhe kudo shkoj unë. Nuk jam as i sëmurë, as i dobët fizikisht; po ju, në rast se silleni me të gjithë kështu, nuk bëni mirë.

— Dale, po më jep edhe mend tani. Hajde, qërohu përjashta, spurdhjak!, — i thashë me të egër i nxehur.

— Unë nuk jam spurdhjak, por ju qenkeni... qenkeniii... — Po i merrej goja dhe ishte bërë dyll i verdhë. — Kokë e këmbë burokrat, — tha më në fund dhe u kthye, doli duke ma lënë derën hapur e duke më lënë mua të xhindosur.

Tani më vjen të qesh kur e kujtoj, më vjen të qesh, se nuk qaj dot. E kupton tani, o Astrit vëllai, pse më vjen keq?

Psherëtiu, pastaj vuri buzën në gaz.

— Më kanë emëruar shef kuadri në grumbullim. Nuk do të vete. Do të shkoj në minierë. Dua ta shqyjej atë shpirtvogëlsinë që më kishte pushtuar këta vjet. Ta varros atje thellë në nëntokë.

Fytyra i ishte errësuar në çast, gjithë muskujt i ishin tendosur. Por e mblodhi veten menjëherë.

— Hajde, gëzuar Astrit, gëzuar edhe ti, djalë!

I trokitëm gotat.

— Punoni bashkë?, — e pyeti Astritin duke më treguar mua dhe me një ton krejt të qetë tani.

— Po.

— I martuar je?, — më pyeti mua.

— I martuar.

— Ke fëmijë?

— Kam një djalë.

— Të të rrojë!

— Falemnderit!

— E do djalin, e do?, — më pyeti i qeshur.

— E dua shumë, — qesha edhe unë.

— Ja, e shikon, kështu ju duam edhe ne pleqtë ju, prandaj t'i duash prindët, edhe në rast se gabojnë ndonjëherë.

## MOTRAT

Fjalët e saj ranë si bombë. E papritura që aq e madhe, sa në fillim askush nuk mundi të hapte gojën. I ati, e ëma, motra e madhe, vëllai i vogël, të gjithë, me sy të mbërthyer tek ajo, shtangën të trullosur.

Hamdi Grona, i zbetë, me sytë gjysmë të mbyllur, vështroi të bijën nga koka te këmbët, pastaj me lëvizje të tërbuara e mbërtheu për fyti, e shtrëngoi duke u skërmitur dhe i tha i shkumëzuar:

— Thuaj se nuk the të vërtetën, se ndryshe të mbyta!...

Vajza mori një herë frymë pasi iu çlirua gryka nga duart, heshti një çast duke e vështruar të atin drejt në sy, pastaj foli e vendosur:

— Baba, unë nuk të gënjeva!

Atëherë ai e qëlloi të bijën fort në fytyrë. Ajo ra në dysheme, ndërsa Hamdiu doli duke përplasur fort derën pas vetes.

Rruga ishte e errët, binte një vesë shi. Ai, ecte me duar të futura thellë në xhepa, psherëtiu dhe vazhdoi të ecte i ngrysur. Ndiante thellë në vete një trazirë ndjenjash. Sigurisht nuk është e lehtë të qëllosh fëmijën tënde...

Në bulevard dikush e përshëndeti duke ngritur dorën i qeshur. Edhe Hamdiu u mundua të buzëqeshte, por ajo buzëqeshje i ngjante më shumë një ngërdheshjeje.



Shkoi te një klub dhe piu një kafe. Pastaj doli dhe ndjeu nevojë të bisedonte me dikë, t'i hapej dikujt, ta zbraste shqetësimin që i dukej sikur e gërryente përbrenda.

U nis nga i vëllai. Kur hyri në oborrin e shtëpisë, mbajti vesh duke ngadalësuar hapat.

— Hajde, i dua, i dua, më jep lekët, — thërriste mbesa e vogël.

— Moj, hiqmu po të them!, — dëgjoi Hamdiu të kunatën.

— Jo, moj, vetëm unë të mos shkoj? të gjitha shoqet...

— Merr vesh ti që nuk kam?...

— Ke, ke, ja, të vete t'i marr vetë?...

— Hej kusur!...

— Epo jepi çupës edhe ti, pse të ndahet nga shoqet?, — njohu Hamdiu zërin e të vëllait.

— Dëgjove, moj Vjollca, po s'të dhashë burrë një plak kur të rritesh, po u bëfsha si ky dru...

Vajza mori lekët, i futi ngadalë në çantë, pastaj, duke dalë nga dhoma, tha:

— Ma jep ti, po e mora unë se? Po e mora, të lumtë ty!

Pastaj Hamdiu dëgjoi se si qeshën në dhomë të gjithë. Dhe ai vuri buzën në gaz.

«Ndryshuan kohët», — tha me vete dhe hyri brenda.

— E dëgjove?, — e pyeti duke qeshur i vëllai.

— E dëgjova, — tha Hamdiu. Nëpër fytyrën e tij rrëshqiti vetëm një çast një buzëqeshje e lehtë, pastaj ai u ngrys përsëri.

— Ç'ke kështu?, — e pyeti pas pak i vëllai duke e vështruar në fytyrë.

— Asgjë, më dhemb pak koka, — tha Hamdiu duke ndërruar mendim. Ai nuk i tregoi të vëllait pse kishte vajtur, dhe, si qëndroi pak atje, u ngrit e u nis për në shtëpi.

Shiu vazhdonte të binte shtruar. Ai ecte i vetëm me kokën përkulur përpara, pa ditur se nga anonte më tepër ndjenja e tij. I vinte edhe inat, i vinte edhe keq.

Në korridor hoqi këpucët dhe hyri në kuzhinë. Fëmijët u ngritën në këmbë të heshtur. E shoqja nuk foli edhe ai nuk foli. Hoqi pallton dhe u ul pranë oxhakut. Pastaj nxori kutinë e duhanit dhe filloi të dridhte ngadalë një cigare. Thithi tymin, pastaj hodhi një vështrim të shpejtë përreth. Të gjithë i mbanin sytë përdhe. Hamdiu më vonë vëshroi me vëmendje të bijën. Ajo ishte ulur në gjuhë në një qoshe dhe lexonte një dispensë.

«U rrit», — mendoi ai dhe si vetëtimë i kaluan përpara syve vite të tëra.

E shoqja u ngrit dhe kaloi nëpër dhomë në majë të gishtave. Djali i vogël ia kishte qepur sytë të atit me ankth. Hamdiu e dinte se ai e donte shumë të motrën. I erdhi keq për të birin, i erdhi keq për të bijën dhe për të gjithë ata njerëz aq të dashur, që i druheshin tani aq shumë...

Psherëtiu, shkundi hirin e cigares, pastaj tha me zë si të ngjirur:

— Shkoni flini!

Vajza e madhe dhe djali dolën të heshtur. Ata harruan ta përhëndesnin babanë, por ajo jo. Ndaloi te praku, e vështrroi drejt në sy të atin dhe tha:

— Natën e mirë, baba!

Hamdiu e vështrroi egër, pa iu përgjigjur, por brenda tij mallëngjimi iu ngjit deri në fytyrë.

«Më ngjan mua, — tha me vete, — ka guxim të ta thotë hapur çdo gjë. E ka zemrën qelibar...» Pastaj dëgjoi se si u mbyll dera e dhomës tjetër.

Vajzat nuk shkëmbyen asnjë fjalë deri sa zuri gjumi të vëllanë.

— Ti je e çmendur!, — e theu heshtjen e madhja.

E vogla nuk u përgjigj. Ajo vështronte tavanin me sy të fiksuar në një pikë dhe ndiente se si dalngadalë po i hipte gjaku në kokë nga qortimet e së motrës, që sa vinin e bëheshin më të rrepta.

— Po, po, ti je e çmendur, vërtet e çmendur. Unë kurrë nuk do ta bëja atë që bëre ti sot.

— Edhe unë nuk do t'i bëja kurrë ato që bën ti, — e ndërpreu motra tjetër me zë të ulët, por me një notë egërsie.

— Ç'do të thuash?, — pyeti tjetra dhe u ngrit ndenjor mbi krevat.

— Dua të them se ti edhe ditën që u martove vajte e takove fshehurazi Bardhin.

— Ti je budallaqe, Arta!, — ajo u zbeh. — Ti nuk mund ta kuptosh sakrificën time!... Unë sakrifikova gjithçka për të mos u thyer zemrën prindëve... Për hatër të prindëve...

— Për hatër të prindëve u martove me një tjetër dhe vazhdon të duash akoma të parin, — tha me rrëmbim e vogla.

— Se nuk isha e pëcapë si ti, se më mungonte guximi yt i çmendur.

— Megjithatë ti akoma mendon për të.

— Je shumë e keqe, Arta; je shumë e keqe!... — tha e madhja e përlotur dhe mbuloi fytyrën me të dy duart. Por e vogla dukej e pamëshirshme dhe nuk e zbuti vështrimin nga lotët e së motrës.

— Ti kurrë nuk më ke dashur, Arta, ti gjithmonë e egër ke qenë.

Por Arta heshtte dhe dëgjonte dënesat e së motrës dhe pikat e shiut që rrihnin xhamat e dritareve me një ritëm monoton. Pastaj u kthye nga muri dhe mbylli sytë. Një buzëqeshje e lehtë ëndërrimi u end një çast në fytyrën e saj të njomë, e pastaj e zuri gjumi.

## ALEATËT

Dhoma ishte e errët. Dimër. Ftohtë. Binte një shi i ngri-rë. Majori italian nxori paqetën. Gishtat i lëvizi me ngathtësi nga të ftohtët. Ndezi një cigare dhe e mblodhi edhe më shumë jakën e kapotës së murme. Kishin njëzet e katër orë që i kishin mbyllur aty pa dritë, pa zjarr, pa bukë. Asnjë shpjegim. Nga tavani një pikë ujë binte në dysheme me një ritëm të qetë. Dy ushtarë bisedonin aty pranë me zë fare të ulët. Njëri thoshte se i ati ishte plak, ushqehj me një dyqan të vogël, ku kishte vjetërsira. Ai vetë kishte punuar peshkatar. Kishte një vajzë e dy djem. E kishte marrë malli shumë për fëmijët. Mburrej me djalin e madh. Thoshte se ishte shumë i zgjuar e do të bëhej patjetër inxhinier. Tjetri e dëgjonte i heshtur. Majori nuk i shihte fytyrat e tyre. Dëgjonte vetëm zërin e shuar të atij që fliste, erën që vërshëllente përjashta dhe atë pik... pik... pik... që i dukej sikur e godiste në tru. Pastaj edhe ai që fliste heshti dhe në dhomë nuk ndihej frymë e gjallë. Vetëm era përplasej me hove në xhamat e dritareve. Më vonë filloi të binte borë. Majori u ngrit dhe u afrua te dritarja. Përtej xhamit flokët e borës, si mijëra flutura të bardha dridheshin në errësirë. Ai pa se si shkriheshin ata në fillim në parvazin e dritares, pastaj dalngadalë filluan të zinin vend mbi njëri-tjetrin në rrugë e përtej rrugës. Një shtresë e bardhë kudo. Papritur u dë-

gjua një breshëri mitralozi diku larg. Pastaj të shtëna pushkësh e më vonë një zjarr i madh, atje larg, ku mbaronte qyteti.

— Bruno, Bruno!, — dëgjoi majori dikë që foli aty pranë.

Një zë u përgjigj i përgjumur.

— A dëgjon, Bruno?, — u dëgjua përsëri zëri i parë. U ngritën të dy dhe u afruan te dritarja tjetër.

— Më jep një cigare. . .

Majori vështroi fytyrat e tyre të parruara në dritën e shkrepëses. Pas një çasti rruga gjëmoi nga zhurma e makinave, motoçikletave dhe e hapave të shqetësuar. Zhurma e këpucëve ushtarake që godisnin kalldrëmin e rrugës, më hijerëndë se të gjitha zhurmat e tjera, dukej sikur jepte një dredhje të nëndheshme.

— U vunë zjarrin depove!

— Kush?

— Shqiptarët.

— Ai mitralozi më duket si yni.

— Po, yni është. . .

— Bruno. . ., si thua, Bruno, për ne të paktën mbaroi lufta?

Tjetri nuk u përgjigj menjëherë.

— Të shohim njëherë a do të dalim të gjallë nga kjo vrimë.

— Pse ta fsheh, Bruno. . . Nuk dua të vdes, por kam një parandjenjë të keqe. Gjermanët janë bisha. Kombi më i egër. Ata janë makinë pa zemër, do të na vrasin, Bruno, nuk do të shohim kurrë shtëpitë tona. Gjermanët janë popull i etur për gjak.

— Nuk është ashtu, — tha tjetri, pasi heshti një çast. — Ti i ngatërron gjërat. Edhe ne të dy, për këta vendësit, deri dje ishim egërsira. Pavarësisht se ndoshta ne e ndienim padrejtësinë dhe ishim kundër vullnetit tonë. Nuk

është populli ai që është i etur për gjak. Është sistemi kapitalist, ai që e bën njerinë ujk për njerinë. Edhe gjermanët i bëri ujqër nazizmi. Pikërisht prandaj ne tani i urrejmë gjermanët, se ata janë shtruar, si këtu edhe në vatrën tona. Çizmjat e tyre rëndojnë tani edhe mbi supet e prindëve, vëllezërve dhe motrave tona. Fëmijët tanë tremben nga krimet e tyre, siç trembeshin djemët e këtyre vendësve nga të shtënat tona. Njerëzit tanë janë ngritur tani me siguri e kanë marrë malet kundër gjermanëve. Ja se ç'na bashkon ne me këta shqiptarë, që e duan lirinë ashtu siç e duam ne tani që e humbëm. Edhe nuk ta fsheh, sikur të më jepej rasti, do të bashkohesha të luftojta për krah të tyre.

— Pusho, se do të na marrësh në qafë me këto gjepurat e tua!

— Trembesh nga oficerët?, — majori mbajti frymën. — Mos ua ki frikën më atyre. Tani që ia ndienë erën vdekjes, janë bërë qengja.

Majori ndjeu t'i merrej fryma. Dridhej nga tronditja. Do të donte t'ia thyente hundët atij ushtari maskara. «Ah, qen, bir qeni, — tha me vete, — me dorën time do ta kisha vrrarë, po t'ia kisha ditur mendimet me kohë». Por ç'të bënte? E ndiente veten të pafuqishëm e pa mbështetje. I dukej sikur urrejtja varej pezull në ajër. Ai vetë tani ishte në pikë të hallit.

Atje larg, në fund të qytetit, flakët ngriheshin të përbindshme. Tani mitralozi nuk dëgjohej më. Nuk vonoi dhe në dhomë ra përsëri heshtja. Majorit tani i kishte kaluar ajo tronditje e ethshme. Një dëshpërim i thellë kishte zënë vendin e saj dhe atij për një çast iu duk vetja si zog pa pupla. Iu duk vetja si një foshnje e hedhur në mes të udhëve.

«Ja rrota e fatit, — mendoi. — Të ngre lart në kul-

min e saj dhe pastaj të lëshon kokëposhtë për të të bluar me nofullat e veta të pamëshirshme». I humbur në mendime vuri buzën në gaz hidhur. Iu kujtuan ditët e lumtura. Kujtoi vilën e rehatshme e plot dritë në breg të detit. Kujtoi rininë... shtratin e tij të butë e të ngrohtë... Kujtoi të shoqen... fëmijët... Dhe ndjeu përsëri t'i merrrej fryma. Iu duk sikur e kishin hedhur të gjallë në një varr të ftohtë e të errët. «Djalli të marrtë», — tha me vete duke kujtuar bisedën që kishte bërë pak më parë. «Vërtet do të na pushkatojnë ata, që deri dje ishin aleatët tanë? Vërtet ky do të jetë kujtimi i fundit i jetës?... Po, po, ndryshe nuk ka si shpjegohet kjo, na kanë mbyllur këtu si derra, pa dritë, pa bukë, në çimento...» Për një çast i pati zili ushtarët. Ata flinin, ose të paktën bënin sikur flinin. Majori u orvat të merrte me mend se si mund të ishin ëndërrat e tyre. E si mund të ishin ndryshe ëndërrat e tyre, veçse të akullta e të errëta... Bora tani e kishte zbardhur krejt rrugën, çatitë e shtëpive përballë e gjithçka. Ajo vazhdonte të binte pa u ndier, e ftohtë e ftohtë... U largua nga dritarja dhe u ul pranë murit. U mbështet të flinte. Mbylli sytë. Iu duk sikur shihte ende borën që binte lehtë dhe flakën atje larg. Dikur ajo flakë do ta kishte vënë në lëvizje. Tani s'donte të dinte për të. Bile do të ishte mirë që ajo të përhapej e ta bënte shkrymb gjithë këtë vend të mallëkuar. Gjithçka në të, të mos linte të gjallë mbi dhe asgjë veç atij hoteli të vjetër, ku aleatët e kishin mbyllur bashkë me ushtarët e tij. Ah, sikur ajo flakë vërtet të bënte mrekullira e ai të mundte të kthehej në shtëpinë e vet! Nuk do të ëndërronte më për spaletat, as për lavdinë, nuk do të ëndërronte më... Mbase kjo luftë do të qe më mirë të mos kishte filluar. «Vërtet thua?...», — mendoi majori. Pastaj tha me vete: «Është era e vdekjes që na bën të arsyetojmë kështu?».

Dikush u rrotullua nëpër gjumë dhe ai ndjeu një trup

që u mbështet në trupin e tij. U largua me neveri dhe u mblodh i tëri në kapotën ushtarake. Por ishte shumë ftohtë, majat e gishtave të këmbës i dukej sikur i ishin paralizuar. «Ja ç'do të thotë i mundur...», — mendoi. «Ja ç'do të thotë të humbësh lirinë... Të hedh ai tjetri si qen në errësirë e nuk kujtohet për asgjë, veç kur të vjen e të këput pastaj një plumb dhe u lamë». Psherëtiu thellë. Një ushtar foli nëpër gjumë. Majori mbajti vesh, por nuk kapi dot asnjë fjalë. Pastaj e zuri gjumi.

Kur u zgjua, ishte bërë ditë. Nga dritarja qielli dukej i kaltër e i ftohtë. Iu afrua dritares. Gjithçka zbardhte. Një ushtar gjerman kaloi në rrugë. Dhjetëra zëra i thirrën:

— Pane! Pane! Pane!

Gjermani me gjakftohtësi iu përgjigj me një breshëri automatiku. Dritaret mbetën të braktisura, xhamat e tyre u bënë pothuaj copë të gjithë. Në dhomë ra një hesh-tje vdekjeje. Fytyrat e parruara të atyre njerëzve dukeshin tani edhe më të zbeta, edhe më të trembura. Era u lëshua nga të gjitha dritaret e mprehtë, e ftohtë.

— Do të na lënë të vdesim nga të ftohtët e nga uria, — tha me gjysmë zëri një ushtar. — Diçka duhet bërë, zoti major...

Majori nuk u përgjigj. Ai dukej sikur ishte plakur shumë gjatë këtyre dy netve. Iu afrua dritares fare i zbetë. Përjashta sapo kishte dalë dielli. Iu duk sikur atje përtej rrugës shtëpitë e ulëta të shqiptarëve përgjonin. «Ç'mendojnë, vallë», — tha me vete. Ushtari gjerman kaloi përsëri në rrugë. Hodhi një vështrim të rreptë nga dritaret dhe ndaloi. Majori ndjeu t'i pritëshin gjunjët. Një valë e ftohtë ia përshkoi gjithë trupin. Një çast u vështruan drejt në sy me gjermanin. Pastaj ushtari pështyu me përbuzje dhe u largua. Majorit iu duk sikur ajo e pësh-tyrë i spërkati fytyrën. Mekanikisht kaloi dorën në të.



Djersë të ftohta... Pastaj u largua nga dritarja dhe u mblodh në një qoshe. «Në qoftë se kanë për të na vrarë, pse s'na vrasin horrat?», — mendoi i zymtë dhe humbi përsëri në mendime. Dhe mendimet i silleshin në kokë të trubullta e të ftohta. I zunë sytë togerin. Ai i kishte hequr rrobat dhe ishte veshur si ushtar. U mundua t'i shmangej vështrimit të majorit i druajtur. Por majori as që e çante kokën. «Le të bëjnë ç'të duan», — tha me vete. «Secili ka të drejtë të përpiqet të ruajë lëkurën e vet... Unë nuk jam komandanti i tyre. Bile do të ishte mirë të mos kisha qenë kurrë», — dhe përsëri ëndërroi një jetë të qetë, pa lavdi e pa halle... Një jetë që do t'i nënshtrohej pa fjalë, nëse nuk do t'ia hidhnin trutë në erë aleatët. «Jo», — tha pastaj me vete. «Unë nuk do ta heq uniformën, do të ishte fare qesharake... Pastaj, kushedi, ata mund të na vënë bashkë përpara mitralozit. Kush thotë se do të bëjnë dallim?». Në drekë, duke pritur vdekjen, filloi të dremitste në një gjumë të mundimshëm e plot ëndrra të akullta.

## NUK ËSHTË KJO DASHURIA

Në mesnatë shiu filloi me rrëmbim. Shtrëngata u sul mbi bregun e detit, duke skërmitur dhëmbët e zjarrtë.

Nga një shkrepëtimë e fortë dritat e plazhit u fikën. Gjithçka e përpiu për disa çaste errësira, por nuk vonoi dhe shkëlqyen përsëri dritat me ngjyra mbi hotellet e turizmit, mbi kampin e pionierëve e neonet buzë detit.

Bato Rodoni u rrotullua në shtrat, ngriti pak kokën e vështroi nga dritarja qiellin që vetëtinte pareshtur.

— U pa puna, me sa duket ky pesëmbëdhjetëditësh kështu do të mbarojë, bëra gabim që nuk erdha në korrrik, — tha duke vështruar shokun e krevatit përbri, që i kërrusur si abazhuri që i bënte dritë mbi fletët e bardha shkruante pa ngritur kokën. — U bënë katër ditë, me të nesërmen pesë, që nuk e kemi parë diellin me sy. — Tjetri nuk u përgjigj.

Batoja u rrotullua edhe një herë, i mbërtheu sytë murit, pastaj duke dëgjuar pikat e shiut e zuri gjumi.

Kur u ngrit në mëngjes, qielli ishte fare i kthjellët. I habitur Batoja vështroi përjashta i kënaqur e deshi t'i fliste shokut, por kur vuri re se ai kishte rënë në një gjumë të thellë, doli nga dhoma në majë të gishtave, zbriti shkallët dhe u drejtua për në oborr.

— Më në fund na buzëqeshi edhe neve...

— Aman, ore, se plasëm, si u gdhive, Guri?

— Falem nderit, Bato... Unë që mbrëmë e mora me mend se do të hapej koha.

— Që mbrëmë!?!.., — Batoja qeshi. — Si e more me mend që mbrëmë?!..

— Sapo filloi të vetëtinte e të gjëmonte, unë i thashë Spiros që do të hapej koha. Pyete, po deshe... Në verë, pas shtrëngatës, hapet koha gjithmonë.

— Opo ne jse, puna është që të na mbajë këtej e tutje se plasëm.

Tjetri pohoi me kokë, se në atë kohë futi furçën e dhëmbëve në gojë. Batoja pasi u la, u largua.

Kur zbriti për të ngrënë mëngjesin, pasi hyri në mensë, u ul vetëm në një tryezë pranë dritares. Pak më tej ishin ulur tri vajza.

«Oh, sa e bukur», — tha me vete Batoja, duke vështruar njërën prej tyre. Asaj i shkëlqente fytyra dhe buzët i kishte aq të kuqe, sa në fillim të dukej se kishte vënë të kuq. Njëra nga dy të tjerat diçka u pëshpëriti shoqeve duke vështruar nga Batoja. Ato vështruan vjedhur nga ai, nga mënyra se si biseduan ato me njëra-tjetrën, e kuptoi se flisnin për të. E ndjeu veten krenar dhe ndjeu atë kënaqësi që provojnë ata që e dinë se emri i tyre është i dëgjuar.

Batoja ia kishte qepur sytë asaj me faqet e buzët e kuqe dhe po e vështronte me ëndje. Edhe vajza e vështroi nja dy herë, vuri lehtë buzën në gaz e i shkëlqyen sytë me gëzim, duke u ndier edhe ajo krenare për forcën e bukurisë së saj, për të cilën ishte plotësisht e vetëdijshme.

Kur vajzat u ngritën, Batoja i hodhi asaj një vështrim nga koka te këmbët.

— Trup të bukur që paska!, — bëlbëzoi.

Deti ishte qetësuar dhe aty nga dreka edhe rëra filloi të thahej. Gjatë gjithë bregut, trupa të zhveshur e gjallëronin plazhin, duke i dhënë një pamje krejt tjetër nga ajo e ditëve të vrenjtura e me shi.

— Do të të prezantoj me të?

— Kam shumë qejf, — u përgjigj Batoja duke i shtrënguar krahun shokut.

— Mirë, hajde!...

— Dale njëherë, prit!..., — nguroi ai nga që e ndjeu se po fillonte të tronditej. — Jo tani, mos mendojnë keq!...

— Hajde ore, mos u bëj budalla, nuk e kuptoj, pse do të mendojnë keq?!...

Batoja e ndoqi shokun duke u mbështetur në krahun e tij, si të donte doemos një pikë ku të mbështetej.

— Vera, nga jeni nisur kështu?, — u foli vajzave ai që ishte me Baton. Ato qëndruan. — Po Vjollcën ku e paskeni lënë sot, çudi!...

— Do të shkojmë të hipim në motoskaf.

— Mrekulli, mendim i shkëlqyer. A shkojmë edhe ne, Bato? Njihuni më parë: Bato Rodoni, besoj se e keni dëgjuar si emër.

Dy vajzat, të druajtura, i zgjatën dorën Batos, pastaj të katër filluan të ecin drejt «Apollonisë».

— T'i fusim vajzat në mes; shiko Bato, e di si më tha sot në mëngjes kjo për ty: «e përfytyroja krejt ndryshe».

Vajza u bë flakë e kuqe, por e mori veten menjëherë dhe foli duke vështuar drejt me guxim:

— Vërtet, nuk e di pse kisha përshtypjen se ju ishit i vjetër në moshë, mbase nga rolet që keni luajtur.

— Në cilin rol më keni parë ju?

— Nuk ju kam parë asnjëherë, por ju kam dëgjuar në radio, e ndjek çdo të mërkurë dhe të shtunë teatrin në mikrofon.

Batoja vuri buzën në gaz. E vështroi drejt në sy dhe ndjeu një dridhje diku thellë brenda vetes.

Deti ishte i qetë. Vera vështronte ujin e kthjellët që përplasej në hundën e motoskafit. Një shkumë e bardhë në formë rrahtësh mbetej pas e tretej pastaj kaltërsive. Dy vaporë të mëdhenj kishin hedhur spirancën dhe prisnin të futeshin në port. Marinarët që lëviznin mbi kuvertat e tyre dukeshin të vegjël e të hollë si fije shkrepëseje.

«Është shumë e bukur», — tha me vete Batoja, duke e vështruar nga afër.

Për disa sekonda ai u vrenjt në fytyrë, si ta kishte trubulluar një kujtim i hidhur, por me të hasur në vështrimin e saj, përsëri i qeshi fytyra.

Motoskafi rrëshqiste shpejt mbi ujë dhe ai ndiente erën që i rrihte fytyrën dhe i hidhte flokët e verdhë prapa. Vasili, shoku i tij, nuk pushonte asnjë sekondë, si të ishte kurdisur. E folura e tij pompoze për pak e bëri të qeshte Baton, por shpejt kafshoi buzën dhe u përmbajt.

Dielli pasqyrohej në det, pikërisht në drejtimin që ndiqte motoskafi. Vezullonte deri tej në horizont një fashë e zjarrtë, që të vriste sytë. Por motoskafi ktheu djathtas dhe u hodh përpara, duke i çarë mes për mes valët e kaltra, që i sulleshin drejt.

— Mos harroni se Resuli mban mbi supë eksperiencën e kaq viteve, — fliste Vasili, ndërsa Bato Rodoni, i heshtur vështronte në det. Edhe vajzat dukej sikur dëgjonin, por në fakt ato ishin zhytur në ëndrrat e tyre. — Interpretimi nga ai i roleve me një koshiencë skuro është formidabël, apo jo, Bato?

Batoja u ndodh në një befasi të atillë, thuajse u zgjua nga gjumi, por megjithatë mundi të përgjigjej:

— Ashtu është...

— Është fatalitet që një aktor i tillë të interpretojë në një skenë varfanjake, në provincë. Pastaj, ai edhe si dramaturg është i mahnitshëm. Ta lësh të shuhet një yll i tillë në një qytet, ku ç'të të them...

— Në këtë pikë nuk jam dakord me ty, — foli fare shtruar Batoja. Vajzat e vështruan si të ishin shkundur nga një ëndërr. — Edhe Molieri në një trupë endacake i ka vënë në skenë veprat e tij, por është i pavdekshëm edhe sot, pak kaq vitesh...

— Po, po, e di, e di, sa mirë që ma kujtove Molierin, vërtet ashtu është, si është ajo thënia e famshme: Për kurrgjë nevojë nuk kanë veprat e mia për famën... Jo... Dale more se në mend e kam. Po, po, kështu fillon: Për kurrgjë... jo...dale!...

— Mos do të thuash për atë mbishkrimin?...

«Lavdia s'ka për kurrgjë nevojë, kurse e jona ka nevojë për të».

Vera u bë flakë e kuqe.

— Të lumtë, Vera, të lumtë, ma mëre nga goja... Një grand vlerësim, apo jo, Bato? — Po Batoja këtë radhë nuk u përmbajt dot dhe qeshi sa i dolën lotë. Pastaj u bë flakë i kuq ngaqë e ndjeu veten ngushtë. Vasili u hutua aq shumë, sa filloi t'i merrej goja.

— Pse qesh?!... Unë e dija, por u ngatërrova, bile e di edhe frengjisht.

— Jo, nuk qesh për atë, mos më keqkupto, — tha Batoja po nuk diti ç'të thoshte tjetër.

— Bile e di edhe ku është ky mbishkrim, në akademinë franceze...

— Mua m'u qesh se vetëm ty s'po të vinte në mend atë çast.

Heshtën duke vështruar secili diku. Ndërtesat e Durrësit zmadhoheshin, sa më shumë motoskafi i afrohej bregut.

— Kush është më i madh, babi, Durrësi apo Tirana, — e pyeti të atin një djalë i vogël rreth pesëvjeç.

— Tirana është më e madhe.

— Po Durrësi ka edhe detin, babi, pse është Tirana?!...

I ati qeshi duke i përkëdhelur kokën të birit. Batoja vuri buzën në gaz dhe vështroi Verën. Edhe ajo po e vështronte djalin e vogël me ngrohtësi. Vetëm Vasili vështronte diku i zymtë. Motoskafi lëkundej lehtë.

\* \* \*

Një lokomotivë vërshëlleu gjatë e pastaj u dëgjua zhurma e rrotave të hekurta, që dalngadalë u largua, deri sa humbi përsëri në atë shushurimë të vazhdueshme që bënë valët duke u përplasur në breg.

Batoja u rrotullua në shtrat, psherëtiu se po i dhimbte koka e s'po mundte të flinte.

Shoku i tij i dhomës shkruante i përkulur mbi tryezë.

Batoja e vështroi dhe përsëri psherëtiu. Ai e njihte atë rrëmbim të ngrohtë, atë kënaqësi të qetë dhe gëzimin që të jep një punë e dashur. Për disa çaste Bato Rodoni mendoi me zili. E pati zili lehtësinë e shpirtit të atij tjetrit, që këto çaste dukej sikur ishte shkëputur nga hallet e rëndomta që i zienin Batos përbrenda. Kjo dukej qartë në të gjithë qenien e atij njeriu, që tani punonte pa çarë kokën për asgjë tjetër. Bato Rodoni e vështroi shokun e tij dhe për një çast e krahasoi atë me një tokë pjellore, që kundërmon gjallëri, e heshtur, por pikërisht në heshtjen e saj fshihet madhështia, se në gjirin e shkrifët të saj

mbulohet fara, që nesër do të shpërthejë me tërë gjelbërimin e bukurinë e vet.

Baton e zuri gjumi vonë dhe pa dalë dielli i hapi sytë. Në krevatin karshi, tjetri flinte. Ai bënte një gjumë të thellë dhe fare të qetë. Në majë të gishtave Batoja doli nga dhoma. Ashtu gjysmë i zhveshur shkoi në buzë të detit. Mbërtheu duart prapa dhe ia qepi sytë horizontit të kaltër. Një delfin nxirrte herë-herë kurrizin e zi mbi ujë, pastaj humbiste përsëri thellësive.

«Është një marrëzi e vërtetë... — tha me vete, — ajo është shumë e re».

Mendime të trubullta e rrëmbyen dhe e bënë më të zymtë fytyrën e tij, ku shquheshin mundimet e një nate me një gjumë të shqetësuar.

Më pas u kthye dhe vështroi drejt kampit të punëtorëve. Vështrimi i tij i ngrysur u përqëndrua diku me vëmendje, pastaj u çel si me magji. Ajo po vinte vetëm drejt bregut dhe atij iu duk se kjo nuk ishte e rastit. Rrahjet e zemrës iu bënë më të forta dhe ai ndjeu gumëzhimën e tyre të brendshme. Mendimet që i ishin harlisur tërë natën në kokë, u tretën, si mjegulla e hollë që trembet nga dielli. Dëshira që deri atë çast ishte strukur e druajtur nga mendimet, u ndez menjëherë dhe e mbushi me një gëzim tronditës.

Duke u afruar ajo, e vështroi e qeshur dhe vetëm kaq u desh, që të bëheshin thërmia-thërmia të gjitha mendimet e natës.

—Edhe ju paskeni dalë herët...

— Po, më pëlqen shumë të dal herët buzë detit.

— Mirëmëngjes!

— Mirëmëngjes!, — iu përgjigj Batoja dhe i shtrëngoi dorën, që ajo ia zgjati.

Bato Rodoni u mbush me frymë dhe ajri i detit sikur i përzuri gjithë psherëtimat dhe e freskoi tërë qenien



e tij. Vështroi qerpikët e saj të gjatë, buzët pak të fryra dhe i harroi të gjitha ligjet e rregullat e logjikës.

Trupi i derdhur i Batos, flokët e verdhë pa asnjë thinjë, fytyra e freskët, që e tregonte shumë më të ri nga ç'ishte, e mbushën me besim dhe e bënë të mos mendonte më për diferencën e moshës së tyre, që, sipas atij, duhej patjetër të ishte e madhe.

Mbase ky qe shkaku, ose për të thyer heshtjen ai u kthye edhe një herë në bisedën e një dite më parë.

— Domethënë ju më përfytyronit plak?...

— Po, po, — qeshi vajza.

— Por megjithatë nuk jam i ri, — tha pak i pikëlluar ai.

— Sa vjeç jeni?, — pyeti ajo fare pa të keq.

— Ja, sa thoni ju?

Vera e vështroi me vëmendje fytyrën e tij. Batoja kishte një fytyrë vërtet të hijshme.

— Ju duhet të jeni rreth të tridhjetave.

«Falem nderit shumë, — mendoi ai, — dymbëdhjetë vjet më pak».

— Hë, e gjeta?

— Aty afër i re, — buzëqeshi duke mos mundur ta fshihte kënaqësinë. — Po ti sa vjeç je?

— Jam shtatëmbëdhjetëvjeç, — tha Vera dhe u skuq.

— Shtatëmbëdhjetëvjeç?!... Oh, lum si ti!, — qeshën të dy. Pastaj Batoja shtoi:

— Domethënë, sikur unë të bëhesha ndonjëherë burri yt, ti duhet të këndoje gjithë ditën këngën «Kuvendon Marta me gra».

— Jo, pse, tridhjetë vjet nuk janë shumë, — tha Vera duke qeshur.

«Por dyzet e dy nuk janë pak», — tha Batoja me vete.

Ky mendim i zgjoi disa mendime të tjera që i dilnin kundër asaj dëshire që tani po e pushtonte, por mjaftoi

një vështrim i ngrohtë i saj, që të gjitha ato mendime të fshiheshin përsëri diku brenda tij, që mbase në kohën e përshtatshme të ngrenin prapë krye e të thërrisnin: «Bato Rodoni, ku të shpie mushka? . . .».

Por zymtësia që u duk disa sekonda në fytyrën e tij humbi në gëzimin që i jepte bukuria e saj.

Hëngrën mëngjesin bashkë e pastaj përsëri dolën, përsëri buzë detit.

— Ke një diksion shumë të kulluar, pastaj, nuk ta them për të të bërë qejfin, je shumë e bukur dhe trupin e ke shumë të rregullt, pse nuk provon të japësh prova për të hyrë në Institutin e Lartë të Arteve, ëëë, si thua?

Vera u bë flakë e kuqe dhe nuk i rezistoi dot vështrimit të tij të ndezur.

Tani Batoja ishte i sigurtë në hapat që hidhte. Përsëri drekën e hëngrën bashkë e pas disa ditësh një mbrëmje shkuan të dy në pistën e vallëzimit, në «Iliria».

Kur dolën prej andej, kamerierët po mblidhnin mbulesat e tryezave dhe bënë pregatitjet për të mbyllur lokalin.

— Sikur e ke trashur ca me atë artistin, — i tha të nesërmen njëra nga shoqet Verës. Por ajo as i ktheu fare përgjigje, hapi valixhen, kërkoi diçka brenda me nxitim, pastaj doli.

Mëngjesi ishte i ngrohtë dhe i kthjellët. Vera i zbriti shkallët duke i kapërcyer nga dy, i buzëqeshi Batos nga larg, pastaj të dy u nisën nga bregu i detit.

Batoja e vështroi, i buzëqeshi, por buzëqeshja e tij tani dukej e lodhur, nuk bënë vetëm disa hapa dhe ai u ngrysi përsëri:

— Çfarë ke?, — e pyeti ajo. — Edhe dje kështu ishe i mërzitur.

— Jo, — tha ai, — ashtu të duket ty, — po në të vërtetë Batoja e ndiente veten fare të rraskapitur. Bile

herë-herë i dukej sikur nuk do të kishte forca t'i jepte asaj qoftë edhe një buzëqeshje.

Në mbrëmje i tha se i dhembte koka dhe u nda prej saj.

Kur u kthye në dhomë shoku i tij i përkulur mbi tryezë as që e ngriti kokën. Batoja qëndroi një çast drejt në këmbë me duart në xhepa, pastaj mbylli derën ngadalë. Tjetri shkruante me aq nxitim, si të trembej se do ta detyronin nga çasti në çast ta ndërpriste punën. Fytyra e tij ishte si në ethë. Mbi tryezë ishin shpërndarë një sasi e madhe fletësh të shkruara me kaligrafi të çrregullt.

— Hëngre bukë sonte, apo përsëri harrove?, — e pyeti Batoja, por ai e vështroi vetëm një çast si i hutuar, pastaj pa i kthyer përgjigje u përkul përsëri mbi letrat.

Atëherë Bato Rodoni u kthye i plogët, u zhvesh ngadalë dhe u shtri në krevat. E ndiente veten të lodhur e mendoj se gjumi do ta zinte menjëherë. U kthye nga muri dhe mbylli sytë. Por nuk kaloi shumë dhe sytë iu hapën, pa e kuptuar edhe ai se si. Ata u mbërthyen në një pikë dhe filluan të ndiqnin mendimet që po i zienin në kokë. Filluan t'i dhembnin tëmthat, u rrotullua sa në një-rën anë në tjetrën, por nuk gjeti qetësi.

Nga njëra anë përfytyrimi i ndezur nga dëshirat e mundonte me magjinë e figurave, veshur me atë mjegullën e lehtë të ëndërrimit. I dukej sikur shihte trupin e saj.

Nga ana tjetër, me qetësi e sulmonin të tjera mendime.

Pas një gjumi të shkurtër dhe plot ëndrra, Batoja u zgjua dhe vendimi i parë që mori ishte t'i jepte fund kësaj gjendjeje. A mund të dashurohej me të?... Cilat do të ishin pasojat?... Të mbyllte sytë e të dilte ku të dilte?... Po sikur të përsëritej ajo që kishte ndodhur vite më parë?... E pse të mos përsëritej, në fund të fundit, a nuk ishin

po ato rrethana?... Ku e njihte ai atë vajzë?... Po ajo ku e njihte atë?...

— Mirëmëngjes!, — i tha ajo e qeshur.

— Mirëmëngjes!, — i tha Batoja i zymtë.

Vera e vështroi drejt, si të donte të zbulonte shkakun që e bënte të ngrysur.

« Në djall të venë të gjitha filozofitë, — tha ai me vete duke vështruar fytyrën e saj të bukur. — Të dalë ku të dalë». E shkundi në çast gjithë plogështinë dhe i buzëqeshi duke e vështruar drejt.

— Hajde, hajde, dalim nga bregu...

Dita ishte e kthjellët, por frynte një erë e freskët nga deti. Valët e vogla dukej sikur e lëpinin tokën e ngjeshur e të lëmuar atje ku bregu fillonte e futej nën pushtetin e ujit.

Batos përsëri iu shua padashur buzëqeshja. U ngrysur dhe, kur ajo e vështroi si të donte ta pyeste, ai u nevrizoi me veten e tij, që tani i ngjante një barke e cila lëkundej sa andej këtej, pa ditur nga të drejtohej.

— Domethënë, — foli ai si me vete, — unë do të dërgoj njerëz në shtëpinë tënde, do të fejojemi e pastaj, pas disa muajsh, do të martohemi, apo jo? — Vera e vështroi e hutuar. Toni i tij e trembi. — Pse nuk përgjigjesh, a nuk jemi marrë vesh për këto?... — Ajo nuk po ia ndante sytë që po e vështronin të habitur. — Po mirë, nuk më thua, a mund të jemi të sigurtë se pas martesës do të jemi të lumtur?...

— Në rast se ti nuk i ke pasur gënjeshtër gjithë ato që më ke thënë s'ka pse të mos jemi të lumtur, — foli ajo me guxim që karakterizon moshën e saj.

— Jo, sigurisht që unë nuk të kam gënjer, por trembem mos të gjitha ato që të kam thënë na dalin ëndrra. Ne nuk e njohim njëri-tjetrin, Vera. Kësaj i trembem unë. E ku më njeh ti mua?... Si guxon bile të mendosh për

t'u bërë gruaja ime?... Unë jam shumë i lig, Vera, ti nuk më njeh. Por unë e njoh veten, jam shumë i lig. — Batoja heshti, kurse Vera po e vështronte si e ngrirë. — Unë jam dyzetedyvjeç e jo aq sa pandeh ti...

— As më duhet se sa vjeç je ti, — foli e ndezur ajo si një fëmijë, që po i rrëmbejnë diçka të dashur e që nuk pranon asnjë lloj arsyesimi.

Batoja e vështroi me një dhembje të dukshme dhe aty për aty vendosi përfundimisht:

— Dëgjo, Vera!..., — psherëtiu thellë, heshti disa sekonda e vazhdoi duke vështruar diku në det: — Shkojmë ulemi të bisedojmë shtruar. — Ajo e ndoqi pas. Të dy shkuan e u ulën pak më tej, mbi rërën që sapo kishte filluar të ngrohej. — Unë, siç të thashë, jam dyzetedyvjeç... — Vështroi përsëri larg në det, si të kërkonte atje fillin e kujtimeve të viteve të shkuara. — Kam qenë i martuar..., — Vera e vështroi fytyrën e tij, që tani ishte bërë fare e ftohtë. Ajo u zbeh. — Isha njëzeteshtatëvjeç kur u martova. Besoj se nuk kisha dashuruar asnjëherë para se të njihesha me gruan time dhe mbase prandaj pandeha se u dashurova me të. Ja po ta them se u martova me të vetëm se ishte e bukur. Vetëm më vonë e kuptova se nuk ishte e mjaftueshme kaq për t'u lidhur përjetë me një njeri. Me një fjalë u martuam pas një së ashtuquajture dashuri vështrimesh. Menduam se patjetër do të ishim të lumtur. E pse mos të ishim të lumtur?... A nuk ishte e bukur ajo? A nuk i pëlqeja unë asaj?...

Në fillim gjithçka vajti mirë, deri sa ne u ngopëm me ato vështrime, ose si ta them më mirë deri sa ne u ngopëm me atë që kishim quajtur dashuri. Por, kur me kalimin e kohës i hapëm njëri-tjetrit ato dy botë të dukshme deri atëherë, botën tonë që fshihej brenda secilit, mendimet, dëshirat, ndjenjat, veset, me një fjalë karakteret tona, atëherë plasi e keqja.

Kanë kaluar kaq vjet që atëherë e nuk mund t'i kujtoj dot të gjitha, por më kujtohet mirë që grindeshim gjithmonë e për gjëra aq të parëndësishme, sa tani nuk di të të them përse grindeshim.

Më kujtohet se çdo gjë që thoshte ajo, sidomos kur kishte njerëz të tjerë, mua më dukej artificiale, më dukej sikur ajo në çdo rast donte të tregonte veten.

Jetuam kështu plot dy vjet, por nuk patëm fëmijë.

Një ditë unë po gdhendja në kopsht një copë shkop me një thikë të vjetër. Nuk më kujtohet përse po grindeshim, por më kujtohet mirë dhe jam fare i sigurtë që ajo që bëra që krejt pa dashje ose, si të ta them më mirë, veprova pa vetëdije. Ajo më kundërshtoi dhe unë i nxehur e flaka në drejtim të saj shkopin që kisha në dorë. Pastaj ngriva në vend, kur e pashë me duar në fytyrë dhe nëpërmjet gishtave të saj gjak që rridhte ngadalë. Më shko mendja se mos i kisha nxjerrë ndonjë sy dhe u tmerrova. Iu afrova me nxitim dhe atë çast isha gati t'i bija në gjunjë. Ia hoqa duart nga fytyra dhe pashë sytë e saj mbushur me lotë. Nxora shaminë dhe ia fshiva faqen e gërvishur. Duart po më dridheshin. Isha gati t'i thosha se isha gomar, se isha anormal, e nuk e di çfarë tjetër më ziente ato çaste në tru, por ajo u kthye dhe iku duke vrapuar. Vërtet ato çaste më shko mendja se nuk isha në rregull, m'u duk vetja se kisha kaluar çaste çmendurie të vërtetë. Sidomos veprimin tim krejt të pamenduar nuk dija ta shpjegoja. Njëqind herë u mata atë ditë t'i kërkoja të falur, t'i kërkoja të falur me gjithë zemër. Unë vetë kisha folur me pasion kundër atyre që rrahin gratë, duke thënë fjalët më të poshtra për ta, duke e quajtur një veprim që nuk pranon asnjë justifikim, duke menduar sidomos se në këtë rast njeriu shfrytëzon dobësinë fizike të gruas. Por ç'vlenin tani të gjitha ato që kisha thënë, a nuk isha i tillë edhe unë?

Nuk e harroj dot kurrë heshtjen e asaj mbrëmjeje. U futa në shtrat dhe e vështrova nga afër. Ndieva një dhembje copëtuese. Ajo dukej si një fëmijë që e kanë rrahur e nuk di pse e kanë rrahur. Vështronte tavanin, por e ndieja që më shihte me cepin e syrit. I kërkova të falur dhe ia zura kokën me duart që më dridheshin. Filloi menjëherë të qante me dënësë. Desha ta qetësoja duke iu lutur e duke thënë fjalët më të rënda për veten time, por ajo vazhdonte njëlloj. Gjithë trupi i dridhej nga ngashërimi. Pastaj papritur m'u shtrengua e tëra pas trupit, m'i lidhi fort duart rreth qafës dhe vazhdoi më me vrrull të qante mbytur, me fytyrën fshehur në gjoksin tim.

— Ç'bën kështu?, — i thashë aq i tronditur, sa po më zihej fryma.

— E di..., — tha ajo..., — e di..., — dhe e mbytën përsëri dënësat.

Nuk e di pse atë çast më kapi një frikë e çuditshme nga ato fjalë pa kuptim. Mbase gjendja e rëndë e çastit apo nervat e mi të tendosur, po një parandjenjë rrëqethëse më përshkoi të tërin.

— Çfarë di?, — i thashë me ankth, — më thuaj, çfarë di?

— E di..., — përsëriti ajo, — e di, — dhe përsëri dënësat nuk e lanë ta mbaronte fjalën. Por pastaj si duket e mblodhi veten, më lëshoi, fshiu lotët e ktheu prapë fytyrën nga tavani dhe mbase u qetësua pak.

— E di që kjo kështu do të vazhdojë, Bato. Ti nuk më do dhe për këtë nuk ke faj. Jam e sigurtë që ti nuk më do, prandaj grindemi... Ne gabuam, por unë do ta ndreq këtë gabim. Dashuria nuk është ajo që kujtonim ne!...

— Pse flet budallallëqe?!..., — i thashë me rrëmbim. Por nga ana tjetër më shkuan mornica nëpër gjithë tru-

pin. Fjalët e saj ishin të drejta. Unë kurrë nuk e kisha dashur atë. Bile mua ato çaste po më bëhej e qartë se kurrë nuk kisha dashur njeri, bile unë nuk dija të doja... Unë vetëm kisha vrapuar pas dashurisë, por kjo s'ishte dashuria; kuptohej që ajo kishte të drejtë. Të nesërmen, ajo iku dhe nuk u kthye më kurrë.

Bato Rodoni ishte bërë dyllë i verdhë. Edhe tani, pas kaq vitesh, ky kujtim e bëri t'i mbulohej fytyra me djersë të ftohta. Vera, e zbetë edhe ajo, vështronte larg në det.

— Nuk dua të bëj një gabim të ri, të ngjashëm me të vjetrin, — tha me zë të shuar. — Ne nuk e njohim njëri-tjetrin, Vera... — Psherëtiu dhe heshti gjatë... Pastaj, mosha ime, ... — ktheu kokën, por ajo nuk ishte më aty. I shqetësuar Batoja vështroi përreth. Ajo po largohej me hapa të shpejtë.

— Iku, — belbëzoi dhe psherëtiu përsëri. E ndoqi me sy deri te kthesa, pastaj mbështeti mjekrën në kurrizin e dorës e vështroi përsëri detin.

Kur u kthye në dhomë, shoku i tij sapo ishte ngritur nga gjumi.

— E mbarova!, — tha ai dhe fytyra i shkëlqeu. — Do të nisem që sot për në Tiranë, më mori malli për kalamanjtë.

— Po gruan e do?, — e pyeti ftohtë Batoja.

Tjetri qeshi.

— E si nuk e dua gruan?!... Ç'pyetje!...

— Sigurisht që gruaja jote do të jetë shumë e bukur. Sa vjet ke i martuar?

— Sa budalla je, Bato. E ç'rëndësi ka bukuria? Gruaja është njeriu më i afërt. Me të vite e vite ke ndarë përgjysmë çdo gëzim, çdo hall, kur e do një njeri, të duket i bukur sido që të jetë... Po ç'paske kështu sot ti?

— Unë ç'kam?... E ç'mund të ketë një njeri si unë?...



Ti punove gjithë këto ditë dhe tani je i gëzuar. Kurse unë gjithë jetën jam marrë me gjëra hiçe... Ti ke gruan, ke fëmijët, kurse unë jam i vetëm e me sa duket kështu do të mbetem. Mirë të më bëhet. Kështu e pëson gjithmonë njeriu kur i shikon gjërat vetëm nga ana e jashtme... — I ktheu krahët shokut dhe vështroi nga dritarja.

— Po kur e kupton këtë, nuk është keq, Bato. Si i thonë asaj fjalës: «Më mirë vonë se kurrë».

— Po, — u përgjigj ngadalë Batoja, — mbase është më mirë ashtu: «Më mirë vonë, se kurrë», po kam frikë se tani është tepër vonë për mua.

— Jo, Bato, kurrë nuk është vonë për njeriun, kur e gjen rrugën që duhet të ndjekë...

Batoja nuk u përgjigj. Ai vështronte diku në horizontin e kaltër, i humbur në mendime. Por thellë në zemër ndiente atë qetësi, që i kishte munguar mbase gjithë jetën.

## G J A K U

— Erdhi Haki Sula.

— Kur u kthye?

— Mbrëmë.

Të tre burrat heshtën të menduar.

— Djall, o punë, —tha njëri prej tyre duke shkundur çibukun te guri ku ishte ulur, — tani do të ngatërrohet puna... Andoni është kokëshkëmb... Ai disa gjëra i kupton së prapthi.

— Ti, xha Milto, duhet të bisedosh me të.

Plaku nuk u përgjigj. Të dy të tjerët shkëmbyen nga një vështrim të shpejtë.

— Do të flas edhe unë me të, bile që tani duhet ta gjej.

Ai u ngrit ngadalë dhe filloi të zbriste tatëpjetë. Andonin e gjeti pranë një lisi të madh. Rrinte mbështetur mbi bërryla, pushkën hedhur te gjunjët dhe vështronte diku zymtë.

— E paska marrë vesh..., — tha me vete Miltoja dhe u afrua ngadalë.

— Pse mendohesh, Andon?

Plaku u mundua të vinte buzën në gaz. Edhe Andoni u mundua të buzëqeshte, por vetëm u ngërdhesh, pastaj fytyra e tij e gjerë u ngrys përsëri.

— E di pse ke ardhur, — tha pas pak dhe heshti.

Plaku nuk iu përgjigj. Të dy qëndruan ashtu të heshtur një copë herë të gjatë.

— Do të më thuash që nuk duhet të ngre dorën kundër Haki Sulës... Mbase do të më thuash edhe të pajtohem me të... Se kështu e kërkon interesi i atdheut. Apo jo? Ndryshe do të më flakni jashtë çetës. Këto edhe të më thuash?...

— Nuk do të të bëj rixha, —tha prerë dhe ftohtë plaku. — Vëllai yt i vrau atij të atin, ai vrau tët bir dhe iku kaq vjet. Tani u kthye në vendin e vet. Mbase nesër do të hidhet edhe ai si ne maleve të luftojë italianin. Ti i di ligjet tona, Andon, po qëlllove kundër tij, shpagimin do ta kërkojmë ne...

— Po më tremb, xha Milto?

— Jo, vetëm po të tregoj rrugët; njëra është jona, tjetra është kundër nesh.

Xha Miltoja u ngrit dhe u largua ngadalë. Andoni shtrëngoi nofullat fort. Sytë i lëshuan zjarr.

— Jo!, — belbëzoi ndërmjet dhëmbëve. — Të dalë ku të dalë. Nuk ia fal gjakun e tim biri. — Dora e tij gjithë damarë shtrëngoi grykën e ftohtë të pushkës. Pastaj me një lëvizje të rrëmbyer u ngrit dhe u largua me kokën varur përpara. Të nesërmen doli te lajthishtet, në qafë dhe zuri pritë. Ishte mëngjes i kaltër maji. Andoni i kishte qepur sytë atje larg, në krye të rrugës e priste i zyrtë. Mendimet i zienin në kokë me vrull. Ndiente një zbrasësirë pa fund në vete. I dukej sikur nuk do të duronte dot. Që kur mori vesh se kishte ardhur Haki Sula, nuk kishte futur kafshatë buke në gojë. Goja i ishte bërë helm nga duhani. Ishte si i dehur nga pagjumësia.

«U dashka të bëhem unë Krisht, — mendoi. — Jo, Haki Sula, jo!... Do të ma paguash me kokën tënde».

Dielli ngrihej dhe të nxehtët shtrëngonte. Tyta e pu-

shkës së tij zgjatej përpara duke vështruar me atë syrin e vetëm fundin e rrugës. Andoni, pushka e shkëmbi dukej sikur përgjonin të tre pa marrë frymë.

— Nuk është e mundur, — tha ai me zë të ulët, — nuk është e mundur të më ketë gënjyer Selimi. Ai duhet të vijë patjetër, po pse po vonohet. — Donte ta kryente sa më parë atë që kishte ndër mend, jo nga padurimi i hakmarrjes, po nga torturat e anktheve dhe të mendimeve që e brenin. Kur pa në krye të rrugës një pikë të zezë, iu tha pështyma. E mbuluan djersët. Zemra filloi t'i rrihte aq shpejt, sa i dukej sikur tronditjet e saj vinin thellë nga nëntoka, thellë nga zemra e shkëmbit. Kjo pikë e zezë filloi të afrohej dhe dalngadalë po merrte formën e një njeriu dhe më në fund ai dalloi qartë bashkëfshatarin e tij, Haki Sulën. Me duart që i dridheshin drejtoi mirë pushkën dhe e vështroi atë me një sy nëpërmjet kanalit të shenjestrës. Trupi i Haki Sulës zmadhohej gjithmonë e më shumë. Tani atij filluan t'i dalloheshin pothuaj rrudhat e shumta të fytyrës shenja të thella vuajtjeje. Për çudinë e tij të madhe, gjithë ajo dëshirë për hakmarrje, që e kishte ruajtur thellë në vete aq vite, tani iu zbeh papritur dhe bile për një çast iu dhimbs ai njeri i kërrusur, i plakur, që po vinte përballë grykës së pushkës. Shkëmbi dukej sikur trokiste ende më fort në çdo rrahje të zemrës së tij. Gishti tregues dridhej duke prekur lehtë këmbëzën e ftohtë, indiferente. Gryka e zezë e pushkës e ndiqte çdo hap fshatarin, që i ngjitej ngadalë së përpjetës. Po ku ishte tani urrejtja e viteve që kishin shkuar? Mos ishte shuar ajo bashkë me vitet, e prej saj, si prej një zjarri, kishte mbetur hiri, vetëm forca për të ruajtur zakonin? Andoni u mundua të sillte ndër mend trupin e përgjakur të djalit të tij, shtrirë në dhomën e zjarrit. U mundua ta ndizte edhe një herë atë zjarr të shuar para se të shkrepente pushkën. Por mendimi nuk

i bindej. Ai fluturoi në skajin tjetër dhe filloi t'i gjëmonte në veshë:

«Jo, po të tregoj rrugët; njëra është jona, tjetra është kundër nesh...»

Ti duhet të kuptosh, Andon, se hakmarrja u ka shërbyer dhe u shërben armiqve tanë.

Flake zakonin, Andon, se vetëm ai të bren tani... Kanë kaluar kaq vite...

Në rast se në një kohë të tillë nuk u nënshtrohesh interesave të atdheut, je tradhtar!».

Filluan t'i erreshin sytë.

«Je tradhtar!... Je tradhtar!... Je tradhtar!...».

Figura e Haki Sulës filloi të lëkundej sa andej-këtej drejtimit të shenjestrës. Ai e lëshoi pushkën dhe mbuloi fytyrën me të dy duart. Kur hapi sytë, Haki Sula po largohej i kërrusur. Andoni psherëtiu i lehtësuar. Pastaj mori pushkën dhe u nis në anën tjetër të rrugës. Atje poshtë dukej fshati i tij. E vështroi një copë herë dhe vazhdoi rrugën.

## PARTIZANËT

Vështroja me njërin sy nga një e hapur e vogël e perdeve. Sheshi ishte mbushur me partizanë. Fatmiri, një shoku im, kishte vënë kapelën e njërit prej partizanëve dhe qeshte me të. Më vinte të qaja nga dëshpërimi. Të gjithë shokët e mi ishin te sheshi, të gëzuar. I vështroja ata dhe mendja ku nuk më shkonte. Në shtëpi të gjithë rrinë si të ngrirë nga frika. Babai është fshehur te mulliri i vjetër. Nga fëmijët vetëm unë e di. Mbrëmë natën, kur i çova bukë, ai më përcolli përtej oborrit të mullirit, më puthi e pastaj u kthye i vetëm në errësirë. Mbrëmë deri vonë nuk më zuri gjumi. Në mulli kam parë minj të mëdhenj. «Si do të ketë fjetur babai mbrëmë atje?», — thosha me vete dhe vështroja shokët me zili. Sabriu është ulur pranë një partizani dhe ledhaton pushkën e tij. Të tjerët janë grumbulluar përreth dhe dëgjojnë me vëmendje. Partizani diçka u tregon.

Gjyshi u kollit edhe unë nuk e di pse u hodha përjetë i trembur. Në shtëpi të gjithë heshtnin, sikur të ketë vdekur njeri. U largova nga dritarja dhe në majë të gishtave iu afrova gjyshit. Doja t'i bëja njëqind pyetje, por heshtja që zotëronte në shtëpi më bënte të druajtur. Mbështeta kokën në supin e gjyshit dhe psherëtiva. Shokët e mi qeshnin të kënaqur, kurse unë... Më vinte të qaja sa të mos më mbetej pikë loti. «Pse vallë duan ta

vrasin ata babanë?... Ah, të mos ishte komandant i tyre ai Fadili i Metajve!... Ç'fat të keq që kishte pasur shtëpia jonë! Ndryshe do të qe të mos ishte ai komandant i tyre. Mbase atëherë ata nuk do të donin ta vrisnin babanë. Atëherë edhe unë mund të shkoja si shokët pranë tyre. Ah, sa qejf do të kisha të isha me shokët tani!»

— Po vijnë, po vijnë!..., — u dëgjua një zë nga korridori. Shtëpia u vu në lëvizje si të kishte rënë tërmet. Gratë hynin e dilnin nëpër dhoma duke vrapuar si të mos dinin ku të futeshin. Vetëm gjyshi nuk lëvizi nga vendi. Vura re se ai u ngrys dhe më shumë dhe filloi të dridhte një cigare. As unë nuk lëviza nga vendi. U ngjsha më tepër pranë gjyshit dhe më kujtohet që m'u mblodh një lëmsh në grykë. «Ata nuk do ta gjejnë dot babanë, — thashë me vete, — le ta kërkojnë sa të duan. Unë nuk do t'u them se ku është babai, edhe sikur të më djejin të gjallë!».

U dëgjuan hapa në korridor, pastaj unë pashë tek hynin dy partizanë në dhomë. Njëri ishte ai, Fadili i Metajve. E njihja atë, ma kishte treguar nëna nga dritarja, por, për habinë time, ai qeshte dhe iu afrua gjyshit, duke i zgjatur të dyja duart.

— Mirë se të gjej, xha Sulo!

— Mirë se vini!, — tha gjyshi dhe i vështroi me vërejtje të dy njërin pas tjetrit. Pastaj ai, Fadili, më përkëdheli kokën mua.

— Po ti, more trim, i kujt je?

Mua më kishin mbetur fjalët në grykë. Gjyshi u kollit dhe u bë flakë i kuq.

— Urdhëroni, urdhëroni rrini, — u tha gjyshi.

Ata u ulën këmbëkryq rreth vatrës. Pastaj filluan të dridhnin nga një cigare nga kutia që u zgjati gjyshi. Pas pak në dhomë hyri nëna me një tabaka, ku ishin dy gota raki. Vura re se nëna ishte e zbetë dhe tabakaja dri-

dhej në duart e saj. Partizanët i morën gotat në dorë dhe heshtën një çast si të prisnin njëri-tjetrin.

I pari foli ai, partizani tjetër. Ishte një burrë me trup të madh, i thinjur, por me fytyrë të qeshur.

— Të gjitha të mirat, gëzuar, o plak!

— Të bëftë mirë!, — iu përgjigj gjyshi.

Ai e ktheu gotën të gjithë menjëherë.

Pastaj unë ia mbërtheva sytë atij, Fadilit të Metajve. Më kujtohet mirë se atij i dridhej dora tek mbante gotën e rakisë. U kollit fort e pastaj foli pa ia ndarë vështrimin gjyshit.

— Për gëzime, gjysh!.. Të shkuara e të harruara qofshin!..

E ktheu gotën, pastaj tha i qeshur:

— Nuk po e shoh Kamberin!

Gjyshi seç belbëzoi duke iu marrë goja.

— Dëgjoni!, — vazhdoi me zë të qartë ai, — i thoni Kamberit të mos fshihet nga ne. Ne luftojmë armiqtë dhe tradhtarët, nuk kemi dalë malit për hasmëritë e vjetra. — Mori një urë zjarri, e rrotulloi dhe pastaj e lëshoi përsëri.

— Bisedova dhe në shtëpi... ne jua kemi falur gjakun, prandaj erdha, xha Sulo, që të pajtohemi...

Gjyshit iu mbushën sytë me lotë e iu drodh buza. E përqafoi Fadilin, e puthi e pastaj e vështrroi i qeshur partizanin tjetër.

— Falemnderit, bij, falemnderit! Shko thirrë babanë,!  
— m'u drejtua pastaj mua.

Unë kërceva në këmbë dhe dola duke vrapuar. Vrapoja sa kisha fuqi drejt mullirit të vjetër ku rrinte fshehur babai. Ai doli nga qoshja ku fshihej i trembur dhe me pushkën në dorë. Unë iu hodha në qafë dhe nuk munda të flisja. Sytë m'u mbushën me lotë e fillova të qaja me dënësë. Gjithë ankthi i atyre ditëve tani vërshoi



në ata lotë gëzimi që ishte e pamundur t'i përmbaja. Tani edhe unë mund të shkoja me shokët te sheshi... Tani edhe unë nuk do të rrija më i mbyllur në shtëpi. Tani edhe babai im nuk do të flinte vetëm si hajdut në këtë mulli të braktisur, ku flinin vetëm minjtë.

Dolëm bashkë me babanë. Vështrova rrugën përpjetë. Shkëmbinj të mëdhenj e të mprehtë ngrihen drejt qiellit. Ata ashtu kanë qenë qindra vjet më parë dhe ashtu do të jenë gjithmonë, po mua kurrë nuk më janë dukur aq të bukur sa atë ditë. Më dukej sikur edhe pishat, edhe vija e ujit më vështronin të gëzuara. Ajo ditë më ka mbetur në kujtesë si dita më e bukur e fëmijërisë sime.

## K A M B A N A T

— Thuaj të drejtën, xha Vasil, të merr ndonjëherë malli për kambanat?, — pyeti një djalë i ri duke e vështruar plakun si me hile.

Të tjerët ngritën kokën dhe vështruan të qeshur.

— Po, edhe më merr, mor bir, — tha plaku. — Por, ama, kur të vështroj ty me këtë kokë të madhe, më nxjerr mallin e kambanave.

Të qeshurat shpërthyen tej e tej tryezës së gjatë të mensës.

— Antikë është, — tha djali që e ngacmoi duke u kthyer i qeshur nga shoku. — E ke njohur më parë ti, xha Vasilin?

— Jo!

— Kur erdhi në fillim, dukej si më i humburi në botë. Fliste a s'fliste një fjalë tërë ditën.

— Ambienti, — tha i menduar tjetri, — me kë të fliste atje, me kubetë e kishës?

Plaku hante i qetë. I mbeti edhe ca kohë nënqeshja në fytyrë, pastaj dalngadalë ajo u shua dhe ai u bë i menduar. Mbase larg, nga vitet e kaluara, filloi të dëgjonte tingujt e largët të kambanave, që u kishte rënë gjithë jetën.

Vazhdoi të përtypej ngadalë dhe kujtoi atë ditë që nuk do ta harronte kurrë.

Ishte maj. Re të bardha, të fryra vërtiteshin në qiell. Toka kundërmonte pranverë. Një puhizë e lehtë dridhej nëpër fletët e gjelbra. Dielli varej drejt perëndimit.

Xha Vasili, strukur në një qoshe, ndiqte me vështrimin plot ankth lëvizjet e njerëzve, të buldozerëve dhe tymin që ngrihej drejt qiellit. I dukej sikur do të shembej bota. I dukej sikur do të çahet qielli dhe do të vërshonin qindra rrufe. Kjo ishte ngjarja më tronditëse e jetës së tij, e asaj jete që ishte tërhequr zvarë, si kërmilli, pa u ndier. Gjithë jetën ai e kishte kaluar brenda atyre mureve që po shembeshin tani. Gjithë jetën u kishte rënë atyre kambanave që tani i kishin hedhur përtokë në mes të sheshit, si të ngordhura. Ndiante një pikëllim therës në gjoks. I dukej sikur bashkë me çdo gur që shkulej nga muret, këputej edhe një copë e zemrës së tij. I dukej sikur çdo majë kazme ngulej edhe në mishin e tij. Jo, nuk ishte ëndërr. Ai nuk do t'u binte më kurrë kambanave. Njerëzit e kishin harruar zotin. Po zoti, ku ishte zoti? Si i duronte ai këto?! Pse i linte ai njerëzit ta merrnin nëpër këmbë?

Ia kishte mbërthyer sytë kryqit dhe pothuaj s'merrte frymë. Kryqi në majë të kishës dridhej nga litarët që e tërhiqnin nga poshtë. U lëkund, u lëkund e pastaj u shkëput e fluturoi në erë. Një shkrepëtimë e fuqishme e bëri xha Vasilin të hidhej në këmbë. Më në fund qielli e kishte bërë mrekullinë e vet. Zoti më në fund e shtriu dorën e hakmarrjes. Xha Vasili po dridhej nga ethet e tronditjes. Por, për çudinë e tij, askush nuk e prishi tezezinë. Edhe qielli vazhdoi të heshtte si më parë. Vetëm një zë burri u dëgjua që u drejtohej atyre lart:

— Mos hidhni asgjë këtej!... Për pak i këputët telat.

Plaku vështroi atje ku pak më parë u përflak qielli. Telat elektrikë tundeshin duke iu afruar e iu larguar një-

ri-tjetrit. Njerëzit vazhdonin të punonin si më parë. Një e qeshur kumboi brenda kishës. Xha Vasili pa priftin që po vinte drejt tij. Iu shtrembërua fytyra nga një ndjenjë dhembjeje që e shtrëngoi përbrenda. Fytyra e priftit ishte e shuar dhe e zbetë.

— Mbaruam!, — pëshpëriti njeriu me të zeza sikur po jepte shpirt. — Mbaroi!..

Kambanari për pak thirri si i çmendur... si ishte e mundur, si ishte e mundur?!... Kambanat dergjeshin në mes të sheshit si të vdekura, por në sytë e tij ato filluan të tundeshin e të lëshonin tingujt më të përmallshëm. Po i këndonin vdekjes së tyre. Çdo tingull sikur i jepte lamtumirën e fundit. Papritur ai kishte filluar të qante duke mbuluar fytyrën me duar. Përreth gjithçka përmbysesj e kthehej në gërmadhë. I dukej sikur një valë skëterre e kishte përpirë.

Ndjeu t'i dridhej toka nën tabanin e këmbëve. Ngriti kokën. Një mjegull tymi ngrihej tani atje ku kishte qenë kisha.

— Mbaroi!, — dëgjoi ai përsëri. — Mbaruam!..

\* \* \*

— Ha bukë, xha Vasil, mos ki turp, — e ngacmoi djali.

— Mos ma trazo xha Vasilin, se të hëngri dreqi, — tha duke qeshur një shofer i gjatë.

Plaku nuk u përgjigj. Shkundi më parë kujtimet, pastaj vuri buzën në gaz. E, di xha Vasili se ata e duan. E di se ata qeshin pa të keq, me gjithë zemër, kur ai bën ndonjë shaka. Bile prandaj e ngacmojnë. Dhe atij i pëlqen ta ngacmojnë. I pëlqen të gëzohet bashkë me ta. I pëlqen

ta rrëmbejë vala e gjallë e tyre. Ajo valë sikur ia ka trembur atij zymtësinë. Atë zymtësi të murme e të ftohtë që kishte mbajtur mbi supe si pelerinë gjithë jetën.

Mbase ndonjëherë edhe tani i kujtohen kambanat. Mbase ndonjëherë i lutet zotit prapë kur është vetëm. Po këtu midis njerëzve dhe gëzimit të tyre, ato duken të pafuqishme dhe të mpita.

## MERCENARI

Po kthehem në qytetin tim, në Napolin tim, në qytetin ku kam lindur e jam rritur. U bënë 15 vjet që kam ikur prej Italic. Atëherë isha njëzetvjeç, i ri, i fuqishëm, por edhe i krisur. Tani po kthehem i dërrmuar, i plakur para kohe, i lodhur.

Sapo zbrita nga vapori, më pushtoi një ndjenjë e fortë malli për gjithçka që më shohin sytë. Gjithçka më duket e shtrenjtë, e ngrohtë, e dashur. Kam 15 vjet që bredh nëpër botë. Kam 15 vjet që kam mall për këto rrugë, për këta gurë, për këtë det. Kam 15 vjet që nuk kam asnjë lajm nga babai dhe nëna. Kam vite që më thërresin jo me emrin tim, bile as nuk guxoj ta them këtë emër dhe as nuk më lejohet ta mbaj këtë emër.

Isha i ri kur e vështa uniformën. E bukur ishte uniforma. E vështrova veten në pasqyrë i kënaqur. Sigurisht që atëherë s'dija asgjë. Nuk dija sa pluhur do të mbaja mbi supe me atë uniformë. Nuk e dija sa herë do të shkoja buzë vdekjes me ato rroba të bukura. Por nuk do të ndalem në këto, vetëm një ngjarje që nuk do ta harroj kurrë, po u tregoj:

«Kalonim në një lagje të varfër. Fëmijët vendës na qëlluan me gurë. Atëherë komandanti ynë qëlloi me automatik mbi ta. Njëri nga fëmijët mbeti i shtrirë në pluhur. Një vendës u lëshua nga një shtëpi pranë. E ngriti përpara duarve dhe e vështroi komandantin tonë ashtu

si mund të të vështrojë një njeri që mban në duar fëmijën e vranë.

Pas një çasti nxora revolverin nga brezi dhe si i dehur ia drejtova komandantit tim në fytyrë. Më kujtohet mirë se si u mbulua me djersë fytyra e tij e zbetë. Desha ta vrisja si qen. Por shokët m'u hodhën dhe më pas me urdhrin e tij më lidhën. Më kot thërrisja unë se nuk kisha ardhur të luftoja me fëmijë. Të drejtë ka gjithmonë më i forti. Më dënuan me pushkatim. Që atëherë unë jam një i pushkatuar, një i gjallë kontrabandë. Jetën ma shpëtoi Alfonsi, napolitan edhe ai, një nga shokët e mi. Bashkë e kishim veshur uniformën. Për komandën unë jam ende i pushkatuar. Mbase edhe për qytetin, mbase edhe për prindët e mi. Prandaj u enda gjithë këta vjet. Po tani u lodha. Të dalë ku të dalë. Nuk durohet gjithë jetën në mes të të huajve. Mbase prindët janë gjallë...»

Ja ku u ktheva më në fund. Çdo rrugë më duket sikur më buzëqesh. Çdo gur më duket sikur e njoh. Hyra në një kafene të vogël, ku hyja zakonisht me Alfonsin përpara 15 vjetve. Vështrova portën e saj të vjetëruar. Edhe banakieri i saj ishte ai i 15 vjetve të shkuar, po që edhe ai ishte plākur si porta. Lëvizte i plogët. Flokët i ishin zbardhur krejt. Fytyra i dukej si prej lëkure druri.

Para se të hidhja prakun e kafenesë, kurrë s'më shkonte ndër mend se aty do të takoja Alfonsin. Bile po në atë tryezë që rrinim zakonisht para 15 vjetve. E pashë sapo hyra dhe shtanga. Ishte i parruar dhe dukej i mjerë. Në qoshen pranë tryezës ishin mbështetur dy paterica. Më kaluan të rrëqethura në trup. Ai rrinte i zymtë me gotën përpara. Në fillim nuk më njohu, pastaj u hodh përpjetë, sa për pak humbi ekuilibrin. Nxitova dhe e kapa për krahësh. Të dyve na u mbushën sytë me lotë. U ula pranë tij dhe filluam të pinim. Pas bisedave të za-

konshme pasoi një heshtje e gjatë. Pas heshtjes ai ia filloi i trishtuar. Një buzëqeshje e hidhur i endej në cepat e buzëve.

— Ja, — tha — u kthjem ashtu siç na premtuan kur na nisën: «të pasur, të lavdishëm, të lumtur».

Më hodhi një sy nga koka deri te këmbët.

Çdo gjë tek unë tregonte varfëri dhe vuajtje.

— Mirë na gjeti, — e ngriti ai zërin papritur, — na gënjyen me nga një palë rroba të bukura. Po, po, mirë na gjeti.

Heshti gjatë përsëri.

Dikush këndonte i dehur në qoshen tjetër të lokalit.

— Mbrëmë pashë ëndërr babanë.

Tani zëri i Alfonsit ishte i shtruar dhe i përmallshëm.

— Më dukej sikur shëtisnim të dy në bulevardin e vjetër. Më dukej sikur i kisha të dyja këmbët. Më dukej sikur e gjithë jeta kishte qenë një ëndërr e keqe. Por unë nuk po e dëgjoja më. M'u kujtua një ëndërr që kisha parë natën e kaluar në vapor. M'u bë sikur shoqëronim një arkivol që e kishim vënë mbi një makinë luksoze. Edhe mbulesa e arkivolit e zezë, me ca si yje të ndritshme, shkëlqente. Gjithë turma ishte elegante. U futëm në varreza dhe e vumë arkivolin pranë një varri të hapur. Papritur njerëzit u larguan dhe unë mbeta vetëm. Arkivoli u shndërrua në çast në grumbull leckash. — Hë, Xhorxh, thuaj që nuk na shpërblyen mirë, — fliste Alfonsi, ndërsa unë vazhdoja të mendoja ende për ëndërrën. Më dukej sikur ajo ëndërr ishte sintezë e jetës sonë.

A nuk ishim nisur ne gjithë shkëlqim? Po megjithatë, a nuk ishim në arkivol që ditën që u nisëm? Shokët tanë u kthyen në eshtra, e u humbi nami dhe nishani nëpër xhungla.

— Kufomat e tyre i shqyen egërsirat, — foli Alfonsi!.



Mua më dukej se kisha përpara syve ende atë grumbull leckash që pashë natën e kaluar në ëndërr.

— Ne u dhamë padronëve tanë rininë, jetën, gjakun tonë... Ata na dhanë neve pleqërinë, varfërinë, patericat.

Ndërsa unë ende mendoja për ëndrrën e mbrëmshme. Fillova ta komentoja në njëqind mënyra.

— Na gënjyen, Xhorxh, na gënjyen keq, na e hodhën.

— Po për prindët e mi di gjë ti?, — e pyeta papritur Alfonsin duke e vështruar drejt në sy. Ai belbëzoi duke iu marrë goja.

— Unë s'jam fëmijë, — i thashë, — më thuaj, sido që të jetë puna.

Ai m'u përgjigj duke ia ngulur sytë gotës që kishte përpara:

— Babai ka shtatë - tetë vjet që ka vdekur.

— Po nëna?

— Nëna rron, — tha ai dhe u koll. Por pikërisht ajo e kollitur më dogji. I thashë se doja ta takoja sa më parë nënën dhe u ngritëm që të dy. Rrugës trokitja e patericave të tij më dukej sikur vinte nga thellësia e viteve të shkuara. Ishte ngrohtë, megjithëse dielli po i afrohej perëndimit. Ne ecim ngadalë dhe ai dukej që donte të më thoshte diçka. Më në fund ndezi një cigare dhe tha me sytë përdhe:

— Ndonjëherë atë e kapin ca kriza, po ti mos u shqetëso.

— Çfarë krizash?, — thashë duke e marrë me mend se fliste për nënën.

— I janë dobësuar nervat...

Dhe unë nuk e pyeta më gjatë, se e mora me mend: i shoqi i vdekur; lajmi i pushkatimit tim. Pa dashje shpejtova hapin, por në çast u kujtova për patericat e

Alfonsit dhe e ndalova vrullin. Kaluam në ca rrugë të ngushta, shtruar me kalldrëm. «Ja shtëpia ime e ulët. Dritaret e saj nuk paskan xhama, por kartona të rjepur nga shiu dhe leckë. Në oborr një plakë e pakrehur dhe me fytyrë të nxirë vende-vende nga tymi. Sa pak i ngjan ajo nënës sime, por megjithatë është, ajo vetë.

Ndjeva një të therur thellë në gjoks. Iu afruam dhe unë po e vështroja i heshtur. Ajo fliste me vete e zhytur në çmendurinë e saj.

— O nënë, mirëmbrema!, — dëgjova që i tha Alfonsi.

Atëherë ajo ngriti kokën dhe na vështroi drejt.

— Të kam sjellë djalin, Xhorxhin.

— Shshsht. . ., — vuri gishtin te buzët. — Njërëzit gënjejnë, — tha ngadalë. — Thonë se atë e pushkatuan, por jo, nuk është e vërtetë. Pse tallesh, ai do të vijë një ditë, do të vijë patjetër, i lumtur, i pasur, po, po, do të vijë.

O nënë, — i thashë, — shikomë mirë, jam Xhorxhi, — dhe ndjeva se zëri më mbeti në grykë. Nëna më vështroi drejt në sy, qeshi dhe tha:

— Ik, ik ti nuk je Xhorxhi. Xhorxhi është i ri, është i bukur, kurse ti je një plak lypësar, një hajdut, që vjen të vjedhësh tim bir, por nuk do t'jua tregoj ku është, nuk jua tregoj.

Filloi të thërriste më e egërsuar:

— Shporruni, shporruni!

Çfarë të bëja? U largova pak dhe ndeza një cigare. Duart po më dridheshin. Veshët filluan të më gjëmonin si të rrokulliseshin të përmbysur të gjitha vitet e jetës sime.

— Ashtu si lindëm, do të vdesim fatkëqinj!, — belbëzoi Alfonsi aty pranë.

— Jo, — i thashë unë dhe ndjeva se filloi të ndi-

zej një zjarr brenda meje. — Jo, unë nuk dua të vdes ashtu si kam jetuar. Në u dashtë të vdes, do të vdes që nesër, por jo më me duart kryq, jo më i gënjyer. Dua të hakmerrem, dua të hakmerrem!

Padashur kisha thirrur fort. Dikush që kaloi aty pranë ktheu kokën i habitur. Por unë edhe atë e vështrova me inat, ndoshta pa të drejtë, po ndieja brenda vetes tërbimin.

Nëna ime fliste me vete aty pranë:

— Im bir do të vijë i lumtur... i pasur...